



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

**Strategjia Kombëtare
për Zhvillim dhe Integrim
2007-2013**

Mars 2008

Parathënie

Kam kënaqësinë dhe nderin të prezantoj Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013 në të cilën ndërthuren axhendat më kryesore të Qeverisë Shqiptare. Për herë të parë harmonizohen në një dokument të vetëm strategjik axhenda për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm me axhendën e integritit në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.

SKZHI kristalizon qartë vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të vendit bazuar kjo në një proces të hapur e transparent që garanton përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, komuniteteve vendore, komunitetit të biznesit, grupeve të tjera të interesit, strukturave akademike e shkencore të vendit, spektrit politik shqiptar, etj.

SKZHI është konsultuar në vazhdimësi e me vëmendje të veçantë jo vetëm me partnerët vendas por edhe me ata tanë ndërkombëtarë që mbështesin vendin në të gjitha reformat e tij. Sfidat e vështira që na presin do të realizohen përmes bashkëpunimit të të gjithë spektrit politik e social shqiptar me partnerët tanë për zhvillim. Gjatë këtij rrugëtimi shtatë vjeçar, jemi të bindur që institucionet tona demokratike do të forcohen si dhe do të sigurohet respektimi i shtetit të së drejtës. Mekanizmat e tregut do të lejojnë bizneset të shfrytëzojnë më shumë mundësitë e reja. Vazhdimësia e procesit të përmirësimit të shpejtë të infrastrukturës në Shqipëri do të jetë prioriteti ynë kryesor. Politikat sociale të cilave do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë do të bëjnë të mundur që popullata të përfitojë nga rritja e qëndrueshme ekonomike.


Duke e konsideruar këtë dokument si një përpjekje e produkt serioz të shumë institucioneve të përfshira në proces, dëshiroj të shpreh vlerësimin për përkushtimin dhe punën e bërë në veçanti nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhimes se Huaj pranë Këshillit të Ministrave, si edhe nga të gjitha Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera publike të përfshira në këtë proces.

Nuk mund të lë pa shprehur vlerësimin maksimal për donatorët që e kanë mbështetur që në fillim këtë proces, në veçanti Departamenti i everisë Britanike për Zhvillim Ndërkombëtar, për ndihmën thelbësore teknike dhe financiare në përgatitjen e këtij dokumenti.

Së fundi, do të doja t'ju ftoja të gjithëve të merrnit pjesë në realizimin e qëllimeve tona të përbashkëta në shërbim të progresit të mëtejshëm të Shqipërisë dhe rritjes së mirëqënies së qytetarëve të vendit tonë.

Kryeministri

Sali Berisha



Pasqyra e lëndës

Hyrje	7
1. Zhvillimet më të fundit	9
2. Vizioni, përparësitë dhe qëllimet strategjike	14
3. Politikat	20
3.1 Integrimi në Bashkimin Europian dhe në NATO	21
3.2 Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	26
Drejhtësia dhe çështjet e brendshme	27
Modernizimi i administratës	39
3.3 Zhvillimi ekonomik dhe social	43
Infrastruktura	44
Ekonomia e tregut	56
Politika sociale	63
Zhvillimi urban, rural dhe rajonal	81
4. Perspektiva makroekonomike dhe fiskale	91
5. Llogaridhënia	100
5.1 Konsultimi	100
5.2 Zbatimi	101
5.3 Monitorimi	102

Hyrje

Në nëntor të vitit 2005, Qeveria e Shqipërisë miratoi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është një grup parimesh funksionale për të garantuar që procesi i planifikimit dhe i zbatimit të politikave nga ana e Qeverisë të kryhet në mënyrë koherente, të frytshme dhe të integruar. Dy janë proceset më të rëndësishme në këtë sistem:

- **Procesi afatmesëm dhe afatgjatë për *planifikimin strategjik*, që është **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) (2007-2013)**, e cila përcakton përparësitë dhe synimet strategjike.**
- **Procesi *buxhetor* afatmesëm, i quajtur Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**, i cili kërkon që çdo ministri të përgatisë midis marsit dhe majit një plan trevjeçar brenda një tavani shpenzimesh të përcaktuar, për të arritur objektivat e politikës, si hapa të ndërmjetshëm për arritjen e qëllimeve të SKZHI-së. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve korrik dhe tetor.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programi Buxhetor Afatmesëm mbështesin plotësisht proceset e mëposhtme të planifikimit:

- **Programin e Qeverisë i cili u paraqit në parlament në shtator të 2005-ës, në përputhje me detyrimet kushtetuese.**
- **Integrimin në Bashkimin Europian, veçanërisht zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), dhe Integrimin në NATO përmes plotësisht të standardeve për anëtarësim, në këto fusha: politike, ekonomike, ligjore, ushtarake, financiare dhe të sigurisë së informacionit.**
- **Menaxhimin e investimeve publike, i cili - me disa procedura të reja që zbatohen për herë të parë më 2007-ën - do të bëhet pjesë integrale e PBA-së.**
- **Asistencën e huaj, veçanërisht përpjekjet e qeverisë për të optimizuar përdorimin e ndihmës së huaj në përputhje me zotimet e deklaratës së Parisit për efikasitetin e ndihmës së huaj nënshkruar në muajin mars të vitit 2005.**

Në mars të vitit 2006, Komiteti i Planifikimit Strategjik, autoriteti më i lartë vendimmarrës i SPI-së, mori vendimet e mëposhtme mbi SKZHI-në:

- **Ajo do të përfshinte gjithë objektivat e masat e përmendura në MSA dhe në Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO, si dhe do të përmbushte të gjitha standardet dhe kriteret e këtyre marrëveshjeve. Kërkesat e këtyre marrëveshjeve të pasqyroheshin plotësisht në vizionin kombëtar, në procesin e hartimit dhe të zbatimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale, si dhe në planifikimin e buxhetit.**
- **Kjo strategji do të shërbente si një vizion afatmesëm për planifikimin e politikave, si dhe afatgjatë për zhvillimin kombëtar.**
- **Ajo do të përcaktonte disa tregues të nivelit të lartë që të masin ecurinë për arritjen e synimeve kombëtare.**
- **Ajo do të sintetizonte strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale afatmesme e afatgjata dhe do të pasqyronte kostimin e tyre indikativ.**
- **Menaxhimi i investimeve publike dhe dokumenti i orientimit të ndihmës së huaj do të bazoheshin në përparësitë sektoriale.**

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim zëvendëson Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES), e cila ishte dokumenti kryesor strategjik i qeverisë deri në vitin 2006. Ndryshimet që sjell SKZHI-ja kanë për qëllim të përmirësojnë disa kufizime të SKZHES:

- **SKZHES-ja bazohej mbi një numër të kufizuar dokumentesh sektoriale të hartuara ad hoc dhe jo si pjesë e një procesi planifikimi të rregullt nëpër ministri.**
- **Integrimi Europian dhe anëtarësimi në NATO nuk ishin pasqyruar plotësisht.**

- Procesi i SKZHES-it ishte i shkëputur nga PBA. Përkundrazi, përsa i përket SKZHI-së:
 - Strategjitë sektoriale do të jenë dokumenti i referencës për PBA-në. Përgatitja dhe aktualizimi i strategjive sektoriale është një nga tiparet kryesore të procesit të SKZHI-së.
 - SKZHI-ja nuk do të bazohet në një kuadër trevjeçar, meqenëse kjo është kompetencë e PBA-së. Ajo do të jetë një dokument afatgjatë me horizont planifikimi 2007-2013, që përputhet me kuadrin buxhetor të Bashkimit Europian dhe veçanërisht me Instrumentin e Asistencës së Para-aderimit. Ajo do të japë informacion për PBA-në duke parashikuar një drejtim afatgjatë për shpërndarjen e të ardhurave midis sektorëve të ndryshëm.

Në qershor të vitit 2006, u publikuan udhëzimet për përgatitjen e SKZHI-së, të cilat përcaktuan:

- strategjitë sektoriale që do të hartohen si bazë për SKZHI-në
- standardet sipas të cilave ato do të rishikohen
- strategjitë ndërsektoriale që do të hartohen me qëllim për të bashkërenduar ato politika të rëndësishme me përparësi, të cilat nuk janë përgjegjësi vetëm e një ministrie.

Në muajin qershor të vitit 2006, ministritë e linjës filluan përgatitjen e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale nën drejtimin e grupeve përkatëse për Strategji, Buxhet dhe Integrim. Projekt-strategjitë u dorëzuan në mes të tetorit 2006 në Këshillin e Ministrave. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj në Këshillin e Ministrave bashkërendoi përgatitjen e SKZHI-së mbi bazën e projekteve të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të marra nga ministritë. Këto drafte u rishikuan në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Integritimit Europian, si dhe INSTAT-in. Më pas projektet e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale u konsultuan me palët e interesuara jo qeveritare gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2007.

Jo të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale ishin miratuar në kohën kur u përgatit ky dokument, megjithatë ka pasur marrëveshje për drejtimet strategjike kryesore. Dokumenti i SKZHI-së pasqyron dinamikën aktuale të këtij procesi. Megjithëse pritet që strategjitë sektoriale të përditësohen në rast se do të ketë ndryshime të rëndësishme në politikat që ato parashikojnë, SKZHI-ja nuk pritet të ndryshojë. Megjithatë, do të bëhet çdo vit një rishikim i procesit të zbatimit të SKZHI-së, duke i paraprirë procesit të përgatitjes së PBA-së në mënyrë që të nxirren informacione të mjaftueshme për përcaktimin e tavanëve buxhetore sektoriale fillestare. Do të publikohet çdo vit një raport i progresit vjetor. Ky raport vjetor do të shërbejë jo si dokument planifikimi, por si një mjet monitorimi, mbi bazën e të cilit do të bëhet e mundur llogaridhënia.

SKZHI-ja përbëhet nga pesë kapituj. Kapitulli 1 jep një përmbledhje të sfidave kryesore me të cilat përballet vendi (*ku jemi*). Kapitulli 2 shpreh vizionin kombëtar, identifikon përparësitë dhe qëllimet strategjike që duhen arritur (*ku duam të shkojmë*). Kapitulli 3 përmbledh çështjet kryesore të çdo strategjie sipas përparësive strategjike (*si do të shkojmë atje ku duam*). Kapitulli 4 paraqet kuadrin makroekonomik dhe diskuton ndryshimet kryesore që do të nevojiten në shpërndarjen e burimeve sipas sektorëve (*sa do të kushtojë ky proces*) gjatë viteve 2007-2013. Dhe së fundi, Kapitulli 5 thekson nevojën për transparencë dhe përshkruan procesin e konsultimit gjatë procesit të hartimit, i cili do të vazhdojë edhe gjatë zbatimit të këtij dokumenti, si dhe treguesit nëpërmjet të cilëve do të vlerësohet zbatimi i strategjisë (*si matet ecuria*).

1. Zhvillimet më të fundit

Në këto 15 vite të demokracisë, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të mëdha politike, institucionale dhe shoqërore-ekonomike. Nga vendi i izolimit më të thellë, të lirive dhe të drejtave të mohuara me kushtetutë, ateizmit të imponuar, u shndërrua në vendin e pluralizmit politik tashmë të konsoliduar. Shqipëria është sot vendi ku respektohen e garantohen liritë dhe të drejtat e individit dhe të minoriteteve, mediat e lira, liria e plotë e besimeve fetare. Ekonomia shqiptare është tashmë ekonomia e nismës së lirë, ku mbi 80 për qind e prodhimit të brendshëm vjen nga sektori privat dhe ku të ardhurat për frymë janë sot 20 herë më të larta se në vitin 1992.

Shqipëria është shndërruar në një faktor të rëndësishëm të sigurisë, paqes dhe stabilitetit në rajon. Politika e saj e jashtme është realizuar nëpërmjet përfshirjes aktive dhe mbështetjes së organizatave rajonale e ndërkombëtare; nxitjes së besimit nëpërmjet dialogut dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë; mbështetjes dhe pjesëmarrjes aktive në programet rajonale e ndërkombëtare për krijimin e besimit; ndershmërisë dhe sinqeritetit në transaksionet rajonale e ndërkombëtare. Kjo politikë synon integrimin e Shqipërisë në NATO dhe BE, vazhdimin e procesit të forcimit të institucioneve ekonomike e të sigurisë rajonale dhe bashkëpunimin euro-atlantik në fushën ekonomike dhe atë të sigurisë.

Asociimi me vendet dhe institucionet euro-atlantike e ka ndihmuar Shqipërinë në forcimin e proceseve dhe strukturave të saj demokratike dhe për zbatimin e reformave të brendshme, të nevojshme për një demokraci të fortë e funksionale.

Integrimi në BE. Më 12 qershor 2006 në Luksemburg, Shqipëria nënshkroi, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshjen e Përkohshme me Bashkimin Europian. Më 1 dhjetor 2006 ka hyrë në fuqi *Marrëveshja e Përkohshme* për tregtinë dhe çështjet e lidhura me të. Sipas Komisionit Europian, zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme ka qenë i suksesshëm. Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe po vë në jetë Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si instrumenti kryesor monitorues i reformave politike, ekonomike, ligjore e institucionale dhe që konsiderohet pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Komisioni Europian ka bërë këtë vlerësim të ecurisë së Shqipërisë në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit¹:

- Në lidhje me *kriteret politike*, vlerësohet përparimi që ka shënuar Shqipëria në fushën e demokracisë dhe shtetit ligjor, në luftën kundër korrupsionit, si dhe për ndjekjen e një politike konstruktive në drejtim të rajonit.
- Në lidhje me *kriteret ekonomike* vlerësohet stabiliteti makroekonomik në Shqipëri, i cili ka ndihmuar në ecjen përpara drejt një ekonomie tregu funksionale.
- Në lidhje me përmbushjen e *standardeve Europiane* dhe krijimin e mekanizmave administrativë dhe institucionalë për të garantuar zbatimin e *acquis communautaire*, është vlerësuar krijimi i strukturave të reja për të bashkërenduar thelbin e reformave të BE, për të menaxhuar burimet dhe për t'i vënë në jetë ato.

Integrimi në NATO. Të gjitha partitë politike shqiptare mbështesin integrimin në NATO dhe në BE dhe u janë përkushtuar reformave e transformimeve të nevojshme për realizimin e tyre. Ngritja së fundi e komisionit dypartiak ad hoc në Kuvend për integrimin e Shqipërisë në NATO ka ndihmuar procesin e miratimit të reformave për integrimin në NATO.

Më 22 gusht 2007, u krijua Zyra e Koordinatorit Kombëtar për NATO-n pranë Këshillit të Ministrave. Koordinatori Kombëtar bashkërendon punën e institucioneve të ndryshme brenda ekzekutivit, duke lehtësuar kështu bashkëpunimin ndërmjet ekzekutivit dhe Kuvendit të Shqipërisë, Presidencës së Republikës dhe organeve të tjera të pavarura, me qëllim çuarjen përpara të reformave të parashikuara në MAP.

¹ Enlargement strategy and main challenges 2006-2007, Annex 2, nëntor 2006

Kriteret politike

Demokracia. Shqipëria është tashmë një demokraci funksionale. Gjatë 30 muajve të fundit ajo kaloi me sukses *tre teste të rëndësishme politike*. Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, të zhvilluara në 3 korrik 2005, realizuan një rotacion demokratik të pushtetit; zgjedhjet vendore të datës 18 shkurt 2007, pavarësisht nga disa mangësi të karakterit teknik, u pranuan nga të gjitha forcat politike dhe u vlerësuan të lira e të ndershme nga drejtuesit e opozitës; në korrik të vitit 2007 u zgjodh Presidenti i Republikës me procedurë parlamentare në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën, që u mbështet nga të gjitha forcat politike dhe u përshëndet edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Reforma elektorale. Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar në maj 2007, *një komision ad hoc dypartiak për reformën zgjedhore*, të bashkëkryesuar nga mazhoranca dhe opozita, i cili po punon për reformën zgjedhore duke marrë parasysh Rekomandimet e Raportit Përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale. Për t'u dhënë përgjigje përfundimtare problemeve teknike në zgjedhje, ka filluar puna për krijimin e regjistrit elektronik të gjendjes civile, i cili pritet të përfundojë në korrik 2008. Në muajin shkurt 2008 zhvillohet tenderi ndërkombëtar për të zgjedhur firmën fituese që do të prodhojë kartat e identitetit dhe pasaportat digjitale.

Në janar të vitit 2008, Kuvendi miratoi një rezolutë me anë të së cilës shpreh gatishmërinë e të gjitha forcave politike për të krijuar një klimë të shkëlqyer bashkëpunimi për të gjitha reformat e nevojshme për integrimin e Shqipërisë, të cilat kërkojnë konsensus të gjerë.

Shteti i së drejtës. Shqipëria ka bërë përparim real në konsolidimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor, si kusht përcaktues për funksionimin e shtetit të së drejtës. Ajo ka sot një nivel të lartë në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, të krahasueshëm me atë të shumë vendeve anëtare të NATO-s. Në Raportin e Progresit të vitit 2007, Komisioni Evropian vlerësoi hapat e bërë në sajë të konsensusit politik, drejt përfundimit të ligjit për reformën në drejtësi, i cili u ofron gjykatave administrative transparencë në vendimet e tyre dhe përmirësimin e skemës së karrierës së gjyqtarëve. Kuvendi miratoi në 18 shkurt 2008 projektligjin "Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të mbështetur në iniciativën e Këshillit të Ministrave dhe ripunuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend, i ndihmuar dhe nga një grup ekspertësh juristë. Projektligji në fjalë u miratua nga Komisioni i Ligjeve me konsensusin e të gjitha partive politike të përfaqësuara në të në konsultim me aktorët dhe organizatat e interesuara. Ky akt ligjor përcakton dhe strukturon në mënyrë të qartë rekrutimin e gjyqtarëve, karrierën e tyre, masat disiplinore, të drejtat, detyrimet dhe statusin e tyre, sistemin e pagave, garancitë e qëndrimit në detyrë, pavarësinë në ushtrimin e profesionit dhe përgjegjshmërinë e gjyqtarëve etj. Ndërkohë, partitë më të mëdha politike në Kuvend kanë nisur diskutimet për paktin e reformës në drejtësi të sugjeruar nga opozita. Projekti fillestar i këtij pakti u është paraqitur të gjitha grupeve parlamentare për sugjerime. Pas konsultimeve politike dokumentit në fjalë do t'i jepet vlerë juridike nga Kuvendi. Pakti përmban një këndvështrim të gjerë për vizionin në sistemin e drejtësisë dhe reformimin e tij në vite, si dhe përcakton modalitetet e realizimit të tij nëpërmjet një plani masash konkrete afatshkurta dhe afatmesme.

Në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve, Shqipëria është vendi ku respektohen dhe garantohen liritë dhe të drejtat e individit e të minoriteteve, mediat e lira, liria dhe pluralizmi i plotë i besimeve fetare, toleranca fetare dhe etnike.

Policia. Ligji i ri për Policinë e Shtetit i miratuar nga parlamenti ka bërë të mundur krijimin e standardeve të reja profesionale, decentralizimin e buxhetit të saj, si dhe vënien në përdorim të koncepteve të policimit në komunitet. Arritjet e vitit të kaluar në fushën e luftës kundër trafikëve ilustrojnë më së miri ecurinë e reformës në këtë fushë. Janë goditur rreth 36 grupe kriminale dhe janë proceduar 149 individë të përfshirë në veprimtari kriminale të trafikëve të drogës. Si rrjedhim është rritur ndjeshëm siguria në vend, e cila vërtetohet nga statistikat e policisë shqiptare, të policive të vendeve fqinje, si dhe nga raporte ndërkombëtare.

Lufta kundër krimit dhe korrupsionit. Qeveria shqiptare ka vazhduar luftën me tolerancë zero kundër krimit dhe korrupsionit. Janë hapur linja pa pagesë për denoncimin e veprave të korrupsionit dhe ka nisur zbatimi i reformave të tilla, si: regjistri elektronik i bizneseve, prokurimi elektronik dhe procedurat elektronike të taksave e të doganave, të cilat reduktojnë ekspozimin ndaj korrupsionit të administratës publike. Si rezultat gjatë vitit 2007 u bë e mundur sjellja para drejtësisë e 51 personave nën akuzën e korrupsionit, mes të cilëve kishte dhe zyrtarë të lartë. Me ndihmën e FBI-së


dhe Komisionit Evropian është ngritur një *task force* për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, e cila ka dhënë rezultatet e veta.

Gjatë vitit 2007 u goditën dy herë më shumë grupe kriminale se në vitin 2005, gjithsej 206 grupe në dy vjet dhe 851 persona të sjellë përpara drejtësisë. Janë marrë masa të forta për të rritur kontrollin dhe sigurinë në pikat kufitare, përfshirë dhe instalimin e një sistemi për menaxhimin e informacionit në pikat kryesore të kalimit të kufirit, sistem i cili po shtrihet në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Janë ndërmarrë masa të rëndësishme për të mbyllur rrugët e kalimit tranzit të drogave, dhe janë arritur rezultate të larta në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore. Arrestimet e nivelit të lartë të grupeve kriminale gjatë viteve të fundit tregojnë angazhimin serioz në trajtimin e këtij fenomeni, i cili dëmtonte imazhin e vendit. Parlamenti shqiptar ka miratuar një sërë ligjesh për të përforcuar luftën kundër krimit të organizuar, si ligji për ndalimin e skafeve, ligji që ngarkon me përgjegjësi penale zyrtarët e administratës vendore, kur në territorin e komunave të tyre gjenden plantacione me bimë narkotike.

Kriteret ekonomike

Funksionimi i ekonomisë së tregut. Shqipëria ka pasur që prej vitit 1992 ritimin e rritjes së produktit të brendshëm bruto më të lartë nga të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, përfshirë këtu dhe vendet e anëtarësuara së fundi në Bashkimin Evropian. Siç e tregon Figura 1.1, produkti i brendshëm bruto për frymë është rritur nga \$1809 në vitin 1992 në \$5727 në vitin 2006 sipas të dhënave të *World Economic Outlook* dhe situata makroekonomike ka qenë e qëndrueshme.

Figura 1.1 Rritja në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore qysh prej vitit 1992



Shënim: 1992=100

Burimi: Baza e të dhënave e *World Economic Outlook*, Fondi Monetar Ndërkombëtar

Rritja ekonomike ka qenë e qëndrueshme në nivelet prej 6% dhe për vitet 2009-2011 do të vazhdojë të ruhet ritmi i lartë 6-7%. Produkti i brendshëm bruto në terma nominalë, në fund të vitit 2007, është vlerësuar në rreth 979 miliardë lekë, nga 892 miliardë lekë që ishte në fund të vitit 2006, duke shënuar një rritje prej rreth 9%.

Prodhimi i brendshëm bruto për frymë, në vitin 2007 ishte 309 611 lekë, ose rreth 9.1% më shumë se në vitin 2006. Rritja e produktit të brendshëm bruto për frymë ka ndikuar në rritjen e nivelit të jetesës, një nga komponentët e treguesit të zhvillimit njerëzor ('Human Development Index'), i cili është vlerësuar nga UNDP dhe krahason nivelin shëndetësor, arsimor dhe nivelin e jetesës midis vendeve. Shqipëria hyn në grupin e vendeve me nivel të lartë të këtij treguesi për vitin 2008.

Inflacioni. Norma vjetore e inflacionit është mbajtur brenda niveleve të synuara të Bankës së Shqipërisë, në rreth 3% (± 1 %), nëpërmjet një politike monetare të kujdesshme dhe në koherencë me politikën fiskale. Leku ka qenë i qëndrueshëm gjatë vitit 2007 dhe oferta monetare (M3) është rritur me 7%.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2007 arrin në rreth €173 milionë dhe rezervat valutore €1,5 miliardë. *Eksportet* u rritën me 27% në 2007, ku vlerësohen më shumë rritja e eksporteve të shërbimeve dhe eksportet me përpunim aktiv (fason). *Importet* u rritën me 26% në 2007, sidomos importi i mallrave kapitale, mallrave të përdorura në procesin e prodhimit, energjisë dhe ushqimeve. *Deficiti tregtar* pothuajse 25% e PBB-së është i ngjashëm me atë të shteteve të rajonit. Mekanizmi kryesor që mbështet bilancin e pagesave është rritja në sasi e *transfertave private* nga jashtë, të cilat si përqindje e PBB-së, janë nga më të lartat në botë.

Niveli i papunësisë është ulur në 2007 në 13,2% krahasuar me 13,9% në 2006, sipas statistikave zyrtare. Sektorët me rritje të numrit të të punësuarve në vitin 2007 ishin industria, transporti, telekomunikacioni, tregtia, hotelet e restorantet. **Politika e pagave** gjatë viteve 2006 dhe 2007 është orientuar drejt dyfishimit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.

Politika fiskale. Me gjithë uljen drastike të taksave, *të ardhurat e përgjithshme* të buxhetit të shtetit janë rritur ndjeshëm. Në vitin 2007 ato ishin rreth 27% të PBB-së, krahasuar me 25,5 % të PBB-së në vitin 2006 dhe 24,8% në 2005. Megjithëse në korrik të vitit 2007 filloi zbatimi i *tatimit mbi të ardhurat personale* në një shkallë të vetme prej 10%, pati rritje në të ardhurat buxhetore kryesisht si rezultat i përmirësimeve në arkëtimin e tatimeve. Në janar të vitit 2008, filloi zbatimi i taksës së sheshtë prej 10% për *tatimin mbi fitimin*, duke shënuar përgjysmimin e tatimit për biznesin. Gjithashtu janë reduktuar me 50% taksa për biznesin e vogël, me 30% kontributet e sigurimeve shoqërore dhe me 33% çmimi i energjisë për biznesin. Të ardhurat buxhetore do të vazhdojnë të rriten për shkak të rritjes ekonomike, rritjes së besimit të biznesit, nxitjes së tij nëpërmjet reduktimit të barrierave insitucionale, rritjes së investimeve publike, rritjes së investimeve private të brendshme e të huaja, përmirësimit teknologjik dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore, rritjes e zhvillimit të mëtejshëm të sistemit financiar. *Shpenzimet buxhetore* 31,6% në vitin 2007, ishin më të larta se në vitin 2006, kur përbënin 28.8%. Politikat kryesore të shpenzimeve janë karakterizuar nga: një rritje e shpenzimeve kapitale për investime (kryesisht në infrastrukturë) nga 5,7% në 2006, në rreth 7,2% të PBB-së në 2007; zvogëlimi i shpenzimeve operative, nga 2,6% të PBB-së në vitin 2006, në 2,5% në vitin 2007. Shpenzimet kapitale do të jenë të larta edhe gjatë vitit 2008, me 9,8% të PBB-së, por më pas ato do të mbahen në nivelin e 6,3% të PBB-së, ndërsa shpenzimet operative do të rriten pas vitit 2008, në rreth 2,9%. Deficiti buxhetor në 2007 është rritur në 4,6% të PBB-së krahasuar me 3,3% në vitin 2006, kryesisht për shkak të rritjes në investime.

Investimet e huaja direkte janë rritur me 84% në 2007 (tri herë më shumë se mesatarja e 10 viteve të fundit) në sajë të reformave të qeverisë për përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit, të procesit të privatizimit të disa ndërmarrjeve shtetërore, zgjerimit të partneritetit publik-privat, si dhe aplikimit të nismës 'Shqipëria 1 Euro'. Interesi i investitorëve të huaj është në rritje kryesisht në fushat e energjisë, minierave, bankave, turizmit dhe infrastrukturës.

Treguesi i lirisë ekonomike. Raporti i publikuar së fundmi nga 'Heritage Foundation', mbi lirinë e sistemit ekonomik e rendit Shqipërinë të 56-ën, ndër 157 vende të gjithë botës, krahasuar me vitin 2004 (vendi 81) dhe 2000 (vendi 121), duke e kategorizuar atë në grupin e vendeve me ekonomi, "përgjithësisht të lirë". Liria fiskale, liria në investime dhe liria financiare janë në nivele më të larta se mesatarja, ndërsa të drejtat e pronësisë dhe liria nga korrupsioni janë më të ulëta.

Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë ka bërë hapa të rëndësishëm përpara. Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave vazhdon procesin e kthim-kompensimit dhe është tashmë në fazën përfundimtare të përpilimit të hartës së tokës, mbi bazën e së cilës do të bëhet i mundur kompensimi. Ndërkohë Agjencia për Legalizimin dhe Urbanizimin e Zonave dhe Ndërtimeve Informale është duke përfunduar hartën dixhitale ortografike për të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu këto dy agjenci kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për të bashkërenduar të dy proceset dhe për ta përshpejtuar reformën.

Në fushën e infrastrukturës, angazhimet e qeverisë janë reflektuar në projektin madhor të ndërtimit të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, modernizimin dhe zgjerimin e Portit të Durrësit, të Vlorës dhe Shëngjinit, si dhe dhënien me koncesion të aeroportit Nënë Tereza. Gjatë vitit 2007 ka filluar

ndërtimi i TEC-it të Vlorës si pjesë e strategjisë për të diversifikuar prodhimin e energjisë elektrike dhe për ta ulur varësinë pothuajse totale të sistemit nga burime hidrike.

Privatizimi i sektorëve strategjikë. Ka përfunduar privatizimi i Albtelekom-it, është miratuar ndarja nga KESH-i e divizionit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe po përgatitet privatizimi i tij, si dhe po vazhdon procesi i ristrukturimit dhe privatizimit të kompanive shtetërore të sektorit të naftës.

Standardet Europiane

Shqipëria ka shënuar përparim në procesin e përafrimit të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis communautaire*. Në aspektin e promovimit të **tregut të brendshëm**, Shqipëria ka ecur me hapa të shpejtë përsa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, përafrimit të politikave doganore dhe sistemit të taksave si dhe vendosjes së konkurrencës së lirë. Procedurat e reja moderne të prokurimeve publike nxisin trajtimin e barabartë, transparencën dhe ruajtjen e çmimeve në nivel të leverdisshëm.

Regjistrimi i biznesit ka kaluar nga kompetencat e gjykatës në ato të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, gjë që e ka zvogëluar kohën e regjistrimit të biznesit nga 42 ditë në 1 ditë, bazuar në praktikën 'one-stop shop'. Kjo iniciativë është pjesë e reformave të ndërmarra për të ngushtuar sektorin informal.

Për të mbështetur **zhvillimin rural dhe bujqësor** po zbatohen skema lehtësuese për fermerët dhe lehtësira fiskale, si kompensimi i TVSH deri në 6%. Integrimi i tokës bujqësore dhe kalimi nga copëzimi në nisma të përbashkëta, do të garantojnë zhvillimin e prodhimit bujqësor, të agrobiznesit dhe të partneriteteve rajonale.

Në fushën e **mjedisit**, Shqipëria ka një impakt shumë të ulët në ndotjen globale, për shkak të sasisë së vogël të gazrave me efekt serre që ajo prodhon. Ka filluar puna për reduktimin e nivelit të ndotjes së ajrit nga automjetet në qendrat urbane dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe atyre urbane, në garantimin e cilësisë dhe vazhdimësisë në furnizimin me ujë, dhe në ruajtjen e nivelit të lartë në Indeksin e Performancës së Mjedisit ('Environmental Performance Index') që i është akorduar Shqipërisë.

Është miratuar ligji ri për **prokurimet publike** i cili parashikon ngritjen e institucionit të Avokatit të Prokurimeve, që mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve, ofertuesve apo furnizuesve. Ngritja e infrastrukturës për prokurimin elektronik do ta ulë edhe më shumë koston e përgjithshme të prokurimeve në vend.

Për të koordinuar politikat në fushën e **teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit** është ngritur Agjencia e Shoqërisë së Informacionit e cila ka rolin udhëheqës në këto projekte: informatizimi i shkollave, e-shërbimet si: e-taksat, e-doganat, regjistri elektronik i gjendjes civile dhe sistemi i adresave, kartat e identitetit, firma elektronike dhe modernizimi i regjistrimit të tokës. Ka filluar puna për krijimin e Rrjetit Kombëtar Akademik dhe rrjeti gov-net ekzistues po përmirësohet dhe zgjerohet.

Për menaxhimin e **rrezikut financiar** është krijuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili fokusohet në identifikimin, matjen, parandalimin dhe eliminimin e hershëm të shkallës së rreziqeve kryesore që kërcënojnë performancën e tregut. Është bërë përparim në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, pa lënë në harresë pensionet private dhe letrat me vlerë. Megjithatë është i nevojshëm përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për ngritjen e një platforme raportimi dhe mbikëqyrjeje të tregjeve të sigurimeve dhe të pensioneve private. Është ngritur gjithashtu Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, i cili synon koordinimin e të gjitha aktiviteteve në këtë fushë.

Administrata dhe shërbimi publik janë në qendër të vëmendjes së politikave qeveritare. Zbatimi rigoroz i konkurseve për rekrutimin në administratën publike e ka rritur profesionalizmin e saj dhe ka pakësuar ndikimin e politikës në të. Është amenduar ligji për konfliktin e interesit që do të ndikojë në nxjerrjen e administratës jashtë konflikteve të interesit. Synimi është që të arrihet më shumë në kualifikimin dhe trajnimin e punonjësve për të krijuar një administratë publike të aftë për përmirësimin e reformave sektoriale.

2. Vizioni, përparësitë dhe qëllimet strategjike

Vizioni

Shqipëria është futur në një fazë të re zhvillimi dhe me perspektiva të qarta integrimi në strukturat euro-atlantike. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin European, si dhe vendeve të tij anëtare, përbën një moment historik drejt realizimit të këtij synimi madhor. Kalimi i Shqipërisë në grupin e vendeve me të ardhura mesatare për frymë është rezultat i reformave të 15 viteve të fundit, arritje të cilat duhen konsoliduar në përputhje me sfidat e reja që shtron stadi aktual i zhvillimit.

Në sajë të pozicionit të saj gjeografik, kapaciteteve njerëzore si dhe pasurive natyrore, Shqipëria ka një potencial të madh zhvillimi dhe avantazhe krahasuese. Afërsia me tregjet europiane dhe kushtet klimatike të favorshme janë faktorë pozitivë për sektorin e bujqësisë. Gjithashtu të qenit pjesë e korridoreve trans-nacionale të transportit e bëjnë Shqipërinë një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e tregtisë rajonale. Shqipëria është edhe një destinacion turistik tërheqës për shkak të bukurive natyrore dhe trashëgimisë të pasur kulturore.

Bazuar në arritjet e deritanishme dhe potencialet e rritjes së vendit, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim përcakton vizionin e mëposhtëm për shtatë vitet e ardhshme:

Një vend me nivel të lartë jetese, të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike, demokratik dhe garant të lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Periudha e tranzicionit, ndër të tjera, u karakterizua nga dukuria e emigracionit masiv si pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike e sociale të vendit. Përparimi i arritur në konsolidimin e shtetit demokratik dhe në funksionimin e ekonomisë së tregut nxitën zhvillimin shoqëror, përmirësuan kushtet e sigurisë në vend dhe krijuan premisat për një rigjallërim të shoqërisë shqiptare dhe të iniciativës private.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar kanë qënë fenomene negative që kanë shoqëruar vitet e tranzicionit, duke bërë që Shqipëria të renditet në nivele jo të mira nga vlerësimet ndërkombëtare për çështjet e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Shteti shqiptar duke zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë dhe duke respektuar parimet themelore të një vendi demokratik, do të jetë mbrojtës i të drejtave e lirive të qytetarëve/qytetareve dhe interesave të tyre. Garanci për këtë do të jetë qeverisja e mirë, e drejtë dhe e paanshme, si pengesa natyrore për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Konsolidimi i institucioneve kombëtare do të garantojë zbatimin e shtetit të së drejtës sipas një modeli ekonomik të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, dhe do të rrisë mundësitë për zhvillimin e biznesit, si dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Në një rend shoqëror të lirë, të zhvilluar dhe demokratik prona konsiderohet si një nga të drejtat themelore të njeriut. Zgjidhja e çështjeve të pronës do të jetë një garanci për vënien në vend të padrejtësive të së kaluarës, duke respektuar këtë të drejtë për çdo individ dhe familje shqiptare.

Thellimi i procesit të decentralizimit, modernizimi i sistemit të adresave e gjendjes civile dhe pajisja e qytetarëve me dokumente identiteti, sipas standardeve europiane, konsiderohen si kushtet kryesore për të konsoliduar demokracinë dhe për të ecur në rrugën e modernizimit.

Moszbatimi i ligjit bëhet pengesë për funksionimin e shoqërisë dhe i hap rrugën zhvillimit të informalitetit. Gjatë 15 viteve të fundit informaliteti në Shqipëri ka marrë forma të ndryshme, si: uzurpime arbitrare të tokës, ndërtime pa leje, aktivitete të paregjistruara, evazion fiskal. Lufta kundër këtyre dukurive përbën një nga kushtet më të rëndësishme për funksionimin e shtetit të së drejtës, për garantimin e lirisë së tregut dhe shanseve të barabarta.

Menaxhimi i dobët i shpenzimeve publike i cili sjell për pasojë çrregullime dhe vonesa në realizimin e investimeve, kërkon rritjen e efikasitetit dhe krijimin e një mjedisi inkurajues sipas parimeve të tregut

dhe partneritetit publik-privat. Realizimi i investimeve për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm me ujë, plotësimin e nevojave me energji elektrike dhe zhvillimin e rrjetit rrugor kombëtar do të ulë koston e sipërmarrjes dhe do të rrisë potencialet për një zhvillim ekonomik e shoqëror të balancuar.

Ofrimi i shërbimeve publike cilësore është një aspekt tjetër i rëndësishëm i nivelit të jetesës dhe garanton kohezionin social. Në sektorin e shëndetësisë, do t'i jepet zgjidhje problemit të financimit të shërbimit shëndetësor për të garantuar cilësinë e këtij shërbimi. Në sektorin e arsimit, treguesit e regjistrimit në shkollë dhe cilësia e mësimdhënies do të rriten. Politikat sociale do të orientohen drejt respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të administratës publike në shpërndarjen e shërbimeve ndaj publikut dhe angazhimi i saj në zbatimin e kësaj strategjie, është çelësi i suksesit që garanton përballimin e sfidës së integritetit evropian, si dhe pranimit në aleancën më të madhe të sigurisë në botë.

Realizimi i këtij vizioni, që shpreh aspiratat kombëtare, është përgjegjësi e të gjithë shqiptarëve.

Përparësitë dhe qëllimet strategjike

Për realizimin e vizionit të mësipërm janë përcaktuar përparësitë dhe qëllimet e mëposhtme deri në vitin 2013:

- Integrimi i vendit në BE dhe në NATO do të realizohet nëpërmjet:
 - Plotësimit të kushteve për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO dhe përmbushjes së të gjithë objektivave dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij;
 - Mundësimin të përfitimit të statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE brenda një periudhe kohore dyvjeçare;
 - Përmbushjes së plotë të standardeve për anëtarësim në BE.
- Zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve. Qeverisje e mirë, luftë ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integritetit të vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës.
 - Përfundimi i reformës **zgjedhore** me synim realizimin e zgjedhjeve vendore dhe parlamentare të lira e të drejta në përputhje me standardet europiane.
 - Sistemi i drejtësisë do të funksionojë në mënyrë të pavarur, transparente, të përgjegjshme dhe eficiente:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: zbatimi i ligjit mbi reformën në drejtësi me qëllim vlerësimin profesional dhe objektiv të gjyqtarëve e prokurorëve, forcimin e statusit të tyre, ndarjen e punës sipas numrit të çështjeve dhe vlerësimin e performancës; zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe përmirësimi i sistemit të teknologjisë së informacionit në gjyqësor, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për një menaxhim të integruar të informacionit në luftën kundër krimit të organizuar.
 - Në periudhën afatgjatë (2011- 2013) përparësitë janë: harmonizimi i ligjeve organike të sistemit të drejtësisë; konsolidimi i mekanizmave ndërinstitucionalë të bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme të gjyqësorit; përmirësime ligjore për garantimin e burimeve financiare dhe njerëzore të Shkollës së Magjistraturës dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme gjyqtarëve e prokurorëve; krijimi i gjykatave të specializuara, administrative dhe tregtare.
- Në vitin 2013, Shqipëria do të arrijë të njëjtat nivele me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitin e anëtarësimit të tyre në Bashkimin Evropian, për treguesin 'Shteti i së drejtës' të Institutit të Bankës Botërore, i cili mat "cilësinë e zbatimit të kontratave, cilësinë e policisë dhe të gjykatave, si edhe probabilitetin e kriminalitetit e të dhunës".
- Reforma e të drejtave të pronës do të transformojë tregun e tokës në një nxitës të madh të zhvillimit ekonomik.

- Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: përpilimi i hartës së vlerës së tokës, regjistrimi i pasurive shtetërore, legalizimi i zonave dhe ndërtimeve informale; regjistrimi fillestar në zonat urbane dhe ato që kanë përparësi zhvillimi, si dhe digjitalizimi i të dhënave në një pjesë të zyrave.
- Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: futja në rrugën e duhur të zgjidhjes përfundimtare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; integrimi i zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara; vazhdimi i regjistrimit me pyjet e kullotat dhe përfunimi i digjitalizimit të zyrave.
- **Korrupsioni** do të reduktohet në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme, do të forcohet integriteti i institucioneve dhe do të promovohen vlerat e mirëqeverisjes. Krijimi i një kulture antikorrupsion në qeverisje, politike dhe shoqëri mbetet synim madhor:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: zbatimi i rekomandimeve të raportit vlerësues të vitit 2005 nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Europës; përshtatja e legjislacionit të brendshëm me të gjitha standardet e vendosura nga konventat kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara; reduktimi progresiv i barrierave administrative; rritja e forcës zbuluese dhe ndëshkuese ndaj rasteve të korrupsionit.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: reformimi dhe forcimi i efektivitetit të sistemit të drejtësisë; krijimi i sistemeve efektive dhe transparente në shërbimet ndaj qytetarëve si shërbimi shëndetësor; konsolidimi i praktikave dhe sistemeve efektive në administratën tatimore dhe doganore, dhe në prokurimet.

Në vitin 2013 Shqipëria do të arrijë të njëjtat nivele me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitin e anëtarësimit të tyre në Bashkimin Europian, për treguesin 'Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit', i cili hartohet nga organizata ndërkombëtare e shoqërisë civile 'Transparency International'.

- **Rendi publik** do të forcohet nëpërmjet afrimit të policisë me komunitetin, si mënyra më e përshtatshme e veprimit në një shtet demokratik, dhe do të vazhdojë lufta ndaj krimit të organizuar. Synohet që deri në vitin 2013, Shqipërisë t'i akordohet statusi 'Tier 1' sipas Raportit për Trafikimin Njerëzor që botohet nga Departamenti i Shtetit dhe vlerëson përputhjen e aktivitetit të qeverisë me nivelet minimale të trafiqeve ilegale. Shqipëria do të ketë standarde të sigurisë sipas nivelit të vendeve të BE lidhur me uljen e kriminalitetit, rritjen e besimit të publikut tek policia dhe forcimin e zbatimit të ligjit në të gjitha fushat.
- **Administrata publike** do të jetë e aftë për të përballuar zhvillimin dhe integrimin e vendit, bazuar në meritokraci dhe profesionalizëm: do të zbatohet me përpikëri Ligji i Shërbimit Civil.
- Në procesin e **decentralizimit** do të ketë përputhje të plotë me parimet e Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore.
- Çdo qytetar që ka mbushur moshën 16 vjeç do të pajiset me kartën e identitetit të bazuar në **Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile**.
- **Arritja e një zhvillimi të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor.**
 - Përmirësimi i infrastrukturës së **transportit**, në veçanti transportit rrugor, duke mundësuar krijimin e një hapësire ekonomike të integruar:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: përfundimi i korridorit Durrës-Morinë; rritja e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare dhe vazhdimi i procesit të privatizimit; ndërtimi i terminalit të pasagjerëve në portin e Durrësit dhe privatizimi i shërbimeve tregtare, duke synuar rritje e autonomisë së portit.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: përfundimi i investimeve të mëdha në korridoret e rrugëve kombëtare Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim; rikonstruksioni i kalatës lindore dhe i shesheve për përpunimin e mallrave në portin e Durrësit.

Përveç kësaj deri në vitin 2013 do të rehabilitohen 6000 km rrugë rurale.

- o Zhvillimi i një sistemi **energjetik** sipas parimeve të ekonomisë së tregut, hapja dhe liberalizimi i tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimi i tij në tregun rajonal dhe atë Europian të energjisë. Rritja e kapaciteteve të prodhimit vendas të energjisë me synim plotësimin e kërkesës agregate për energji dhe duke synuar një prodhim me kosto sa me të ulët dhe me ndikim sa me minimal në mjedis:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: ndërtimi i termocentralit të Vlorës, rehabilitimi i termocentralit të Fierit dhe ndërtimi i hidrocentralit të Kalivaçit; ndërtimi i linjës 400 kV Elbasan-Podgoricë; ndërtimi i nënstacionit 400 kV në Tiranë; fillimi i punës për ndërtimin e hidrocentraleve të reja në kaskaden e lumit të Devollit dhe të Drinit; ndërtimi Qendres së Re Kombëtare Dispeçer; privatizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike; si dhe ristrukturimi dhe privatizimi i kompanive shtetërore në sektorin e naftës.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: vënia në punë e hidrocentraleve të kaskadës së Drinit dhe Devollit; nxitja e përdorimit me frytshmëri të energjisë sidomos në fushën e banesave; krijimin e një klimë të favorshme ligjore dhe institucionale për inkurajimin e përdorimit të burimeve të energjive të rinovueshme, kryesisht të paneleve diellore; dhe lidhja me rrjetin rajonal të naftës-jellësve dhe gazsjellësve.

Në vitin 2013, prodhimi vendas i energjisë elektrike do të japë më shumë se 8500 GWh në vit.

- o Sektori i **furnizimit me ujë dhe kanalizimeve** do të zhvillohet sipas standardeve të Bashkimit Europian, për rritjen e nivelit të jetesës, ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: zgjerimi i procesit të vendosjes së matësve për të përmirësuar menaxhimin e kërkesës për ujë; shërbimi i ujësjellësit do t'i kalojë qeverisjes vendore; do të bëhen marrëveshje (kontrata) shërbimi midis qeverisjes vendore dhe shërbimeve të ujësjellësit; ndërsa shpenzimet kapitale do të rriten në masën 30%.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: lehtësimi i pjesëmarrjes së sektorit privat në forma të avancuara; ... studimi që i paraprin procesit të rajonalizimit nëpërmjet bashkimit të kompanive për të përfituar nga ekonomitë e shkallës; subvencionimi vetëm i kompanive që plotësojnë kushtet e cilësisë së shërbimit dhe performancës financiare; si dhe përgatitja e një programi investimesh kapitale afatmesëm bazuar në master-planin kombëtar.

Deri në vitin 2013 synohet që përqindja e popullsisë, e cila përfiton shërbimet e mëposhtme të jetë: (a) furnizimi me ujë: 95%; (b) kanalizimet: 83%; (c) trajtimi i ujërave të përdorura: 45%

- o **Mjedisi** do të mbrohet nga ndotja dhe degradimi:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: përdorimi i karburantit që plotëson standardet europiane dhe kryerja e testeve të detyrueshme për shkarkimin e gazrave; ndërtimi i 5 landfillleve rajonale; dhe përfundimi i dosjeve të projekteve për të gjitha zonat e nxehta.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: zbatimi i një sistemi kombëtar për monitorimin e cilësisë së ajrit në përputhje me standardet europiane; ndërtimi i vend-depozitimeve sanitare për heqjen e mbetjeve në nivel vendor; mbyllja e vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane dhe rehabilitimi i terrenit të ndotur në të gjitha zonat e nxehta të identifikuar.

Në vitin 2013 synohet që cilësia e ajrit në Tiranë dhe në qytetet e mëdha të plotësojë standardet e Bashkimit Europian.

- o Do të mbahet një **rritje ekonomike** mesatare më të lartë se 6% në vit dhe me tendencë rritëse duke arritur në 7%.

- **Stabiliteti makroekonomik** do të ruhet nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm fiskal, uljes së vazhdueshme të borxhit të brendshëm, përmirësimit të balancës korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare.
- Niveli i taksave do të ulet dhe do të ruhet niveli 27-28% i PBB-së të të ardhurave publike, krahas reduktimit të informalitetit dhe mirëadministrimit të sistemit fiskal.
- Do të krijohet një klimë biznesi e favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: fuqizimi i kapaciteteve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të konsoliduar procesin e regjistrimit të bizneseve; reforma e sistemit të licensimit do të ndjekë parimet e OECD-së për cilësinë rregullatore; krijimi i fondit shtetëror të garantimit të kredive të eksportit; fillimi i projekteve të investimeve në zbatim të ligjit të koncesioneve; dhe krijimi i parkut të parë industrial.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: lufta kundër informalitetit për të siguruar konkurrencë të ndershme; vazhdimi i zbatimit të Kartës Europiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme; ndërtimi i institucioneve shtetërore dhe private për vlerësimin e certifikimit dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve; si dhe ndërtimi i qendrave të përpunimit të eksporteve.

Në vitin 2013 Shqipëria do të arrijë të njëjtin nivel me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitin e anëtarësimit të tyre në Bashkimin Europian, për treguesin 'Doing Business', i cili është hartuar nga Banka Botërore.

- Funksionimi i tregut të punës, do të lehtësohet nëpërmjet përmirësimeve në shërbimin e punësimit, zbatimit të programeve aktive e pasive dhe formimit e trajnimit profesional: niveli i papunësisë do të jetë më pak se 10% sipas Anketës për Krahun e Punës, e cila është bërë nga INSTAT.
- Niveli i varfërisë për person do të reduktohet dhe do të bjerë nën 10% deri në vitin 2013, në përputhje me indikatorët e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës, që është bërë nga INSTAT.
- Do të hartohet një kuadër ligjor i plotë për **politikën sociale** për të siguruar mbrojtjen e duhur për të gjithë qytetarët; do të garantohet përfshirja e individëve dhe familjeve të varfëra në skemën e ndihmës ekonomike dhe programe të tjera sociale dhe do të plotësohen më mirë nevojat e përfituesve nga këto programe.
- Do të krijohen **mundësi të barabarta** për gratë dhe burrat në jetën ekonomike, politike dhe sociale, ndërsa dhuna në familje do të parandalohet: do të rritet shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.
- Do të ristrukturohet dhe reformohet sistemi ekzistues i **pensioneve**, dhe do të kalohet, në mënyrë graduale, drejt një sistemi shumëshyllës të pensioneve.
- Sistemi **shëndetësor publik** do të ofrojë shërbime bazë për të gjithë, cilësore dhe efikase, përmes përmirësimit të menaxhimit dhe nxitjes së inicativës private:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: krijimi i kushteve për të inkurajuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore nga sektori privat; krijimi i një pakete shërbimesh, e cila do t'u ofrohet falas të gjithëve; ndërsa një blerës i vetëm strategjik do të përqendrojë në mënyrë të baraspeshuar të gjitha vendimet për ndarjen e burimeve publike.
 - Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: përmirësimi i menaxhimit të institucioneve të ofrimit të shërbimit shëndetësor e të skemave klinike; përgatitja e një kuadri rregullator më të qartë në lidhje me përgjegjshmërinë ndaj qytetarëve.

Në vitin 2013 shkalla e vdekshmërisë foshnjore do të ulet në 5 vdekje për 1000 lindje të gjalla

- Do të sigurohet një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe në funksion të përmbushjes së kërkesave të ekonomisë së tregut:
 - Në periudhën afatmesme (2007-2010) përparësitë janë: zbatimi i politikave të dyfishimit të pagës së personelit; vazhdimi i transferimit të përgjegjësisë dhe autoritetit

vendimmarrës nga niveli qendror në nivelin lokal të qeverisjes dhe forcimi i tij; zhvillimi i një politike të re të formimit dhe zhvillimit profesional që u përgjigjet kërkesave të tregut; përmirësimi i nivelit të vlerësimit të nxënësve nëpërmjet reformimit të maturës shtetërore dhe provimeve të lirimit.

- Në periudhën afatgjatë (2011-2013) përparësitë janë: futja e vitit përgatitor para-shkollor i cili synon rritjen e aftësisë për shkollë të fëmijëve të vegjël; përmirësimi i skemës së financimit mbështetur në numrin e nxënësve, duke mënjanuar dallimet rajonale dhe rritur aksesin; përfundimi i procesit të dhënies së autonomisë së universiteteve duke forcuar mekanizmin e llogaridhënies së jashtme dhe transparencën e menaxhimit të brendshëm.

Në vitin 2013 shkalla neto e rregjistrimit në arsimin e mesëm do të rritet deri në 76% ndërsa përqindja e tërheqjes në arsimin e mesëm parashikohet të jetë në masën 86%.

- Do të zbatohet një model i ri **planifikimi hapësinor**, gjithëpërfshirës dhe i integruar, që do të garantojë menaxhimin dhe kontrollin mbi territorin në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe nxitjes së turizmit.
- Do të zbatohet një politikë e integruar dhe koherente me qëllim **zhvillimin rajonal** të balancuar dhe pakësimin e pabarazisë midis rajoneve.
- Do të konsolidohen skemat mbështetëse shtetërore për **zhvillimin bujqësor dhe rural** në përputhje me praktikën e BE, me synim mbështetjen dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit në këtë fushë, dhe do të ngrihet Agjensia e Pagesave. Gradualisht do të futen sistemet moderne të sigurisë ushqimore dhe do të konsolidohen institucionet që garantojnë standardet e saj.

3. Politikat

Në këtë kapitull bëhet një renditje e politikave të SKZHI-së pak a shumë sipas përparësisë strategjike. Çdo seksion i korrespondon një strategjie sektoriale dhe ndërsektoriale të vendosur nga Komiteti i Planifikimit Strategjik sikurse tregohet më poshtë.

Strategjia sektoriale	Përgjegjësia institucionale
Mbrojtja (Plani afatgjatë i zhvillimit të Forcave të Armatosura)	Ministria e Mbrojtjes
Punët e jashtme	Ministria e Punëve të Jashtme
Drejtësia	Ministria e Drejtësisë
Rendi publik (Strategjia 7-vjeçare e Policisë së Shtetit)	Ministria e Brendshme
Gjendja civile	Ministria e Brendshme
Transporti	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Energjia	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Financat publike	Ministria e Financave
Ekonomia (Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve)	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Punësimi	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Sportet	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Mbrojtja sociale	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Sigurimet shoqërore	Ministria e Financave
Shëndetësia	Ministria e Shëndetësisë
Arsimi bazë	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Arsimi I lartë	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Planifikimi hapësinor	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Bujqësia dhe ushqimi	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve
Turizmi (Strategjia e zhvillimit të turizmit)	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Kultura	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Statistikat (Programi kombëtar 5-vjeçar i statistikave zyrtare)	INSTAT
Strategjia ndërsektoriale	
Të drejtat e pronës	Ministria e Drejtësisë
Anti-korrupsioni dhe qeverisja transparente	Këshilli i Ministrave
Menaxhimi i integruar i kufijve	Ministria e Brendshme
Migracioni	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit	Ministria e Brendshme
Administrata publike	Ministria e Brendshme
Decentralizimi	Ministria e Brendshme
Mjedisi	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbikëqyrja e tregut	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Rinia	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës në familje	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Përfshirja sociale	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Zhvillimi rajonal	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Zhvillimi rural	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve

3.1 INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN DHE NË NATO

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin European dhe në NATO kërkon një punë të përbashkët nga të gjitha institucionet qeveritare dhe gjithë politikat e përmendura në këtë kapitull i shërbejnë drejtpërdrejt arritjes së këtij objekti strategjik të dyfishtë. Në këtë pjesë të kapitullit jepen objektivat kryesorë në lidhje me procesin e anëtarësimit.

Integrimi në Bashkimin European

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është instrumenti i cili do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin European. Marrëveshja krijon kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor, rritjen e efikasitetit të tij, ndihmon reformat institucionale dhe ekonomike me qëllim rritjen e standardeve të jetesës për të gjithë shtetasit. Me anë të kësaj marrëveshjeje Shqipëria synon arritjen e standardeve, të cilat do të garantonin statusin e saj si vend kandidat dhe më pas asociimin në Bashkimin European. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit i njeh Shqipërisë dhe shtetasve të saj si detyrime ashtu edhe të drejta, ndër të cilat mund të përmenden:

- **Respektimi i shtetit të së drejtës dhe i demokracisë, i të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, si dhe i rregullave të një ekonomie tregu të lirë:** Respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut, i shtetit ligjor dhe i lirive ekonomike do të përbëjë bazat e politikave të shtetit shqiptar. Ky detyrim vlerësohet si klauzolë thelbësore e marrëveshjes, shkelja e së cilës mund të përligjë masa që shkojnë deri në pezullim ose anulim të marrëveshjes.
- **Bashkëpunimi rajonal në favor të stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik:** Bashkëpunimi rajonal përmban forcimin e marrëdhënieve politike dhe ekonomike me anë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit tonë në të gjitha fushat që mbulon marrëveshja. Ky instrument do të mundësojë kështu forcimin e zhvillimit ekonomik në rajon, duke zbatuar rregullat europiane të një tregu të hapur dhe të konkurrencës së lirë.
- **Krijimi i një zone tregtie të lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit European:** Lëvizja e lirë e mallrave së bashku me dispozitat që parashikojnë lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve, përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë european dhe bashkëpunimin në disa fusha përparësore për zhvillimin ekonomik e social të vendit, hapin rrugën drejt krijimit në të ardhmen të një tregu të përbashkët mes Shqipërisë dhe Bashkimit European.
 - *Zona e tregtisë së lirë Shqipëri-BE:* Për vendosjen hap pas hapi të një zone tregtie të lirë ku mallrat qarkullojnë lirshëm, palët (Shqipëri-BE) në bazë të MSA-së zotohen të heqin detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to, të ndalojnë vendosjen e barrierave të reja tregtare, si dhe të respektojnë parimin e mosdiskriminimit në fushën fiskale ndërmjet mallrave të palëve kontraktuese.
 - *Lëvizja e lirë e personave, shërbimeve dhe kapitaleve:* Në bazë të marrëveshjes një shtetas shqiptar do të mund të lëvizë lirshëm në territorin european, në qoftë se ai ushtron të drejtën e lëvizjes ose të drejtën e vendosjes në një nga shtetet anëtare të BE dhe anasjelltas.

(a) *Lëvizja e lirë e punëtorëve.* MSA parashikon parimin e trajtimit kombëtar, sipas të cilit punëtori shqiptar, ligjërisht i punësuar në territorin e një shteti anëtar të BE, duhet të trajtohet njësoj si shtetasi i po këtij shteti anëtar të BE përsa u përket kushteve të punës, të pagës ose të pushimit nga puna. Për më tepër, bashkëshorti dhe fëmijët e një punëtori të punësuar ligjërisht në territorin e një shteti anëtar, kur ata banojnë ligjërisht në këtë shtet, kanë të drejtën e arsimimit dhe pjesëmarrjes në tregun e punës së këtij shteti anëtar gjatë periudhës së qëndrimit profesional të autorizuar të punëtorit. Por mundësia për punësim e punëtorëve shqiptarë në tregun european është e kufizuar, pasi mbetet nën vullnetin e shteteve anëtare të BE, të cilat do të njohin lirinë e lëvizjes së punëtorëve me anë të marrëveshjeve të dyanshme që nënshkruhen me Shqipërinë.

(b) *E drejta e vendosjes.* E drejta e vendosjes, e cila lidhet drejtpërdrejt me investimet e huaja, realizohet me anë të ushtrimit të një aktiviteti afatgjatë profesional nga një shtetas shqiptar në një vend anëtar të BE si i vetëpunësuar, ose duke krijuar apo drejtuar një ndërmarrje. Dispozitat e MSA-së u njohin të drejtën e vendosjes edhe shoqërive nëpërmjet ngritjes së tyre, apo nëpërmjet vendosjes së degëve ose filialeve të shoqërive në territorin

europian ose shqiptar.

(c) *Liria e ofrimit të shërbimeve*. Liria e ofrimit të shërbimeve është një mundësi që do t'i njihet çdo shtetasi shqiptar në mënyrë të përkohshme në territorin europian ose në territorin e tij pranë shtetasve të BE. Liria e ofrimit të shërbimeve nënkupton edhe lehtësimin dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve nga shoqëritë komunitare ose personat fizikë me një trajtim jo më pak të favorshëm se ai vendas në Republikën e Shqipërisë.

(d) *Kapitalet dhe pagesat*. Shqipëria dhe BE duhet të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitaleve lidhur me investimet direkte, investimet në përgjithësi, si dhe kreditë lidhur me transaksionet tregtare. Gjithashtu në kuadër të realizimit të kësaj lirie, pala Shqiptare ka marrë zotimin të fillojë procedurat e garantimit të së drejtës së shtetasve të vendeve anëtare të BE për të blerë pasuri të paluajtshme në Shqipëri, brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e MSA.

- **Adoptimi i *acquis communautaire***: Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm europian me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë. Ky përafrim i legjislacionit parashikohet të bëhet në dy faza 5-vjeçare sipas një programi të detajuar, i cili përditësohet duke marrë parasysh realizimin e objektivave si dhe vetë ndryshimet në të drejtën Komunitare. Versioni më i fundit është Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili u miratua në shtator të vitit 2007.
- **Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme dhe politika të tjera sektoriale**: Bashkëpunimi në fushat e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme ka si qëllim krijimin e garantimit e kriterëve të Kopenhagen mbi lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Ky bashkëpunim kërkon që Shqipëria të forcojë institucionet në çdo nivel, por në veçanti ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Pikat kyçe të këtij bashkëpunimi fokusohen në regjimin e vizave, azilit dhe migracionit, dhe në luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit. Lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë në hapësirën europiane është e lidhur ngushtësisht me përparimin e arritur në këto fusha. Bashkëpunimi në politika të tjera sektoriale me natyrë ekonomike dhe shoqërore ka si objekt përkrahjen dhe zhvillimin e shtetit të asociuar dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike ekzistuese midis palëve.
- **Bashkëpunimi financiar**: Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon akordimin e një ndihme financiare për shtetin shqiptar, me qëllim mbështetjen për realizimin e objektivave të vendosur nga marrëveshja. Bashkëpunimi financiar do të mund të mbështesë reformat ekonomike dhe institucionale në përputhje me kërkesat e Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Kushtet për anëtarësim shkojnë përtej punës së parashikuar në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Shqipëria do të përfitojë nga përvoja e zgjerimit të Bashkimit Europian me anëtarësimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore për të negociuar pozitën e saj në lidhje me periudhën kalimtare të nevojshme për disa nga fushat e 'acquis'-it. Kjo do të kërkojë një vlerësim në thellësi të efektit të adoptimit të disa fushave të 'acquis' për të caktuar cilat janë me përparësi kërkesat për periudhat e tranzicionit. Një studim ka përcaktuar bujqësinë, lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të forcës së punës, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, sigurinë ushqimore, politikat veterinarë e fito-sanitare, si dhe mjedisin, si fushat që vendet e tjera i kanë patur shumë të vështira për t'i negociuar². Ky negociim është pjesë e procesit 'screening' [radiografimit], i cili do të fillojë mbas marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim.

Ministria e Integritimit Europian është institucioni përgjegjës për orientimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e masave për zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të Instrumentit të Asistencës së Para-aderimit.

² Enlargement of the European Union: an analysis of the negotiations for the countries of the Western Balkans, Studimi SIGMA nr.37, shkurt 2007

Integrimi në NATO

Integrimi në NATO është një nga synimet më të rëndësishme të politikës të jashtme të vendit, i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, i Strategjisë Ushtarake dhe i Planit të Zhvillimit Afatgjatë të Forcave të Armatosura 2007-2020. Ky objektivi përbën një projekt kombëtar madhor, që ka përkrahjen e të gjitha forcave politike të vendit dhe gjithashtu të më shumë se rreth 90% të publikut. Shqipëria po bën të gjitha përpjekjet për të përmbushur të gjitha kriteret për marrjen e ftesës për anëtarësim, në samitin e ardhshëm të Aleancës në pranverë të vitit 2008 dhe për të qenë anëtare me të drejta të plota brenda vitit 2010.

Zbatimi i Programeve Kombëtare Vjetore në kuadër të MAP-it ashtu edhe pas marrjes së ftesës për anëtarësim, në kuadrin e reformave të mëtejshme është përparësi për të gjitha nismat dhe reformat, që qeveria do të ndërmarrë në sektorët e përfshirë në këtë plan. Reforma elektorale, konsolidimi i institucioneve, i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës, në veçanti lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të vazhdojnë të jenë në fokusin e reformave të qeverisë, duke pasur një efekt të drejtpërdrejtë në procesin e anëtarësimit. Integrimi në NATO do të shërbejë si një garanci për të tërhequr investimet e huaja dhe do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik me ritme të larta të vendit, duke krijuar kushtet e favorshme për anëtarësimin e mëtejshëm në Bashkimin Evropian. Kjo strategji e konsideron anëtarësimin si një sfidë që duhet përballuar me sukses, si në aspektin e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe në aspektin ekonomik dhe veçanërisht të infrastrukturës.

Përsa i përket reformës në fushën e mbrojtjes, Forcat e Armatosura janë përfshirë në një varg transformimesh të thella e të rëndësishme. Qeveria po garanton mbështetjen maksimale politike, financiare dhe çdo mbështetje tjetër për realizimin e reformave në Forcat e Armatosura. Qeveria përmbushi angazhimin për sektorin e mbrojtjes duke arritur në shifrën 2 përqind të PBB-së, në vitin 2008 dhe do të mbahet në këtë shifër edhe në vitet në vijim.

Shqipëria ka rritur kontributin e saj në misionin ISAF të drejtuar nga NATO-ja në Afganistan me një kompani më tepër në mesin e vitit 2007, si dhe do të vijojë kontributi i Ekipit të Përbashkët Mjekësor në ISAF, në kuadër të Kartës së Adriatikut. Gjithashtu Shqipëria do të vazhdojë të japë ndihmesën e saj në misionet 'Liria e Irakut', në kuadër të misionit ALTHEA të BE në Bosnje-Hercegovinë me një ekip EOD-je, si dhe me vëzhgues në UNOMIG, në Gjeorgji. Në Mesdhe, Shqipëria ka zyrtarizuar pjesëmarrjen në operacionin 'Active Endeavour' të NATO-s. Pjesëmarrja në misionet dhe operacionet e NATO-s do të bazohet në zhvillimin e Elementit të Mbështetjes Kombëtare dhe të Mbështetjes së Vendit Pritës.

Mbrojtja

Sfidat

Strategjia për Sigurinë Kombëtare, në përputhje me Kushtetutën është dokumenti themelor i cili pasqyron politikën e shtetit për mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve nga rreziqet dhe kërcënimet e jashtme e të brendshme.

Strategjia Ushtarake përcakton se si do të veprojnë komponentët ushtarakë për të mbështetur strategjinë për sigurinë kombëtare dhe se si do të përmbushin misionet që u janë caktuar.

Strategjia sektoriale e Zhvillimit të Forcave të Armatosura jep drejtimet kryesore të zhvillimit dhe transformimit të Forcave të Armatosura në vitet e ardhshme, përcakton objektivat dhe orienton zhvillimin e kapaciteteve operacionale të nevojshme për përmbushjen e misioneve kombëtare dhe të kërkesave të integritit në NATO.

Sfidat në sektorin e mbrojtjes kanë të bëjnë me thellimin e mëtejshëm të reformës, konsolidimin e strukturës së re dhe zbatimin e konceptit "joint", kthimi i Forcave të Armatosura në një forcë tërësisht profesioniste, modernizimi i Forcave të Armatosura dhe rritja e ndërveprimit me NATO-n, pjesëmarrja aktive në misionet kombëtare dhe ndërkombëtare duke siguruar Elementin e Mbështetjes Kombëtare, kapacitetet e Mbështetjes së Vendit Pritës, si dhe rritjen e eficiencës së bashkëpunimit rajonal, duke u orientuar në realizimin e projekteve të përbashkëta konkrete.

Vizioni i sektorit

Forcat e Armatosura janë nën kontrollin demokratik civil dhe angazhohen për kryerjen e misionit kushtetues: ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtjen dhe

mbështetjen e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë. Përbushja e këtij misioni do të jetë thelbi i transformimit të Forcave të Armatosura, i cili do të realizohet brenda kuadrit të mbrojtjes kolektive.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Forcat e Armatosura kanë tri përparësi strategjike të mëposhtme:

- vazhdimin e transformimit të Forcave të Armatosura në një forcë plotësisht profesioniste brenda vitit 2010, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe modernizimin e saj për të përmbushur cilësisht detyrat kryesore të misionit të saj
- shndërrimin e Forcave të Armatosura në një forcë ushtarake, më të vogël në numër, por më efikase, të pajisur mirë dhe të mirëstërvitur, me aftësi ndërvepruese me Forcat e Armatosura të vendeve aleate dhe partnere, si dhe me realizimin e kapaciteteve niche (specifike), për të qenë sa më të vlefshme në misionet e paqes të drejtuara nga NATO, BE, OKB apo të koalicioneve të ndryshme; në veçanti, 8% e njësive operacionale të komponentit tokësor të Komandës të Forcës të Bashkuar të jetë e dislokueshme njëherësh, dhe 40% e këtij komponenti të ketë kapacitete të dislokueshme
- konsolidimin e strukturave në realizimin tërësor të **Objektivave të Partneritetit** dhe rritjen e kontributit real në NATO

Mbështetur në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2007-2020, Qeveria do të:

- zhvillojë dhe mbështesë stafin përmes konsolidimit të sistemit modern të menaxhimit të personelit për të përmirësuar rekrutimin, trajnimin, karrierën dhe trajtimin e personelit ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura
- përmirësojë trajnimin për të rritur profesionalizmin dhe nivelin e përgatitjes
- modernizojë sistemet e pajisjeve, siç janë sistemi i vëzhgimit të hapësirës detare dhe ajrore; sistemi i komandimit, kontrollit, komunikimit, kompjuterëve dhe informacionit (C4I); helikopterët; mjetet lundruese patrulluese; pajisjet individuale, infrastruktura stërvitore, qendrat e simulimit, mjetet lëvizëse; si dhe pajisje që sigurojnë ndërveprimin me NATO-n
- modernizojë sistemin logjistik të integruar për mbështetjen e Forcave të Armatosura
- sigurojë mbrojtjen jo vetëm të forcave të veta ushtarake, por edhe të popullsisë civile
- synojë rritjen e ndërveprueshmërisë me NATO-n, nëpërmjet rritjes së nivelit operacional të njësive përparësore dhe reparteve në dispozicion të NATOs
- bashkëpunojë me NATO-n dhe me vendet e rajonit për menaxhimin e hapësirës ajrore dhe do të vazhdojë projektin e menaxhimit të hapësirës detare
- vlerësojë repartet të përcaktuara si kontribut për NATO-n sipas Konceptit të Kapaciteteve Operacionale (OCC)
- përgatitë personelin për plotësimin e vendeve që do të ofrojë Aleanca në shtabet e saj, si dhe do të sigurojë një performancë cilësore të tyre në këto shtabe pas anëtarësimit
- zhvillojë kapacitete për të mbështetur integrimin e vendit në BE nëpërmjet zhvillimit të konceptit të një set-i të vetëm forcash
- investojë në infrastrukturë, sidomos në objektet e kazermave dhe garnizoneve kryesore, dhe në menaxhimin logjistik të shërbimeve e të mirëmbajtjes
- angazhohet në bashkëpunimin ushtarak me të gjitha vendet e Aleancës, në interes të transformimit të Forcave të Armatosura dhe mbi bazën e partneritetit

Punët e jashtme

Sfidat

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. Në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë

partnerët ndërkombëtarë, Ministria e Punëve të Jashtme pasqyron zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbron interesat kombëtarë, si dhe punon për të mbrojtur e përfaqësuar interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Politika e jashtme shqiptare është kryesisht e orientuar në ato drejtime të cilat përbëjnë jo vetëm objektivat më madhorë të shtetit shqiptar, por edhe dosjet më parësore të punës së institucionit, të cilat janë:

- marrja e ftesës për anëtarësim në NATO gjatë pranverës së 2008 deri në anëtarësimin e plotë të vendit në këtë organizatë
- përshpejtimi i procesit të integritit evropian nëpërmjet ratifikimit të MSA nga të gjitha vendet anëtare
- mbështetja e procesit të njohjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në kuadër të forcimit të gjithanshëm të marrëdhënieve dy e shumëpalëshe në rajon, në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal
- përmirësimi i vazhdueshëm i imazhit të vendit në funksion të rritjes së marrëdhënieve ekonomike me vendet e tjera, duke ndikuar në rritjen e investimeve të huaja në vend
- reformimi i sistemit të Shërbimit të Jashtëm dhe përmirësimi i shërbimit publik të Ministrisë së Punëve të Jashtme

Vizioni i sektorit

Anëtarësimi në NATO realizon objektivat tanë të sigurisë kombëtare e rajonale dhe përbën një stimul të fuqishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e reformës së forcave të armatosura, si dhe zhvillimeve të tjera pozitive në fushat politike, ekonomike dhe ushtarake. Ai forcon rolin e Shqipërisë si kontribues i drejtpërdrejtë në fushën e sigurisë ndërkombëtare.

Vazhdimi me sukses dhe përshpejtimi i procesit të integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

Mbështetja e Republikës së Kosovës, fuqizimi i faktorit shqiptar në rajon dhe zbatimi në vazhdimësi i një politike rajonale të fqinjësisë së mirë.

Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të Jashtëm dhe administratës publike në fushën e marrëdhënieve me jashtë.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike janë:

- **Anëtarësimi në NATO:**
 - Vazhdimi i zbatimit të planit të masave të posaçme të miratuar për këtë qëllim, i cili ka në qendër mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme intensive, në të gjitha nivelet, me të gjithë aktorët kryesorë, duke paraqitur ecurinë e zhvillimeve tërësore në vend dhe në veçanti ato aspekte për të cilat partnerët tanë janë veçanërisht të interesuar.
 - Ministria e Punëve të Jashtme do të vazhdojë të koordinojë veprimtarinë shtetërore me jashtë në këtë aspekt dhe në të njëjtën kohë, do të jetë përçuese e mesazheve, qëndrimeve të partnerëve tanë, duke propozuar gjithnjë masat përkatëse për më tej.
- **Integrimi në Bashkimin Evropian:**
 - Vazhdimi i përpjekjeve intensive pranë të gjitha kancelarive evropiane për përmbylljen e procesit të ratifikimit të MSA-së nga të gjitha vendet anëtare të BE, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2008.
 - Angazhimi intensiv në dialogun për liberalizim të lëvizjes me Bashkimin Evropian që do të hapet në vitin 2008 dhe do të bëjë përpjekjet e nevojshme për ta vënë atë në jetë sa më parë.
 - Zgjerimi i kuadrit të bashkëpunimit ekonomik e tregtar me vendet e BE, me synim të veçantë rritjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri.
 - Zgjerimi i pranisë së saj në vende të tjera të BE ku ajo nuk është e përfaqësuar dhe ku ka interesa imediate dhe afatmesme politike e ekonomike, me qëllim rritjen e pranisë sonë, shtimin e pranisë së dukshme të Shqipërisë dhe shqiptarëve në Bashkimin Evropian për

përmirësimin e imazhit dhe përfaqësimin e drejtpërdrejtë të vlerave dhe interesave të vendit e shtetasve tanë.

▪ **Politika rajonale:**

- Mbështetja e çdo nisme, iniciative apo zhvillimi në dobi të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal.
- Ndërtimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve të ngushta bashkëpunimi dy e shumëpalëshe me të gjitha vendet e rajonit, në mënyrë të veçantë me Republikën e Kosovës, përfshirë nëpërmjet dhënies së ndihmës së drejtpërdrejtë ku të jetë e nevojshme.
- Mbështetja e faktorit shqiptar në vendet ku ata jetojnë, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tyre legjitime.
- Nënshkrimi i një Traktati të Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit.

▪ **Forcimi i kapaciteteve:**

- Miratimi i ligjit të ri për Shërbimin e Jashtëm, i cili synon përmirësimin cilësor të strukturave të Shërbimit të Jashtëm, të procedurave të rekrutimit, të trajnimit, të karrierës diplomatike si dhe një përcaktim më të sakët të të drejtave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm.
- Zgjerimi i përfaqësimit diplomatik të vendit në rajone ku Shqipëria nuk është e përfaqësuar dhe ku, në bazë të zhvillimeve gjeopolitike, janë përfutur interesa imediate dhe afatmesme politike e ekonomike, me qëllim rritjen e pranisë tonë, shtimin e pranisë së dukshme të Shqipërisë, përmirësimin e imazhit dhe përfaqësimit e drejtpërdrejtë të vlerave dhe interesave të vendit e shtetasve tanë.
- Hapja e disa qendrave të kulturës shqiptare si mjete të rëndësishme për njohjen e vendit, kulturës dhe trashëgimisë së shoqërisë shqiptare.
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së shërbimeve konsullore për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, duke rritur edhe cilësinë e informacionit për shtetasit shqiptarë që udhëtojnë jashtë vendit.
- Mbështetja dhe forcimi i diasporës shqiptare, duke përfshirë organizimin e kongresit të diasporës, si dhe mbështetjen e çeljes së shkollave të mësimi plotësues në gjuhën shqipe.

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Punëve të Jashtme ka një rol parësor për të garantuar që politikat tona të jenë e të zbatohen në përputhje të plotë me parimin e paqes dhe stabilitetit, bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Për më tepër, ky është fokusi kryesor i qeverisë për zhvillimin e dialogut politik (Titulli II).

3.2 DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS

Përparimi i arritur në lidhje me vendosjen e demokracisë ka qenë rezultat i angazhimit të qytetarëve shqiptarë, si dhe i mbështetjes konstruktive nga ana e partnerëve ndërkombëtarë. Megjithatë, rastet e shumta të shkeljes së të drejtave të individit kanë bërë që qytetarët ta humbasin besimin te institucionet shtetërore. Qeveria ka si synim rivendosjen e transparencës dhe ofrimin e një programi të gjerë reformash institucionale të orientuara drejt standardeve europiane për ta konsoliduar sistemin demokratik dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut.

Zgjedhjet e lira e të drejta do të jenë burimi i vërtetë i legjitimitetit të institucioneve demokratike. Kthimi i besimit të publikut tek zgjedhjet është një përparësi absolute. Për këtë qëllim, do të përfundohet reforma zgjedhore në klimën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me të gjitha forcat politike, si dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe me kontributin e të gjithë aktorëve të tjerë të shoqërisë.

Një rëndësi madhore do të ketë garantimi i lirisë së shprehjes dhe i mediave, duke synuar garantimin e lirisë së shtypit, mbrojtjen e tij në ushtrimin e misionit për informimin e publikut, marrëdhënie të mira midis shtypit, publikut të gjerë dhe organeve shtetërore, si dhe marrëdhënie të mira midis

gazetarëve dhe organeve drejtuese të medias së shkruar. Pjesëmarrja aktive e organizatave jo qeveritare dhe të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes do të inkurajohet edhe më shumë.

Gjithashtu, qeveria do të angazhohet për të arritur dhe zbatuar standardet më të larta të respektimit dhe realizimit të të drejtave të gjithë minoriteteve që jetojnë në Shqipëri. Të gjithë hapat dhe nismat që do të ndërmerren do të synojnë zbatimin dhe përputhshmërinë e plotë me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare", të ratifikuara nga Shqipëria.

Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Drejtësia

Sfidat

Gjatë periudhës së tranzicionit, Shqipëria iu përshtat koncepteve të reja për pushtetin gjyqësor dhe zbatoi një legjislacion modern, shumë të ndryshëm nga ai i mëparshmi. Me gjithë këto ndryshime, sistemi i drejtësisë nuk mund t'i shpëtonte ndikimit të faktorëve nga jashtë, veçanërisht atij politik. Edhe pse drejtësia u shpall e pavarur nga politika, ndërhyrjet e saj në të kanë qenë të shumta. Sistemi i drejtësisë është sektori më pak i kontrolluar dhe vlerësohet si sektori me nivelin më të lartë të korrupsionit, duke qenë se asnjë gjyqtar apo prokuror nuk është burgosur, ndryshe nga sektorët e tjerë. Reformimi i sistemit të drejtësisë është një domosdoshmëri që theksohet në mënyrë të vazhdueshme edhe nga vëzhguesit e huaj, sidomos Komisioni European, i cili në objektivat afatshkurtër të Partneritetit European thekson "finalizimin, adoptimin dhe zbatimin e ligjit të reformës në drejtësi". Gjithashtu, përmes raporteve të tij periodike, Komisioni European sugjeron që përmirësimet në sistemin gjyqësor duhet të përqendrohen në:

- marrëdhëniet me institucionet e pavarura gjyqësore, duke përfshirë edhe sqarimin e kompetencave përkatëse midis inspektorateve gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë
- riorganizimin e gjykatave në funksion të rritjes së efikasitetit dhe transparencës në gjykim, si dhe ofrimit të hapësirës, pajisjeve dhe rrjeteve kompjuterike të mjaftueshme
- fuqizimin e statusit, pavarësisë dhe mbrojtjes kushtetuese të gjykatësve e prokurorëve dhe ecurinë e trajnimit të tyre, marrjes në punë, caktimit të çështjeve dhe vlerësimit të punës së tyre
- transparencën e proceseve gjyqësore civile dhe penale përmes publikimit të vendimeve të gjykatës dhe rezultateve të kontrollit të bërë për të parë nëse ka pasur shkelje të procedurës
- ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, i cili mbetet në nivel të ulët, sidomos për ato çështje në të cilat shteti është i detyruar të dëmshpërblejë qytetarët
- sistemin e vuajtjes së dënimit, burgjet dhe qendrat e paraburgimit, të cilat vlerësohen më poshtë se standardet europiane

Vizioni i sektorit

Vizioni është funksionimi i një sistemi drejtësie i pavarur, transparent, i përgjegjshëm dhe efikas me qëllim rikthimin e besimit të qytetarëve në ndershmërinë dhe paanësinë e vendimeve gjyqësore. Qëllimi përfundimtar është sjellja e sistemit të drejtësisë në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit European.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Reforma në sistemin e drejtësisë përfshin riorganizimin institucional si dhe reformën e mentaliteteve, me qëllim përmirësimin e mangësive të konstatuara deri më sot dhe rritjen e frytshmërisë së sistemit. Këta objektiva kërkojnë përpjekje të vazhdueshme financiare dhe njerëzore për mirëfunksionimin e sistemit, garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, rritjen e përgjegjshmërisë së aktorëve të tij ndaj shoqërisë, zbatimin e *acquis communautaire* dhe të standardeve të Bashkimit European, si dhe ndryshimin e mendësive. Më konkretisht, duke synuar arritjen e një konsensusi të

gjerë politik për përgatitjen e bazës legislative dhe zbatimit të reformës në drejtësi, përparësitë strategjike ku do të përqendrohet puna e qeverisë janë:

- **Garantimi i plotë i ndarjes dhe baraspeshës ndërmjet pushteteve me synim rritjen e pavarësisë nëpërmjet forcimit të përgjegjshmërisë së gjyqësorit në dhënien e drejtësisë:**
 - rishikimi në bashkëpunim me Kuvendin dhe organizatat partnere ndërkombëtare i dispozitave kushtetuese dhe zbatimi i parimit 'check and balance', si dhe funksionimi sa më i drejtë i këtij parimi
 - rishikimi i funksioneve brenda sistemit gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë, si dhe i raporteve ligjore e kushtetuese mes tyre, me qëllim që të ketë një ndarje të drejtë dhe të baraspeshuar të përgjegjësisë dhe kompetencave
 - forcimi i dialogut ndërinstitucional dhe bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe gjithë aktorëve të tjerë me kontribut në fushën e drejtësisë, me qëllim ndërtimin dhe konsolidimin e besimit dhe konsensusit të nevojshëm mes forcave politike parlamentare për reformën në drejtësi dhe përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor
 - reformimi në të gjitha përmasat e tij të institucionit të prokurorisë (përfshirë edhe ndryshimet e mundshme kushtetuese), e cila do të ketë si qëllim rritjen e efektivitetit dhe parandalimin e korrupsionit, rritjen e përgjegjshmërisë së prokurorëve në kryerjen e detyrave ligjore, dhe mundësimin e zbatimit të luftës ndaj krimit të organizuar; kjo përfshin edhe ligjin për etikën e prokurorit, rregulloren për sistemin e vlerësimit të punës dhe rregullat për zbatimin e sistemit të administrimit të çështjeve
 - rishikimi dhe harmonizimi i ligjeve organike të sistemit të drejtësisë
 - përmirësimi i mekanizmave dhe procedurave ligjore që parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në sistem
 - orientimi prej praktikave më të mira europiane për funksionimin e gjyqësorit dhe administratës së tij
 - përmirësimi tërësor i sistemit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit të sistemit gjyqësor
 - fuqizimi i institucioneve të vetëkontrollit të gjyqësorit
 - kufizimi i imunitetit të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë, me qëllim lehtësimin e procedimit penal për vepra korruptive
 - zbatimi i programeve vjetore të inspektimeve në prokurori dhe në administratën gjyqësore, si dhe të inspektimeve të përbashkëta të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë - dhe publikimi i raporteve të kontrollit
 - trajnimi i inspektorëve në lidhje me metoda të reja kontrolli, si edhe në lidhje me sisteme të vendeve të ndryshme të Bashkimit Europian
- **Orientimi i sistemit të gjykatave drejt praktikave më të mira europiane:**
 - përtëritja ose zgjerimi i gjykatave përmes investimeve
 - përfundimi i rrjetit kombëtar mbi bazën e sistemit CCMIS dhe kompjuterizimi i përpunimit të dosjeve gjyqësore në të gjitha gjykatat (civile dhe penale), hedhja e shortit në mënyrë elektronike dhe çdo gjykatë me faqe interneti
- **Forcimi i statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve:**
 - zbatimi i procedurave objektive për emërimin e gjyqtarëve nëpërmjet provimeve konkurruese
 - vendosja dhe zbatimi i rregullave objektive dhe transparente për ndarjen e çështjeve midis gjyqtarëve
 - përmirësimi i kushteve, mjeteve dhe mjediseve të punës në gjyqësor
 - trajnim i vazhdueshëm dhe i përshtatshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbi çështje si të drejtat e njeriut, etika, çështje tregtare dhe ato të lidhura me MSA-në

- zhvillimi i kurseve kualifikuese nga Shkolla e Magjistraturës në fusha të ndryshme të së drejtës, si: e drejta civile, e drejta procedurale civile, e drejta penale, e drejta procedurale penale, e drejta kushtetuese, e drejta europiane dhe të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare private, bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale dhe civile, paraqitja e *acquis communautaire*, prokurimi publik, e drejta e falimentimit, pronësia intelektuale, barazia gjinore, mbrojtja e të dhënave personale etj.
- **Rritja e transparencës dhe efikasitetit në proceset gjyqësore**, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe përmirësimin e performancës së administratës gjyqësore në funksionin e saj, si një ndihmesë e çmuar administrative në procesin e dhënies së drejtësisë:
 - zbatimi i sistemit të ri për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, bazuar në kritere objektive
 - programimi vjetor i kontroleve në gjykata, lidhur me përmbushjen e marrëdhënieve me publikun, me mundësinë e qytetarëve për t'u drejtuar në gjykatë dhe me njohjen e vendimeve gjyqësore
 - kontrolli në zbatimin e sistemit të administrimit të çështjeve në të gjitha fazat
 - nxitja dhe popullarizimi i sistemit të zgjidhjeve parajgjyqësore, si arbitrazhi apo ndërmjetësimi, duke synuar krijimin dhe profesionalizimin e një klase arbitrash dhe ndërmjetësish
 - rishikimi i statusit dhe kualifikimeve të administratës gjyqësore nëpërmjet përfshirjes në mënyrë progresive në shërbimin civil
 - përmirësimi i sistemit të përpunimit, analizimit dhe publikimit të statistikave
 - publikimi i ekstrakteve të vendimeve gjyqësore dhe versioneve të konsoliduara të ligjeve
 - bashkëpunimi gjyqësor
 - krijimi i zyrës kombëtare të ndihmës ligjore
- **Ngritja e vazhdueshme e nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë në nivele të ngjashme me ato të vendeve të Bashkimit Europian dhe përmirësimi i performancës së Shërbimit Përmbarrimor nëpërmjet iniciativave ligjore (si p.sh. në Kodin e Procedurës Civile), por edhe aktivitetet e zbatues si:**
 - përmirësimi i infrastrukturës së zyrave të shërbimit përmbarrimor
 - trajnime në lidhje me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile dhe legjisllacionit tjetër që ka lidhje me të
 - futja e një sistemi të ri kontrolli, i cili do të sjellë vlerësimin për ecurinë dhe efektivitetin në ekzekutim të zyrave përmbarrimore lokale
 - ngritja e një intraneti për komunikimet midis të gjitha zyrave të shërbimit përmbarrimor
- **Përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të individit, krijimi i kushteve të duhura për zbatimin me rreptësi të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke garantuar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi nëpërmjet:**
 - respektimit të konventave ndërkombëtare për ngritjen dhe drejtimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimin e të paraburgosurit e të burgosurit në pritje të gjyqimit
 - trajnimit të personelit të burgjeve për çështjet e të drejtave të njeriut dhe fuqizimit të Qendrës së Trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve
 - zbatimit të masterplanit për përmirësimin e kushteve për të burgosurit dhe zgjidhjen e problemit të mbipopullimit të burgjeve sipas rekomandimeve të Këshillit të Europës; do të përfundojnë ndërhyrjet në infrastrukturën e burgjeve Burrel, Lezhë, Lushnjë, Peqin, 313, 302 e Vlorë dhe ndërtimi i paraburgimit në Durrës, Vlorë dhe Elbasan

- o rritjes së përfshirjes së të burgosurve në veprimtari që do të mbështesin ri-integrimin e tyre pas lirit
- o ngritjes së strukturës për zbatimin e dënimeve alternative
- o shpërndarjes së të dënuarve nëpër institucionet pranë qendrave të tyre të banimit
- o reformës së sistemit të burgimit për të miturit, përshtatjes së mjediseve për funksionimin e Institutit të Riedukimit për të miturit, ndërhyrjes së nevojshme ndërtimore dhe pajisjes së ndërtesës, si dhe trajnimit të personelit të Institutit
- o modernizimit të sistemit statistikor në burgje

Gjithashtu:

- Do të nxitet **bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar**, duke marrë pjesë në programe të ndërrmarra nga partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Do të miratohen marrëveshjet me vendet fqinje dhe do të sigurohet zbatimi i efektshëm i tyre.
- Do të përmirësohet **procesi i hartimit të legjisllacionit**, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin profesional të tyre, rritjen e vëmendjes ndaj *acquis communautaire* me qëllim përgatitjen e teksteve ligjore cilësore, dhe përsheptimin e procesit të përafrimit të legjisllacionit, midis të tjerave nëpërmjet:
 - o zbatimit të manualit të hartimit të akteve legjisllative dhe trajnimit të strukturave juridike
 - o konsultimeve më intensive në fazën e hershme të procesit legjisllativ
 - o analizave të opsioneve të politikës përpara se të propozohen ligje të reja
 - o shkëmbimit të përvojave me ekspertë për përvetësimin e standardeve dhe praktikave komunitare
 - o përmirësimit të përkthimeve zyrtare
- Do të harmonizohen të drejtat dhe detyrimet e **avokatëve** me standardet ndërkombëtare të gjithëpranuara dhe do të përmirësohet funksionimi i **noterisë** si shërbim publik që është pjesë integrale e sistemit të drejtësisë, me qëllim forcimin e sigurisë ligjore dhe lehtësimin e ndjeshëm të ngarkesës së punës në gjykata

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Drejtësisë ka një rol kyç për të siguruar që të jetë i garantuar shteti i së drejtës, një ndër synimet parësore ky të Asociimit (Nenet 1 dhe 2). Për më tepër, ajo është përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e Titullit VII për lirinë, drejtësinë dhe sigurinë, me referenca të veçanta ndaj Neneve 78 dhe 79.

Të drejtat e pronës

Sfidat

Rritja ekonomike pengohet nga paqartësia në lidhje me të drejtat e pronësisë. Gjatë periudhës së tranzicionit ka pasur disa reforma madhore në fushën e tokës dhe pronave, përfshirë këtu privatizimi i tokës, banesave dhe pronave të tjera, njohja e të drejtave të pronësisë së tokave të konfiskuara nga shteti pas vitit 1945 dhe krijimi i një Sistemi Regjistri të Pronave të Paluajtshme për të mbështetur tregun e tokës. Janë bërë përpjekje për t'i ndarë të drejtat e përdorimit të pronave publike midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Megjithatë mbetet shumë për t'u bërë në sensibilizimin e njësive të qeverisjes vendore dhe qendrore për zbatimin korrekt të ligjit "Për transferimin e pronave të paluajtshme". Do të vijojë përfundimi pothuajse në të gjithë Shqipërinë i inventarizimit të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe transferimi përfundimtar i së drejtës së pronësisë të karakterit lokal dhe qendror. Me gjithë këto përpjekje, ka ende probleme:

- Rikthimi i pronave të pronarët e vjetër të tokës, të cilëve u është marrë apo konfiskuar në mënyrë të padrejtë pas vitit 1945, është penguar nga konflikte të shpeshta pretendimesh me personat që i kanë në përdorim këto prona. Këtu ka çështje të rëndësishme të pazgjidhura, si

pjesë e zbatimit të ligjit të ndryshuar për kthimin dhe kompensimin e pronave, siç janë: zbatimi në praktikë i metodologjisë së vlerësimit të tokave, kompensimi që do të ofrohet nëse nuk është i mundur rikthimi dhe rrjedhojat e përgjithshme buxhetore që do të sjellë kompensimi, të cilat mund të jenë të konsiderueshme. Gjithsesi ky mbetet një proces i ndërlikuar për vetë faktin se prona ka pësuar ndryshime apo mund t'u jetë tjetërsuar personave të tjerë.

- Nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive dhe si rrjedhojë nuk është përfshirë i gjithë vendi në sistemin e regjistrimit, gjë që krijon veçanërisht shumë vështirësi në zonat ku këto prona kanë vlerë të lartë dhe ku tregu i tokës është dinamik. Si pasojë e punës njëkohësisht me një sistem të vjetruar (hipoteka) dhe një sistem të ri, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk është ende në gjendje të përmbushë funksionin e saj ligjor për të mirëmbajtur dhe garantuar një regjistër të interesave ligjorë. Kjo sjell pasiguri, mosbesim tek qytetarët, të cilët duke hasur gjithashtu në procedura të ndërlikuara, si dhe duke mos pasur informimin e nevojshëm, jo gjithmonë paraqiten pranë ZRPP për të regjistruar pronat e tyre, duke bërë të pamundur përditësimin e informacionit dhe duke krijuar rrezik për mbivendosje.
- Migracioni i brendshëm ushtron një presion të madh për krijimin e zonave të reja të banuara në zonat urbane periferike, të cilat janë zënë dhe mbi të cilat është ndërtuar në mënyrë të paligjshme. Edhe pse sasia dhe cilësia e banesave është përmirësuar ndjeshëm gjatë këtyre viteve, shumë prej tyre nuk janë të lidhura me infrastrukturën bazë dhe me shërbimet sociale. Është i nevojshëm zbatimi i ligjit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e vendbanimeve të paligjshme në mënyrë që pronat të përfshihen në planet e urbanistikës dhe të përfitojnë nga investimet në infrastrukturë.

Vizioni

Vizioni i reformës së të drejtave të pronës është rregullimi i tregut të tokës, i cili do të jetë një faktor nxitës për zhvillimin ekonomik.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Qeveria do të përfundojë regjistrimin fillestar dhe legalizimin e titujve të pronësisë, si dhe kthimin dhe kompensimin e pronave. Zonat pranë qyteteve të mëdha do të kenë përparësi, duke qenë se ato janë më aktivet në tregun e tokës, kanë vlerë më të madhe, dhe një përqendrim më të madh të kërkesave nga ana e pronarëve të mëparshëm në lidhje me pronat që do të legalizohen. Do të realizohet gjithashtu edhe rregullimi 'de jure' i së drejtës së pronësisë nga 'de facto' për njësitë e qeverisjes vendore dhe qendrore.

Ligji parashikon që **pretendimet për pronat do të kompensohen** në natyrë ose në të holla duke u bazuar mbi vlerën e tregut. Objektiv me përparësi në të gjithë këtë proces mbetet krijimi i hartës së vlerës së pronës, si dhe përcaktimi i Fondit të Kompensimit Fizik së bashku me atë financiar. Rëndësia e realizimit të hartës së vlerës së pronës, qëndron në faktin se kjo hartë në vetvete përfaqëson hapin vendimtar dhe përfundimtar për mundësinë e zgjidhjes së problematikës rreth pronësisë. Kjo hartë do të lehtësojë qeverinë shqiptare për të krijuar idenë e fondeve që do të nevojiten për kompensimin e subjekteve të shpronësuara, do të shërbejë si pikë referimi për vlerën e tokës në raste kontratash, si dhe do të krijojë një ide për tregun e tokës në Shqipëri. Arkivat e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave do të kompjuterizohen për të ndihmuar vlerësimin e nevojave për kompensim, si dhe ankesat e ndryshme në lidhje me vendimet e marra nga zyrat rajonale të Agjencisë.

Një ligj i ri do të miratohet për të vendosur një taksë mbi pronën, i cili bazohet mbi vlerën e tregut. Kjo taksë mbi pronën do të jetë një burim i rëndësishëm të ardhurash për qeverisjen lokale. Aktualisht në mungesë të saj rritja e popullsisë nuk çon në zgjerimin e bazës financiare dhe qeverisja lokale nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të financuar zhvillimin e infrastrukturës.

Procesi i **legalizimit** është i parashikuar nga ligji mbi legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe planin përkatës të veprimeve. Hapi i parë ishte procesi i vetëdeklarimit të pronave ilegale. Aktualisht po prodhohen hartat ortofotografike dhe po krijohet sistemi i informacionit. Personeli i njësisë së qeverisjes vendore do të nxjerrë informacionet e dhëna në vetëdeklarimet dhe do t'i përpunojë ato në përputhje me një paketë të plotë udhëzimesh që po hartohet. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) është përgjegjëse për koordinimin e punës. Për ta maksimizuar efencën dhe frytshmërinë

e kostos së procesit të legalizimit, ajo do të jetë e përfshirë drejtpërdrejt në procesin e regjistrimit fillestar.

Në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, qytetarët dhe institucionet shqiptare do të përfitojnë të mira sociale dhe ekonomike, që rrjedhin nga një sistem efikas, ku: kartelat përmbajnë informacion të qartë dhe të saktë të pronësisë mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme si dhe mbi interesat e tjera mbi to në Shqipëri; kartelat pasqyrojnë shtrirjen ligjore të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në përputhje me hartat treguese të regjistrimit të përditësuara rregullisht; i gjithë informacioni i kartelave dhe hartave është i gatshëm dhe i disponueshëm për publikun; dhe është i shpejtë regjistrimi i transaksioneve mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme. Mënyrat kryesore në funksion të realizimit të objektivave të mësipërm janë:

- përmirësimi i ofrimit të shërbimit dhe ulja e tarifave
- krijimi i standardeve të shërbimit dhe monitorimi i tyre
- realizimi i vetëfinancimit të sistemit
- realizimi i statusit juridik të një agjencie autonome
- koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera, që trajtojnë çështjet e pronave

Në funksion të këtyre përparësive strategjike dalin objektivat dhe aktivitetet zbatuese, nëpërmjet të cilave ato do të realizohen:

- përfundimi i regjistrimit fillestar
- modernizimi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku përfshihen: krijimi i programeve kompjuterike dhe procedurave për përditësimin e informacionit; përditësimi i të dhënave digjitale; dhe krijimi i standardeve të shkëmbimit të të dhënave
- zhvillimi i kuadrit rregullator
- ngritja e kapaciteteve administrative

Për realizimin e objektivave të saj, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka përgatitur një paketë dokumentesh, ku përfshihet edhe plani i biznesit, për zbatimin e Projektit të Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës, që përbën aktivitetin kryesor për vitet në vazhdim.

Zbatimi i MSA-së

Neni 61 kërkon qartësimin e situatës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme si pjesë e angazhimit për garantimin e lëvizjes së lirë të kapitaleve.

Anti-korrupsioni

Sfidat

Rritja e korrupsionit në përmasa tepër të rrezikshme, rënia e tregjeve nën kontrollin e monopoleve, zbatimi i dobët e i shtrembëruar i ligjit, vonesat në kryerjen e reformave kanë shkaktuar humbjen në shkallë të gjerë dhe në nivele tepër të larta të besimit të shqiptarëve te institucionet shtetërore. Qeverisjet e mëparshme kanë shkaktuar një rënie të theksuar të forcës së shtetit për të zbatuar ligjin kudo jo vetëm për shkak të paaftësisë për të kryer reforma, por veçanërisht për shkak të mungesës së vullnetit, si dhe për shkak të konfliktit të interesave në të gjitha nivelet.

Raportet e ndryshme ndërkombëtare, por edhe studimet e sondazhet e ndryshme të kryera, si dhe konstatimet e aktorëve të ndryshëm qeveritarë e joqeveritarë, kanë theksuar, ndër të tjera:

- zbatimin e dobët të kuadrit ligjor anti-korrupsion ekzistues
- zbatimin e dobët të instrumenteve administrative për të parandaluar korrupsionin (administrata publike, transparenca e dobët, keqfunksionimi i sistemit të kontrollit, etj.)
- bashkërendimin e pamjaftueshëm ndërmjet strukturave të kontrollit/auditit dhe të ndjekjes penale që luajnë rol në fushën e luftës kundër korrupsionit
- mosfunksionimin e institucioneve që kanë përgjegjësi ligjore në luftën kundër korrupsionit

Në rastin e sistemit të drejtësisë, disa nga problemet më shqetësuese lidhen me: transparencën e ulët të proceseve penale dhe civile të drejtësisë, gjë që ka sjellë një shkallë të ulët besueshmërie në sistemin gjyqësor; mungesën e transparencës dhe procedura jo objektive të emërimit të gjyqtarëve e prokurorëve; mangësitë në statusin, pavarësinë dhe mbrojtjen e posaçme që u sigurohet gjyqtarëve; mangësitë infrastrukturore në gjykata, prokurori, burgje, dhoma paraburgimi, etj.; mungesën e statusit dhe pagat e ulëta të personelit administrativ të gjykatave; dhe shkallë jo të kënaqshme të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Sistemi i prokurimeve publike shpesh nuk i ka shërbyer qëllimit të përdorimit të fondeve publike në mënyrë efikase. Vlerësimi i ofertave është i dobët dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme. Përqindja e kontratave të realizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jokonkurruese ka qenë e lartë. Ligji i ri për prokurimet publike parashtron parimet kryesore, siç janë: respektimi i procesit, dhënia e informacionit dhe transparenca.

Vizioni

Vizioni i përgjithshëm është pakësimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë themelore të strategjisë do të përqendrohen në fushat e mëposhtme.

- Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja dhe edukimi
 - Forcimi i sistemit politik dhe i etikës në funksionin publik, duke përfshirë financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, reformimin e sistemit zgjedhor, rregullimin e veprimtarive të lobimit dhe rishikimin e mekanizmave vetërregullues
 - Modernizimi dhe konsolidimi i procedurave, duke përfshirë reforma rregullatore të licensimit dhe shërbimeve publike
 - Reformat sektoriale (kontrolli, klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia, pushteti vendor, etj.); për shembull, ligji i ri për prokurimin publik, me mbështetjen e Agjencisë së Prokurimeve Publike, do të përmirësojnë ndjeshëm transparencën e procedurave, duke kërkuar tendera të hapur
 - Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike nëpërmjet mundësisë së lirë dhe të plotë për t'u njohur me të dhënat mbi veprimtarinë e institucioneve publike dhe realizimi i 'e-government' në nivelin e qeverisjes qendrore
 - Përafrimi i legjislacionit, veçanërisht përputhshmëria e kuadrit ligjor me konventat penale e civile kundër korrupsionit të Këshillit të Europës dhe vënia në zbatim e detyrimeve të konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit
 - Fushatat informuese dhe masa edukuese të qëndrueshme
- Hetimi dhe dënimi i korrupsionit
 - Sigurimi i efektshmërisë së ndjekjes penale dhe rritjes së shpejtësisë së gjykimit
 - Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë
 - Forcimi i mjeteve administrative në luftën kundër korrupsionit
 - Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e korrupsionit
- Konsolidimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të brendshëm e ndërkombëtar
 - Konsolidimi i mekanizmave në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit
 - Konsolidimi i mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbimin periodik të informacionit
 - Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare

Zbatimi i MSA-së

Kërkesat për politikën antikorrupsion mbulohen nga Neni 74 mbi prokurimet publike, Neni 82 mbi pastrimin e parave dhe Neni 85 mbi bashkëpunimin.

Menaxhimi i integruar i kufijve

Sfidat

Komisioni Europian i ka njohur meritat e Policisë Kufitare dhe Migracionit në përmirësimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, duke kontribuar dukshëm në luftën ndaj krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe parandalimin e flukseve migratore, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj shtetasve, duke bashkëpunuar më mirë me organet homologe të vendeve fqinje. Risitë e kohëve të fundit, siç janë njësitë e lëvizshme të vëzhgimit, instalimi i Sistemit Total të Menaxhimit të Informacionit në pikat kryesore të kalimit të kufirit, modernizimi i pajisjeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, trajnimi i vazhdueshëm i efektivave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve e Protokolleve të bashkëpunimit kufitar me vendet fqinje kanë ndihmuar në rritjen e efektivitetit. Megjithatë, në përputhje edhe me nismat në vendet e Ballkanit Perëndimor për një menaxhim të integruar të kufijve, nevojiten investime të mëtejshme në mënyrë që menaxhimi kufitar në disa porte të ngrihet në standardet ndërkombëtare. Një çështje e pazgjidhur është çmilitarizimi i funksionit të Rojës Bregdetare për mbikëqyrjen e kufirit detar, meqenëse vazhdimi i pranisë ushtarake në kontrollin e kufirit nuk përputhet me standardet europiane, objektivat e partneritetit me NATO-n dhe angazhimet për procesin e Ohrit për siguri e menaxhim kufitar. Menaxhimi i mirë i kufijve së bashku me menaxhimin doganor kanë rëndësi edhe për kontrollin e korrupsionit.

Vizioni

Të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet gjithë autoriteteve dhe agjencive kombëtare të përfshira në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, lehtësimin e shkëmbimeve tregtare, lehtësimin e qarkullimit të lirë të njerëzve si dhe bashkëpunimin kufitar rajonal, me qëllim krijimin e sistemeve efikase të integruara për menaxhimin e kufirit, në mënyrë që të realizohet qëllimi i përbashkët për të pasur kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufijve është në përputhje me 'Udhëzimet e BE për Menaxhimin e Integruar të Kufijve', i cili është dokumenti i punës i Komisionit Europian. Strategjia përqendrohet në katër agjenci: Policia Kufitare dhe e Migracionit; Shërbimi Doganor; Shërbimi Fitosanitar dhe Shërbimi Veterinar. Thelbësore për bashkërendimin është një ndarje e qartë e përgjegjësisë, komunikimi aktiv dhe një rrjedhje e mirëorganizuar e informacionit. Koncepti i menaxhimit të integruar të kufijve mbështetet mbi tri shtyllat:

- bashkëpunimi brenda shërbimit: në planin vertikal (koherencë përgjatë linjës së komandës) dhe në planin horizontal (komunikimi ndërmjet niveleve administrative që nga organi shtetëror deri te njësitë që punojnë në kufi)
- bashkëpunimi ndërmjet agjencive: përpunimi i koordinuar në pikat e kalimit kufitar, operacionet e përbashkëta në kufijtë e blertë dhe blu me ndarjen e përgjegjësisë, sisteme qendrore të integruara të teknologjisë së informacionit, rritja e ndërgjegjësisë dhe përdorim i përbashkët i infrastrukturës
- bashkëpunimi ndërkombëtar: bashkëpunimi lokal ndërmjet punonjësve në të dy anët e kufirit, bashkëpunimi dypalësh ndërmjet shteteve fqinje dhe bashkëpunimi shumëpalësh për përgatitjen e vendeve për anëtarësim të mundshëm në sisteme të ndryshme të BE (p.sh. në Sistemin e Vizave Shengen dhe Sistemin e Informacionit të Doganave) mbi bazën e dy dokumenteve themelore ligjore: marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit dhe marrëveshjet e ripranimit

Secila prej këtyre shtyllave përfshin çështjet e mëposhtme: kuadrin ligjor rregullator, menaxhimin dhe organizimin, procedurat, trajnimin dhe burimet njerëzore, komunikimin, shkëmbimin e informacionit dhe teknologjinë e informacionit, infrastrukturën dhe pajisjet. Përparësitë strategjike janë si më poshtë:

- ndryshimet e legjisllacionit përkatës (për të tri shtyllat), të cilat garantojnë që agjencitë e kufirit të organizohen dhe të funksionojnë siç kërkohet nga BE
- reformat organizative dhe ristrukturimi si pasojë e ndryshimeve në kuadrin ligjor rregullator, të cilat garantojnë linjën e duhur të drejtimit, kontrollit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale e financiare

- të gjitha procedurat e agjencive të kufirit përsa i përket personelit, trajnimit dhe financave përcaktohen në rregulloret e brendshme me konsultime të përbashkëta ndërmjet tyre
- procedurat e duhura dhe transparente të **përzgjedhjes dhe të emërimit të personelit** vihen në zbatim me qëllim rritjen e cilësisë dhe të profesionalizmit të agjencive të kufirit
- komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit si dhe shpërndarja e informacionit midis agjencive të kufirit të përmirësohet, si dhe të krijohet një sistem i **përgjithshëm i menaxhimit të informacionit**
- **infrastruktura dhe pajisjet** e përshtatshme mbështesin përpjekjet e agjencive për t'u dhënë shërbim profesional qytetarëve dhe përfituesve të tjerë

Zbatimi i MSA-së

Kërkesat për menaxhimin e integruar të kufijve janë përfshirë në Nenin 80.

Migracioni

Sfidat

Rreth 20% e popullsisë është larguar nga vendi gjatë më shumë se një dhjetëvjeçari, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me nivelin më të lartë të flukseve të emigracionit në botë. Migracioni gjithashtu përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet anëtare të Bashkimit Europian si vende destinacioni për shumicën e emigrantëve shqiptarë. Në Shqipëri shikohet me përparësi lufta kundër migracionit të parregullt, ashtu sikurse theksohet edhe nga Bashkimi Europian. Marrëveshja midis Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi lehtësimin e dhënies së vizave u nënshkrua në muajin shtator të vitit 2007, si një hap drejt liberalizimit të plotë të lëvizjes së lirë.

Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është të sigurojë një politikë më të plotë për migracionin, në krahasim me një politikë që kryesisht ka reaguar në luftën ndaj flukseve të parregullta drejt një politike të bazuar në ngritjen dhe funksionimin e një sistemi kombëtar menaxhues të migracionit.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike të strategjisë ndërsektoriale për migracionin janë si më poshtë:

- Të **luftojë migracionin e paligjshëm** nëpërmjet masave të tilla: si zbatimi i Marrëveshjes së Ripranimit dhe krijimi i një sistemi TIMS që do të regjistrojë fluksin e shtetasve të vendeve të treta që rikthehen dhe qëndrojnë në Shqipëri për motive punësimi
- Të **krijë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë favorizues për të siguruar korrelacionin e dyanshëm të migrimit me zhvillimin e Shqipërisë** duke përfshirë:
 - Orientimin e dërgesave të emigrantëve drejt investimeve në biznes
 - Përmirësimin e imazhit të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit
 - Përmirësimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike shqiptare në vendet pritëse
 - Mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve/eve shqiptarë në vendet ku ata jetojnë, duke kërkuar një trajtim të barabartë në pëputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë
 - Mobilizimin dhe organizimin e bashkësive shqiptare jashtë vendit
- Të **menaxhojë emigrimin qarkullues të shqiptarëve** nëpërmjet nxitjes së nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe të punësimit ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE
- Të **luftojë dukurinë e ikjes së trurit** nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për hartimin e programeve që tërheqin studentët dhe për të mundësuar punësimin në vend të emigrantëve të kualifikuar
- Të **sigurojë trajtimin e barabartë të shtetasve të vendeve të tjera të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Shqipërisë** nëpërmjet përafrimit të legjislacionit në këtë fushë dhe arritjes së standardeve europiane

- Të përmirësohet **kuadri ligjor për migracionin**, veçanërisht ligji për shërbimet konsullore, ligji për emigrimin për motive punësimi, kodi penal, kodi zgjedhor dhe ligji për të huajt
- Të krijohet një strukturë e përshtatshme institucionale për të menaxhuar **politikat e migracionit** lidhur me: shërbimet integruese; hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të punësimit me bizneset private; ofrimin e shërbimit dhe informacionit për të emigruar në mënyrë të rregullt; dhe vlerësimin e kërkesë-ofertës për personat e kualifikuar në tregun e punës

Zbatimi i MSA-së

Çështjet e migracionit trajtohen në Nenet 80 dhe 81.

Krimi i organizuar, terrorizmi dhe trafikimi

Sfidat

Kontrolli mbi lëvizjet e skafeve ka vazhduar sikurse edhe ndjekjet penale dhe dënimet e trafikantëve, edhe pse mbeten problem veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, siç janë ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve apo shfrytëzimi për prostitucion, keqtrajtimi i të miturve. Shërbimet për ri-integrimin afatgjatë të viktimave mbeten gjithashtu një problem, për zgjidhjen e mundshme të të cilit, organet kompetente kanë filluar të ndërmarrin hapat e nevojshëm. Marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e një mekanizmi kombëtar referues për identifikimin dhe asistencën e përmirësuar për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është instrument i vlefshëm për bashkërendimin sa më të mirë të veprimeve për referim, ndihmë dhe rehabilitim.

Komisioni Europian³ ka vlerësuar përparimin e bërë në lidhje me zbatimin e masave konkrete kundër krimit të organizuar. Megjithatë, të njëjtat burime përmendin nevojën për të rritur ritmin, numrin dhe cilësinë e ndjekjeve ligjore të veprave të krimit të organizuar dhe ngrirjen e konfiskimit e të ardhurave nga krimi. Kjo kërkon përdorimin më intensiv të të dhënave informative dhe përmirësimin e lëvizjes së informacionit ndërmjet agjencive publike edhe me institucionet e huaja të kontrollit të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi i gjyqësorit me policinë e shtetit do t'i përmirësonte më tej rezultatet. Është e nevojshme të fuqizohet Njësia Informative Financiare (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe kuadri ligjor që e mbulon atë, për të parandaluar veprimtaritë e pastrimit të parave.

Edhe pse vënia në jetë e parimit të realizimit të veprimtarisë policore në bashkëpunim me komunitetin është një parakusht i rëndësishëm, premisat që ndihmojnë në lulëzimin e krimit të organizuar janë të shumta dhe variojnë nga kushtet socio-ekonomike (si p.sh. karakteri i përhapur i ekonomisë me para në dorë), në ato institucionale (si p.sh. pavarësia e institucioneve), teknologjike (si p.sh. dobësitë në mbledhjen e të dhënave informative) dhe kushtet politike (si p.sh. ndarja e pamjaftueshme e pushteteve ndërmjet administratës publike dhe sistemit politik).

Vizioni

Vizioni i strategjisë është një shoqëri pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve/eve, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e një vendi të qetë e me standarde të larta të sigurisë.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Strategjia ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit e përqendron vëmendjen në përparësitë e mëposhtme strategjike:

- Kryerja e **hetimeve**, me qëllim shkatërrimin e plotë të rrjeteve kriminale, organizatave kriminale apo grupeve të strukturuar, për të gjitha format e krimit
- **Rritja e kapacitetit profesional** të Drejtorisë së Krimit të Organizuar përmes marrjes në punë të personelit të specializuar dhe trajnimit të vazhduar
- **Përsosja e infrastrukturës së operacioneve speciale**, nëpërmjet krijimit të kushteve për mjete e teknologji bashkëkohore, përmes përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë

³ Enlargement Strategy and Main Challenges 2006-2007, Komisioni Europian, nëntor 2006

këtë veprimtari, trajnimit të personelit përkatës, thellimit të punës me inteligjencën për informacionin dhe analizën e tij, sidomos në plotësimin e Sistemit të Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS), Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Rrezikut (RMIS), rrjetit të komunikimit për Policinë e Shtetit (DATAcom) si dhe sistemit të analizës së informacionit kriminal (MEMEX)

- **Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtare** në fushat e shkëmbimit të informacionit kriminal dhe pjesëmarrjes në operacione të përbashkëta
- **Fuqizimi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë përpara, gjatë dhe pas procesit gjyqësor** nëpërmjet zbatimit rigoroz të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përmirësimit të bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse, qofshin këto shtetërore, të pavarura apo organizata ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet rritjes së besimit të qytetarëve tek forcat e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori
- **Sensibilizimi i qytetarëve** në lidhje me pasojat e krimit të organizuar mbi destabilizimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit
- **Zgjerimi i mëtejshëm i kapacitetit të autoriteteve në luftën kundër pastrimit të parave dhe i aftësisë së administratës së doganave për të luftuar kontrabandën** përmes trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit
- **Zbatimi i planit kombëtar të veprimit për luftën kundër drogave dhe, në lidhje me këtë, ngritja e kapaciteteve** hetuese dhe përmirësimi i menaxhimit të drogave të sekuestruara
- **Përdorimi i metodave të posaçme të hetimit për të luftuar trafikun e armëve**
- **Zbatimi i detyrimeve nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore**, përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare
- **Krijimi i një sistemi efikas të vlerësimit të rrezikut nga terrorizmi dhe marrja e masave për parandalimin e terrorizmit** nëpërmjet ndarjes më të qartë të përgjegjësive të strukturave të shtetit që angazhohen në këtë drejtim

Zbatimi i MSA-së

MSA e përfshin luftën kundër krimit të organizuar në Nenin 81 (trafikimi), Nenin 82 (pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit), Nenin 83 (droga), Nenin 84 (parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme) dhe Nenin 85 (bashkëpunimi). Rëndësia që Palët i kushtojnë kësaj sfide, përkufizohet qartë edhe në paragrafët hyrës të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të cilët theksojnë zotimin e Palëve për të luftuar krimin e organizuar dhe për të forcuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit në bazë të deklaratës së nxjerrë nga Konferenca Europiane më 20 tetor 2001.

Rendi publik

Sfidat

Periudha e tranzicionit është shoqëruar me krijimin e strukturave policore në përshtatje me një shtet demokratik dhe me nevojën për të respektuar të drejtat e njeriut. Policisë së Shtetit i është dashur t'u përgjigjet sfidave tërësisht të reja si nga niveli ashtu edhe nga lloji i kriminalitetit. Sfida të reja, si zbatimi i modelit të policimit në komunitet me qëllim parandalimin e veprimtarisë ilegale dhe ndryshimi i tipareve demografike, kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë.

Ndryshimet e fundit të strukturës organizative të Policisë së Shtetit kanë për synim rivendosjen e stabilitetit institucional. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe i infrastrukturës ka nevojë të përmirësohet. Çdo ditë po forcohet opinioni i përgjithshëm se efektiviteti i veprimit të policisë po përmirësohet, siç kanë dëshmuar disa operacione të suksesshme në shkallë të gjerë. Sidoqoftë, mungesa e të dhënave të plota statistikore pengon krijimin e një informacioni të qartë për prirjet. Përmirësimet e bëra në këtë fushë do të rrisin transparencën dhe do të ndihmonin në përmirësimin e mëtejshëm të imazhit të këtij institucioni.

Vizioni i sektorit

Strategjia e rendit publik mbështetet në afrimin e policisë me bashkësinë, që njihet si mënyra më e përshtatshme e veprimit për një shtet demokratik. Qasja më e madhe e bashkësisë ndaj policisë sjell që të shikohet policia si një shërbim dhe jo si një forcë dhe, për rrjedhojë, e konsideron atë të jetë e hapur për komunitetin dhe të japë llogari përpara publikut. Pritet që policia dhe bashkësia të punojnë së bashku. Kjo kërkon një shkallë të ngritur profesionalizmi nga ana e policisë, në mënyrë që ajo të angazhohet me grupet e bashkësisë dhe të kuptojë kontekstin lokal. Për rrjedhojë, kjo qasje kërkon ndryshime të mendësisë, në mënyrë që punonjësit ta përqendrojnë vëmendjen te cilësia e shërbimit të ofruar dhe të menaxhojnë organizatën me synimin për të përmirësuar rezultatet. Policia synon të krijojë një imazh më të mirë për veten dhe të krijojë besim te bashkësia.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Për të arritur këtë, strategjia përcakton përparësitë e mëposhtme:

- **Luftë kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit, si dhe menaxhim i integruar i kufijve** (të cilat janë trajtuar me hollësi në seksionet e mëparshme)
- **Ngritja e partneriteteve dhe e besimit**, e cila kërkon trajnim të personelit, studim të perceptimit të qytetarëve dhe të kërkesave të tyre, si dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e linjave të komunikimit ndërmjet agjencive dhe institucioneve partnere të angazhuara në fushën e zbatimit të ligjit
- **Rritja e cilësisë së shërbimit**, e cila përfshin ngritjen e kapaciteteve në fushën e komunikimit, përgatitjen e manualeve të procedurave standarde, zbatimin e modeleve të vetëvlerësimit dhe përcaktimin e treguesve të performancës
- **Veprimtaria policore e udhëhequr nga inteligjenca** e cila përfshin zhvillimin e një modeli kombëtar të inteligjencës, krijimin e njësive të inteligjencës dhe trajnimin për të orientuar punonjësit të përdorin të dhënat informative
- **Përmirësimi i menaxhimit të policisë**, përmes krijimit të një dokumenti orientues të procesit, decentralizimit të kompetencave, përhapjes së përvojës më të mirë dhe trajnimit të drejtuesve
- **Reduktimi i mëtejshëm i krimit dhe i sjelljeve antishoqërore**
- **Përmirësimi i sigurisë rrugore**
- **Zhvillimi i burimeve njerëzore**, ku përfshihen procedurat e përshtatshme të rekrutimit dhe vlerësimit; një plan zhvillimi për të gjithë punonjësit; përcaktimi i kompetencave për secilin rol dhe secilin funksion; transparenca dhe komunikimi; unifikimi i trajnimit të ofruar dhe ngritja e kapaciteteve në Akademinë e Policisë
- **Përmirësimi i menaxhimit logjistik**, përmes përmirësimit të politikave të planifikimit, rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara, përmirësimit të bazës ligjore, trajnimeve specifike për çështje të logjistikës, përshtatjes së armatimit me misionin e Policisë, rritjes së kapaciteteve të strukturave automekanike, si dhe decentralizimit të buxhetit të Policisë së Shtetit
- **Zhvillimi i infrastrukturës mbështetur në një master-plan dhe në standardizimin e ndërtesave**

Sferat ku strategjia e veprimtarisë policore në bashkësi pritet të sjellë rezultat shkojnë nga sjelljet antisociale deri te dhuna në shtëpi dhe nga siguria në rrugë deri te krimi ordiner.

Zbatimi i MSA-së

Policia e shtetit është një aktor kyç në zbatimin e Neneve të Titullit VII mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, në veçanti Nenet 80-85.

Modernizimi i administratës

Administrata publike

Sfidat

Një vend i cili është duke u përgatitur për të hyrë në Bashkimin European duhet të fuqizojë institucionet, të ngrëjë kapacitetin menaxhues dhe sistemet administrative në standarde të tilla, të cilat garantojnë vënien në zbatim të kuadrit ligjor european (acquis communautaire). Sipas udhëzimeve këshilluese të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin e Komisionit European⁴, “kjo kërkon një administratë publike funksionale dhe të qëndrueshme, të mbështetur në një shërbim civil eficient dhe të paanshëm”. Pjesë përbërëse e negociatave për anëtarësim në BE është edhe një vlerësim i rregullt i kapacitetit administrativ të vendeve candidate për çdo kapitull të acquis communautaire. Kjo nënkupton një vizion të qartë për strukturat kryesore administrative, të cilat kërkohen për të vënë në zbatim kapitujt e ndryshëm të acquis communautaire, për funksionet kryesore që duhet të përmbushin këto struktura dhe për karakteristikat bazë që duhet të kenë.

Departamenti i Administratës Publike ka theksuar⁵ se “paaftësia për të realizuar objektivat e ndryshëm, mungesa e respektimit të arritjes së objektivave, mungesa e planifikimit me realizëm” janë një provë e qartë e nevojës së ngutshme për reformë. Nëse nuk përmirësohen këto kushte, do të jetë gjithnjë e më e vështirë për të tërhequr, mbajtur në punë dhe motivuar punonjësit e nevojshëm për një administratë publike të efektshme.

Partneriteti European ka përcaktuar si përparësi futjen e menaxhimit të orientuar drejt rezultateve dhe zbatimin e një strukture pagash, për të motivuar zhvillimin e karrierës dhe për të rritur profesionalizmin e administratës publike, si edhe trajnimin e punonjësve të sektorëve të administratës publike, përgjegjës për zbatimin e kërkesave të MSA-së dhe ato të përfshira në zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit European.

Fuqizimi i administratës publike do të ndihmojë në përmirësimin e procesit legjislativ. Do të jetë shumë e madhe axhenda e përgatitjes së ligjeve për vitet e ardhshme, në të cilën do të përfshihet edhe përafrimi i legjislacionit me acquis communautaire dhe përshtatja e konventave ndërkombëtare të ratifikuara në kuadrin ligjor vendas.

Vizioni

Krijimi i një administrate profesionale, të mbështetur në merita, të paanshme dhe të aftë të përballojë sfidat gjithëpërfshirëse të integritetit dhe ato të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Për të zbatuar vizionin e saj, Qeveria ka parashikuar si përparësi kryesore strategjike:

- **Ngritjen dhe fuqizimin e strukturave efektive për të gjitha institucionet publike.** Të gjitha institucionet publike duhet të organizohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë realizimin e të gjitha funksioneve të tyre, të mos ketë mbivendosje funksionale dhe të përmirësohen shërbimet që i ofrohen publikut. Gjithashtu, do të shqyrtohen të gjitha funksionet që mund të privatizohen, apo që nuk përbëjnë më objekt të punës së administratës publike.
- **Thellimin e reformës në shërbimin civil dhe zgjerimin e fushës së veprimit të ligjit të shërbimit civil.** Kjo përparësi do të realizohet nëpërmjet ndryshimeve përkatëse në legjislacionin për shërbimin civil, për të mundësuar rritjen e objektivitetit të procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të aftë profesionalisht. Gjithashtu, synohet që të ofrohen për të gjithë punonjësit publikë, të drejta dhe detyrime të njëjta si për nëpunësit civilë.
- **Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të performancës.** Synimi është që të krijohet një sistem objektiv i përcaktimit të qëllimeve institucionale, që lidhen me objektivat individualë të

⁴ Guide to the main administrative structures required for implementing the acquis, Komisioni European, maj 2005

⁵ Raport vjetor 2005, Departamenti i Administratës Publike

nëpunësve, për të arritur në fund të vitit në një bilanc të realizimit të tyre. Gjithashtu, synohet të realizohet një lidhje e drejtpërdrejtë mes performancës individuale, sistemit të shpërblimeve dhe zhvillimit të karrierës.

- **Krijimin dhe zbatimin e skemave shpërblyese për nëpunësit publikë.** Qëllimi është të diferencohen nëpunësit publikë mbështetur në kualifikimet e tyre, për të tërhequr dhe mbajtur në administratë kuadro të aftë profesionalisht. Për këtë arsye do të ndryshohet struktura e pagës, duke parashikuar shpërblime shtesë për nëpunësit që kanë kryer studime pasuniversitare (master, doktoraturë).
- **Trajnimin si një instrument strategjik për zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike.** Zbatimi i angazhimeve të MSA-së, si edhe i programeve të mbështetjes financiare të BE kërkon ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë nëpërmjet trajnimeve në përputhje me kërkesat e vendit të punës. Strategjia e trajnimeve do të zbatohet nga Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike.
- **Vënien në funksionim të një sistemi modern të menaxhimit të burimeve njerëzore.** Synohet vënia në funksionim e bazës qendrore të të dhënave për të gjithë nëpunësit publikë, e cila do të shërbejë si bazë informacioni për kryerjen e parashikimeve lidhur me stafin dhe zhvillimin e skenarëve të ndryshëm për reforma në fushën e pagave. Gjithashtu, lidhja me sistemin e thesarit, do ta shndërrojë këtë sistem në një gjenerues elektronik të pagës për nëpunësit publikë.

Zbatimi i MSA-së

Fusha e administratës publike mbulohet nga Neni 111. Gjithashtu, Partneriteti Europian rekomandon garantimin e zbatimit të legjislacionit të statusit të nëpunësit civil, duke formalizuar në këtë mënyrë kujtesën institucionale dhe funksionimin e sistemit të karrierës.

Decentralizimi

Sfidat

Decentralizimi si proces dhe qeverisja vendore do të vazhdojnë të konsiderohen si një instrument dhe kriter i qartë i matjes së vullnetit të shoqërisë shqiptare, të aktoreve të rëndësishëm të jetës politike dhe administrative, veçanërisht të qeverisë shqiptare: (i) për të ndërtuar një sistem demokratik, (ii) për të siguruar një qeverisje të mirë dhe efektive për qytetarët, (iii) për të ushtruar pushtetin dhe shërbimet në nivele qeverisjeje sa më pranë qytetarëve, (iv) për të tërhequr apo siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, (v) për të kontribuar në mënyrë aktive në procesin integruar të Shqipërisë në strukturat euro-atlantike nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkomunal e ndërrajonal. Procesi i decentralizimit në Shqipëri është mbështetur në dokumentet kryesore europiane që normojnë demokracinë vendore e rajonale dhe qeverisjen e mbështetur në to, në Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Vendore, Konventat kuadër për bashkëpunimin ndërkufitar, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe gjithë kuadrin ligjor për qeverisjen vendore në Shqipëri.

Decentralizimi për konsolidimin e frytshëm të qeverisjes vendore konsiderohet si: (1) decentralizim politik, duke synuar t'u japë qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur të tyre më shumë pushtet në procesin e vendimmarrjes publike; (2) decentralizim administrativ, duke kërkuar rishpërndarjen e autoritetit, përgjegjësisë dhe mundësisë për sigurimin e shërbimeve publike me anë të niveleve të ndryshme të qeverisjes; dhe (3) decentralizim fiskal, sipas të cilit autoritetet vendore për të kryer më mirë funksionet e tyre të decentralizuara të kenë të ardhura të mjaftueshme, të realizuara këto me burime të veta apo të transferuara nga pushteti qendror, si dhe autoritetet për të marrë vendime për shpenzimet.

Vizioni

Vizioni i qeverisjes vendore në Shqipëri është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, me parimet e Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe objektivat në kuadrin e zbatimit të MSA-së.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Në vijim të arritjeve në kuadër të zbatimit të strategjisë kombëtare për decentralizimin dhe autonominë vendore gjatë shtatë viteve të fundit, Ministria e Brendshme ka bërë një rishikim të problemeve kryesore të politikave dhe ka përcaktuar përparësitë strategjike të mëposhtme:

- **Forcimi i nivelit të parë të qeverisjes vendore nëpërmjet:**

- Forcimit institucional të bashkive dhe komunave. Kjo përfshin përmirësimin e strukturave të tyre administrative, qartësimin dhe saktësimin e marrëdhënieve të këshillave me kryetarët dhe administratat përkatëse, thjeshtëzimin dhe bërjen më transparente të strukturave përkatëse, dhe rritjen e cilësisë së nëpunësve civilë të administratës vendore nëpërmjet zgjerimit të objektit të ligjit "Për shërbimin civil", duke përfshirë në të edhe administratën e komunave. Një objektiv afatshkurtër është edhe hartimi dhe miratimi i një strategjie për trajnimin e nëpunësve dhe të zgjedhurve vendorë, pazgjidhshmërisht i lidhur me luftën kundër korrupsionit, me qeverisjen e mirë dhe me pjesëmarrjen e publikut.
 - Fuqizimit financiar. Kjo do të arrihet përmes bashkimit të dy komponentëve të tatimit mbi biznesin e vogël (taksat lokale dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin) në një tatim të vetëm; transferimit të të drejtave të plota të qeverisjes vendore për mbledhjen dhe administrimin e tatimeve të biznesit të vogël. Ky fuqizim mund të përfshijë miratimin dhe zbatimin efektiv të ligjit për huamarrjen e pushtetit vendor, si dhe miratimin e ligjit integral për financat vendore. Synimi kryesor në këtë aspekt është përmirësimi i efektivitetit, parashikueshmërisë, drejtësisë në shpërndarjen e fondeve midis njësive vendore, transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, kjo do të mundësonte një ndarje të mundshme mes pushtetit qendror dhe atij vendor të kuadrit të përbashkët të të ardhurave fiskale nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin. Në kushtet e një veprimi më aktiv mes niveleve të qeverisjes duhet parë gjithashtu si përparësi edhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i kapaciteteve për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Në lidhje me llogaridhënien, do të formalizohet sistemi statistikor dhe mënyrat e raportimit e të shkëmbimit të informacionit midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor.
 - Transferimit të shpejtë të pasurive në nivel vendor. Do të përfundojë transferimi i plotë i pronave të njësitë e pushtetit vendor, sipas dispozitave të ligjit dhe procedurave për regjistrimin e pronës shtetërore. Në periudhën afatshkurtër duhet të përfundojë transferimi, regjistrimi në gjykatë dhe konsolidimi i shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave. Po kaq me përparësi është konsideruar edhe transferimi brenda gjysmës së parë të vitit 2008 i pyjeve dhe kullotave në pronësi të qeverisjes vendore.
 - Përmirësimin të marrëdhënieve për kompetencat e ndara. Lidhur me përmbushjen e detyrave në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, një rregullim i veçantë në përputhje me dispozitat e Kartës dhe ligjit organik të qeverisjes vendore duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë e secilit aktor, si dhe mënyrën e koordinimit mes tyre.
 - Përmirësimi i ndarjes administrative-territoriale. Realiteti i sotëm, përdorimi i instrumenteve më efektive, si bashkëpunimi ndërkomunal apo dhe komplementariteti i shërbimeve publike, mes bashkive e komunave nga njëra anë, me këshillat e qarqeve nga ana tjetër, nxjerrin në pah finalizimin e përpjekjeve për një ndarje më racionale dhe më efektive administrative. Kjo ndarje do të jetë produkt dhe do të përdoret gjerësisht në këshillimin me të zgjedhurit vendorë, me këshillat vendorë, si dhe me qytetarët.
- **Fuqizimi i qeverisjes vendore të nivelit të dytë.** Sot për sot, paraqiten mjaft mangësi në ndërtimin apo zgjedhjen e organeve përfaqësuese të këshillit të qarkut, në sasinë e kompetencave të ngarkuara me ligj, si dhe burimet e pavarura financiare për këshillat e qarqeve. Në këtë këndvështrim nevojitet një kuadër i ri ligjor, i cili do të realizojë një mënyrë të re të zgjedhjes dhe ndërtimit të këshillave të qarqeve, do të shtojë dhe zgjerojë llojet e kompetencave, do të përcaktojë burime të pavarura financiare për këshillat e qarqeve, e kombinuar kjo me një rishikim të madhësisë së rajoneve apo qarqeve, në përputhje me standardet europiane.

Zbatimi i MSA-së

Neni 111 mbi administratën publike mbulon gjithashtu qeverisjen lokale.

Gjendja civile dhe kartat e identitetit

Sfidat

Shqipërisë i duhet të zhvillojë një sistem të saktë të gjendjes civile, të cilin individët mund të mbështeten me besueshmëri. Ky është një problem i ngutshëm, me rrjedhoja të cilat shkojnë përtej

mungesës së regjistrave të saktë të votuesve. Regjistri civil është një instrument shumë i rëndësishëm për planifikimin e politikave të qeverisë në fushat e tatimeve, shëndetësisë, sigurimeve shoqërore, arsimit, shërbimit postar, shërbimit ushtarak dhe lëvizjes së lirë të njerëzve.

Një e metë e madhe e sistemit të gjendjes civile në Shqipëri është mungesa e një sistemi administrativ të adresave. Sistemi i mëparshëm i adresave u shemb në periudhën pas regjimit komunist, si pasojë e politikave jo konsekuente, e menaxhimit dhe planifikimit të pamjaftueshëm vendor, lëvizjeve të parregullta të popullsisë dhe ndërtimeve të paligjshme. Kuadri ligjor i detyron njësitë e pushtetit vendor të bëjnë emërtimin e bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve ekzistuese të paemëtuara, si dhe adresimin e brendshëm dhe të jashtëm të objekteve ekzistuese, por nuk i parashikon të gjithë hapat e nevojshëm për të zbatuar dhe menaxhuar gjithë procesin. Është duke u hartuar procesi i harmonizuar dhe i unifikuar i certifikimit të hartave. Njësitë përgjegjëse për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemit të adresave janë: në nivelin qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave, që do të jetë përgjegjëse për sistemin e adresave, regjistrin kombëtar të adresave dhe administrimin e këtij regjistri; në nivel lokal, duke u bazuar në kuadrin ligjor aktual, përgjegjës për administrimin e sistemit të adresave janë njësitë e qeverisjes vendore.

Aktet e gjendjes civile (certifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes) regjistrohen në nivel vendor në zyrat e gjendjes civile dhe më vonë hidhen në regjistrin themeltar, që është një përmbledhje e gjithë përbërësve të gjendjes civile për çdo familje. Në bazë të regjistrin themeltar, u lëshohen certifikatat qytetareve. Këto certifikata shërbejnë edhe si dokument identifikimi, duke qenë se këto të fundit nuk ekzistojnë në Shqipëri.

Krahas kësaj, ligji për mbrojtjen e të dhënave nuk përputhet tërësisht me Konventën 108 të Këshillit të Europës dhe Protokollin Shtesë përkatës, që ka ratifikuar Shqipëria në vitin 2005. Në kërkesat e këtyre instrumenteve ligjore ndërkombëtare përfshihet edhe krijimi i një autoriteti të pavarur të mbikëqyrjes për mbrojtjen e të dhënave. Për më tepër, legjislacioni aktual mbulon vetëm autoritetet publike dhe jo personat juridikë privatë.

Vizioni i sektorit

Krijimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të regjistrin të gjendjes civile dhe të adresave që do të përdoret si bazë për një dokument identiteti personal të sigurt dhe unik, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike të këtij sektori janë:

- Krijimi dhe administrimi i një sistemi bashkëkohor adresash për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike
 - Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues
 - Krijimi i mekanizmave të përshtatshëm të bashkëpunimit për të mbështetur zbatimin në nivel vendor
 - Hartimi i projekt-manualeve për zbatimin e sistemit të ri të adresave
 - Krijimi i një autoriteti qendror që do të veprojë si bashkërendues për hartat
 - Informimi i publikut nëpërmjet fushatave sensibilizuese
 - Vendosja fizike e tabelave me emërtimet e bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve dhe me numërtimet e ndërtesave në mbarë vendin
- Krijimi i një sistemi bashkëkohor të gjendjes civile
 - Kompjuterizimi i regjistrave themeltarë dhe lidhja e tyre me sistemin e ri të adresave
 - Rishikimi i kuadrit ligjor në përshtatje me shërbimin e ri
 - Rritja e kapacitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe përshtatja e statusit të saj ndaj ndryshimeve rrënjësore që do të ndodhin
 - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me autoritetet vendore
 - Fushatë për njohjen e publikut të gjerë me zhvillimet e reja të shërbimit të gjendjes civile

- Përcaktimi i numrit optimal të zyrave të gjendjes civile dhe vendndodhjes së tyre, si dhe i funksioneve të secilës
- Krijimi i lidhjes midis sistemit të gjendjes civile dhe sistemit të kartave të identitetit për të arritur rezultate të qëndrueshme në kohë
 - Lidhja e regjistrimit civil dhe kartave të identitetit në një skemë të përgjithshme: përdorimi i regjistrimit civil për të krijuar dhe lëshuar një numër identifikimi personal; krijimi i një infrastrukture për transferimin e të dhënave; parandalimi i krijimit të dy bazave të ndryshme, një për regjistrin civil dhe një për kartat e identitetit
 - Krijimi i mundësisë së përdorimit të regjistrimit civil nga përdorues të tjerë qeveritarë ose jo, në përputhje me parimin 'një regjistrim i qytetarëve, shumë përdorime të të dhënave'
- Futja në përdorim e kartave të identitetit dhe e pasaportave elektronike, një sistem që:
 - do të ndërtohet në dy nivele: (1) niveli qendror me dy përbërës: Qendrën e Përpunimit dhe Kontrollit të të Dhënave; dhe Qendrën e Prodhimit të Dokumentit të Identitetit dhe Pasaportës Elektronike; (2) niveli lokal me dy përbërës: Zyrat e paraqitjes së kërkesës për dokument identiteti dhe pasaportë elektronike; dhe Zyrat e verifikimit të dokumentit të identitetit (Policia, Zyrat e Gjendjes Civile etj.) dhe të pasaportës elektronike (në pikat e kalimit kufitar)
 - do të ketë edhe modulën e kontrollit të të dhënave biometrike, i cili do të sigurojë unicitetin e identitetit dhe shmangien e tentativave për marrje dhe përdorim të identitetit të shumëfishtë
 - do të jetë i aftë të përshtasë ndryshimet në fushën e kartave me mikroqark të integruar ('chip') dhe të dhënave biometrike ose të dhëna shtesë identifikimi; do të sigurojë verifikimin e identitetit biometrik në çdo kohë; do të sigurojë fshehtësinë e të dhënave biometrike dhe demografike kur ato ruhen në bazën e të dhënave; do të mbrojë fshehtësinë dhe integritetin e të dhënave në kalimet midis sistemeve
- Mbrojtja e të dhënave personale, dhe zbatimi i rekomandimeve të dokumentit të Partneritetit Europian 2007, nëpërmjet përcaktimit të qartë të përgjegjësiave institucionale sipas:
 - ndryshimeve dhe shtesave në aktet ligjore dhe nënligjore
 - krijimit të strukturës dhe procedurave të nevojshme për funksionimin efektiv të autoritetit të pavarur për mbrojtjen e të dhënave
 - ndërgjegjësimin për çështjet dhe standardet e mbrojtjes së të dhënave

Zbatimi i MSA-së

Neni 79 mbulon mbrojtjen e të dhënave personale dhe Neni 81 mbulon pajisjen me dokumente të përshtatshme identifikimi.

3.3 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ndan me vendet anëtare të Bashkimit Europian qëllimin e përbashkët për një zhvillim të baraspeshuar, harmonik dhe të qëndrueshëm, si dhe axhendën e Lisbonës për zhvillimin dhe tregun e punës. Strategjia ka për qëllim të ndërtojë dhe të përmirësojë infrastrukturën bazë, të krijojë kuadrin e duhur mbështetës për biznesin, si dhe të rrisë mundësitë për punësim duke përmbushur kështu edhe qëllimet e përfshirjes sociale.

Infrastruktura

Infrastruktura e dobët ka ngadalësuar nivelin e rritjes ekonomike dhe uljen e varfërisë⁶. Në këtë këndvështrim:

- Zhvillimi i infrastrukturës në rrjetin kombëtar të transportit do të ndihmojë në rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve dhe mallrave, do të afrojë tregjet e për pasojë do të ndihmojë në nxitjen e biznesit, do të rrisë aksesin e njerëzve ndaj shërbimeve elementare por shumë të rëndësishme, si arsimi e shëndetësia duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e tyre të jetesës, ndërkohë që zhvillimi i rrjetit kryesor kombëtar dhe i rrugëve kufitare, i porteve dhe aeroporteve do të ndihmojnë në integrimin me tregun rajonal dhe me atë Europian;
- Investimet në mbrojtje të mjedisit do të ndihmojnë në qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike, do të ulin në mënyrë të ndjeshme koston ekonomike (p.sh. përsa i përket shëndetit publik), si dhe do të ndihmojnë në arritjen e standardeve të përcaktuara nga Bashkimi Europian;
- Prodhimi i energjisë elektrike do të rritet, cilësia e transmetimit dhe e shpërndarjes do të përmirësohet, për të siguruar furnizimin me energji, brenda kuadrit të angazhimeve për liberalizimin e tregut të brendshëm dhe për të marrë pjesë në tregun rajonal energjetik.

Transporti

Sfidat

Pavarësisht nga investimet e mëdha (rehabilitime dhe ndërtime të reja në shumë segmente), rrjeti rrugor është i kufizuar si në shtrirje ashtu dhe në cilësi, krahasuar me vendet e rajonit dhe aktualisht gjendja e tij nuk paraqitet e mirë, edhe për shkak të mungesës së një sistemi efikas mirëmbajtjeje. Zhvillimi i pabarabartë i rrjetit të transportit rrugor është një nga arsyet më të forta të zhvillimit të pabarabartë ekonomik të krahinave të ndryshme të vendit. Ka një përpjesëtim të drejtë midis shkallës së varfërisë dhe nivelit të cilësisë së infrastrukturës rrugore.

Plani Kombëtar për Transportin, i cili është miratuar në maj 2006, argumenton se “në vende të vogla si Shqipëria mund të ketë vetëm një port detar kryesor të përgjithshëm për mallrat”. Për rrjedhojë, rekomandohet që portet shqiptare të zhvillohen sipas avantazheve që kanë në krahasim me Portin e Durrësit, ndërkohë që ky i fundit po zhvillon më tej shërbimet dhe objektet e veta për kontejnerët, mallrat e përgjithshme dhe udhëtarët. Specializimi i porteve synon të mënjanojë dublimin e investimeve të mëdha. Vendimi për t’ia dhënë me koncesion sektorit privat vënien në punë të porteve ngre probleme në lidhje me investimet për rritjen e kapaciteteve dhe për rehabilitimin. Mirëmbajtja e pajisjeve, objekteve, strukturave dhe pastrimi i fundit të detit në Durrës kanë qenë kaq të pamjaftueshme, saqë pajisjet e portit dhe të trajtimit të mallrave duhet të zëvendësohen.

Aktualisht infrastruktura fizike e hekurudhave është e dobët. Si rrjedhojë e akordimit të fondeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së mekanizimit në punimet e mirëmbajtjes, standardet teknike të linjës hekurudhore janë të ulëta dhe nuk garantojnë treguesit për një lëvizje të sigurt. Shpejtësia e lëvizjes së trenave është në nivelin 30-40 km/orë. Sistemi i sinjalizimit në linjë dhe sistemi i ndërlihdjes në disa stacione e kalesa hekurudhore nuk janë funksionale. Ka shumë kalesa në një nivel me linjën hekurudhore, të cilat shpesh janë burim aksidentesh me mjetet rrugore. Sasia e mallrave që transportohet është e vogël, largësia mesatare e transportit tejet e shkurtër dhe numri i punonjësve është relativisht i lartë. Për rrjedhojë situata financiare është deficitare dhe po bëhet pengesë për ndërhyrje më të gjera në përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës dhe superstrukturës hekurudhore. Në këto kushte transporti hekurudhor nuk është tërheqës krahasuar me transportin rrugor.

Vizioni i sektorit

Vizioni është që sistemet, strukturat dhe infrastruktura e transportit, të jenë të tillë që të ndihmojnë realizimin e një transporti të qëndrueshëm që çon në krijimin e një hapësire unike ekonomike,

⁶ Shqipëria: Ruajtja e rritjes së qëndrueshme edhe përtej tranzicionit: Memorandum ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë, dhjetor 2004

brenda territorit shtetëror dhe më tej në rrafshin rajonal e europian. Në këtë mënyrë do të rritet mobiliteti dhe shkëmbimi i mallrave, aksesit ndaj shërbimeve primare si arsimit dhe shëndetësia duke evituar krijimin e qendrave të mbipoplluara.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Këto janë përparësitë strategjike të nënsektorit të transportit:

1. Politika e transportit

Politika e transportit buron nga Plani Kombëtar i Transportit i cili duhet të përditësohet periodikisht. **Masat institucionale kryesore** që i shërbejnë bashkërendimit në fushën e politikave të transportit përfshijnë reformën në sistemin e transportit dhe veçanërisht të agjencive rregullatore. Në Planin Kombëtar të Transportit parashikohet gjithashtu ngritja e një Qendre Kombëtare të Burimeve të Transporteve; një institut kërkimor shkencor për infrastrukturën e transporteve; dhe Njësinë Koordinuese Mjedisore në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

2. Transporti rrugor

- Krijimi i një **kuadri ligjor** të unifikuar, në përputhje me *acquis communautaire*; adoptimi i direktivave dhe aderimi në konventat që ndihmojnë në pranimin në treg të operatorëve shqiptarë.
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për **heqjen e barrierave** që pengojnë ndërkombëtarizimin e shërbimeve të transportit shqiptar.
- Përfundimi i investimeve madhore në rrjetin kombëtar të rrugëve (i cili është thuajse tërësisht i përfshirë në Rrjetin Kryesor rajonal) që përfshin:
 - Korridorin **Veri-Jug**, veçanërisht segmentet rrugore Lushnjë-Fier-Tepelenë-Gjirokastrë dhe Shkodër-Hani i Hotit;
 - Korridorin **Lindje-Perëndim** (Korridori VIII), veçanërisht segmenti Fier-Vlorë dhe Durrës-Rrogozhinë;
 - Korridorin **Durrës-Morinë**, i cili do të përfundojë në tri faza;
 - **Rrugët turistike**, veçanërisht Dhërmi-Sarandë, por edhe rrugët hyrëse për në Velipojë, Dardhë, Butrint, Divjakë, Patok, Lalëz dhe Spille;
 - Segmentet rrugore që ndërlidhin **pikat e kalimit kufitar**, veçanërisht rruga Sarandë-Konispol, segmenti Leskovik-Tri Urat, rruga e Liqenasit, rruga Has-Qafë Prush, si dhe rruga e Arbërit.
- Hartimi dhe zbatimi i një programi investimesh për përmirësimin e **rrugëve lokale dhe rurale** në bashkëpunim me qeverinë vendore.
- Nxitja e ndërtimit të rrugëve me **koncesion**;
- **Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve** si dhe forcimi i kapaciteteve projektuese dhe zbatuese të projekteve infrastrukturore me miratimin e standardeve të projektimit të rrugëve;
- Përmirësimi i **mirëmbajtjes** së rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore (duke përfshirë urat), privatizimit të plotë të shërbimeve, si dhe dyfishimit të shpenzimeve për mirëmbajtjen;
- Ndërtimi i **terminaleve për linja autobusësh** kombëtarë dhe ndërkombëtarë në Tiranë, në bashkëpunim me qeverisjen lokale, dhe gjithashtu ndërtimi i terminaleve të autobusëve edhe në qytete të tjera të rëndësishme, si Durrësi, Shkodra dhe Vlora;
- Promovimi i masave për **sigurinë rrugore**, veçanërisht përafrimi i legjislacionit duke u përqendruar kryesisht te parandalimi i aksidenteve dhe pakësimi i ndotjes nga automjetet (standartet për nivelin e lëshimit të gazrave ndotës dhe të nivelit të zhurmave nga mjetet e rënda), përmirësimi i kushteve të sigurisë së rrugëve në infrastrukturë (p.sh. përmirësimi i sinjalizimit rrugor), kontrolli teknik i mjeteve, procedurat e auditimit të rrugëve, përmirësimet në cilësinë e mësimdhënies për drejtimin e mjetit, si dhe në procedurat e testit për kandidatët për leje drejtimi të mjetit.

3. Transporti detar

- **Krijimi i Administratës Detare**, me të gjitha institucionet dhe strukturat e nevojshme politikëbërëse, zbatuese dhe kontrolluese, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ristrukturimin e regjistrimit detar shqiptar dhe të kapitenerive të porteve.
- **Zhvillimi i porteve mbi bazën e master-planeve**, që do të konsistojë në specializimin dhe zhvillimin e harmonizuar, duke rehabilituar dhe zgjeruar infrastrukturën, superstrukturën, përfundimin e privatizimit të shërbimeve, futjen e teknologjive bashkëkohore me koncesion, rritjen e pavarësisë komerciale dhe orientimi i tyre drejt ekonomisë së tregut:
 - Porti i Durrësit, si porti më i madh në vend, do të zhvillohet mbi bazën e master-planit të ri, që po hartohet si një port administrues toke (*'landlord port'*), me pavarësi komerciale;
 - Zhvillimi i porteve të Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës do të bëhet mbi bazën e master-planeve të secilit port, me financim të donatorëve të huaj dhe buxhetit të shtetit;
 - Kryerja e një studimi mbi zhvillimin e kapaciteteve të porteve komerciale, për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit.
- **Zhvillimi i transportit detar** nëpërmjet rritjes së standardit teknik të anijeve, nivelit të menaxhimit të tyre dhe përputhjes me strukturën e mallrave të eksport-importit.
- **Siguria e jetës në det**, siguria në anije dhe e pajisjeve portuale mbi bazën e kërkesave të Konventës SOLAS 1974 dhe amendamentit të Kodit ISPS.
- **Mbrojtja e mjedisit detar** në përputhje me kërkesat e Konventës MARPOL 73/78 duke realizuar projektin me qendrën e REMPEC-ut në Maltë.
- **Arsimimi dhe trajnimi i detarëve** në përputhje me kërkesat e Konventës STCW 1995 "Për standardin e trajnimit, certifikimit dhe shërbimeve të detarëve".

4. Transporti hekurudhor

- **Ristrukturimi i metejshëm i Hekurudhës Shqiptare** me qëllim përmirësimin e menaxhimit, të marketingut dhe shëndoshjen e situatës financiare të kësaj shoqërie bazuar në rekomandimet e plan-biznesit 5-vjeçar;
- **Përafrimi i legjislacionit hekurudhor** me atë të BE;
- **Integrimi i rrjetit kombëtar hekurudhor në rrjetin rajonal**, përmes ndërtimit të linjës hekurudhore me Maqedoninë;
- **Rinovimi gradual i infrastrukturës hekurudhore**, sidomos të trungut kryesor;
- **Rinovimi i mjeteve lëvizëse** me përparësi modernizimin e trenave të udhëtarëve.

5. Transporti ajror

- **Hartimi i Kodit Ajror** të Republikës së Shqipërisë dhe ratifikimi i tij në Kuvendin e Shqipërisë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe *acquis communautaire*;
- **Anëtarësimi me të drejta të plota në struktura ndërkombëtare** dhe plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga angazhimet për të pasur një Hapësirë të Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA), Single Europe Sky (SES) dhe blloqet funksionale;
- **Përmirësimi i sistemit rregullator**, ndryshime institucionale dhe krijimi i enteve të reja në përputhje me *acquis communautaire* në fushën e transportit ajror;
- **Përfundimi i studimit mbi transportin e brendshëm ajror**, i cili do të japë perspektivën e ngritjes dhe zhvillimit të transportit të brendshëm ajror

Zbatimi i MSA-së

Çështjet që lidhen me sektorin e transportit përfshihen në Nenet 52, 59 dhe 106. Përveç kësaj, Protokollin 5 trajton problemet që lidhen me transportin tokësor.

Energjetika

Sfidat

Sektori i energjetikës mbetet një sektor prioritar në politikat e Qeverisë si dhe një sektor me zhvillim të paqëndrueshëm, siç e kanë treguar edhe krizat e energjisë elektrike të viteve 2002 dhe 2007. Fushat kryesore të këtij sektori janë: sektori i hidrokarbureve (i naftës dhe gazit) që përbën rreth 61-63% të bilancit të burimeve energjetike në shkallë vendi; sektori elektro-energjetik me rreth 25-27% të bilancit të burimeve energjetike në shkallë vendi; dhe sektori i energjive të tjera (energji të rinovueshme) që zenë rreth 11-13% të bilancit të burimeve të energjisë në shkallë vendi. Problemet me të cilat është përballur sektori energjetik shqiptar gjatë këtyre viteve janë:

- Kapaciteti i prodhimit të energjisë elektrike është i pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesën aktuale në vend. Për pasojë furnizimi me energji elektrike i konsumatorëve shoqërohet me ndërprerje dhe kufizime të saj;
- Mungesa e burimeve termike për prodhimin e energjisë elektrike dhe varësia totale nga kushtet hidrologjike është një faktor tjetër i vështirësive në furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike;
- Shqipëria ballafaqohet me kapacitete të kufizuara në importin e energjisë elektrike pasi linjat ekzistuese të interkonjeksionit me vendet fqinje kanë kapacitete jo të mjaftueshme për të përballuar importin e energjisë elektrike në Shqipëri. Gjithashtu edhe kapacitetet transmetuese të rajonit, kufizojnë importet e energjisë elektrike në Shqipëri;
- Mungesa e lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale dhe europiane të naftës-jellësve e gazës-jellësve për furnizimin e vendit me burime energjetike hidrokarbure;
- Mungesa e sektorit tregtar të gazit natyror dhe mosfunksionimi i tregut të gazit;
- Humbjet jo-teknike mbeten ende relativisht të larta në Shqipëri. Ato janë rezultat i faktorëve të ndryshëm, sidomos i lidhjeve ilegale dhe i ndërhyrjeve në sistemin e matjes së energjisë elektrike;
- Humbjet teknike të larta në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes si rezultat i rrjetit të amortizuar dhe të pamjaftueshëm;
- Vlera të larta të konsumit të energjisë elektrike për ngrohje dhe ftohje të hapësirave pasi energjia elektrike përdoret ende gjerësisht për ngrohjen dhe ftohjen e banesave, si dhe për gatim. Kjo është dhe një arsye më shumë për pamundësinë e sistemit energjetik për të garantuar një furnizim të rregullt për shërbimet e tjera;
- Mungesa e liberalizimit të çmimit të energjisë elektrike dhe fakti që lëndët e tjera djegëse nuk janë shumë atraktive për përdorim për ngrohje dhe gatim;
- Infrastruktura jo e zhvilluar dhe jo adekuate e import-eksportit në rrugë detare dhe hekurudhore e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- Përdorimi i lëndëve djegëse jo tërësisht sipas standardeve europiane, si dhe prania në qarkullim e automjeteve të transportit relativisht të vjetra, që ulin efikasitetin dhe rrisin ndotjen e mjedisit;
- Mospërfundimi i procesit të privatizimit të plotë të sektorit publik në industrinë shqiptare të naftës kryesisht për aktivitetet e përpunimit dhe të shërbimeve, si dhe mosarritja e rinovimit teknologjik në parametra bashkëkohore të kësaj industrie;
- Përdorimi jo eficient i energjisë elektrike dhe energjive të tjera, si rezultat i keq izolimit të banesave dhe përdorimit të pajisjeve me efikasitet të ulët.

Për zgjidhjen e problemeve të trajtuara më lart, janë përcaktuar objektiva konkrete dhe politika të qarta, që janë reflektuar në një sërë dokumentash të këtij sektori. Që nga viti 2001 po zbatohet një Plan Veprimësh për Sektorin Elektroenergjetik, që përditësohet çdo vit.

Vizioni i sektorit

Reformimi i këtij sektori, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i një sistemi energjetik në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut, hapja dhe liberalizimi i mëtejshëm i tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimi i tij në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike dhe politikat për arritjen e këtij vizioni janë:

- Reformimi dhe ristrukturimi i sektorit energjetik shqiptar, bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjetike për krijimin e **kuadrit efektiv institucional dhe rregullator** të shoqërive publike energjetike, me synim privatizimin e shpejtë të tyre. Reforma do të përqendrohet në rradhë të parë në ristrukturimin e sektorit të energjisë elektrike duke kaluar nga struktura vertikalisht e integruar e sh.a. KESH, në shoqëri të ndara sipas funksioneve, pra në prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim, me synim privatizimin e tyre dhe liberalizimin e sektorit. Këtij qëllimi do t'i shërbejë dhe Modeli Shqiptar i Tregut të energjisë elektrike, i cili është miratuar nga Qeveria Shqiptare. Kjo do të shoqërohet me përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për nxitjen e investimeve private në prodhimin e energjisë elektrike (ligji i ri për koncesionet është një prej tyre), në sektorin e shpërndarjes së energjisë (shoqëruar me riorganizimin e KESH-it), në sektorin e hidrokarbureve (privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese), si dhe përmes inkurajimit të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.
- Nxitja e rritjes së **efiçencës së energjisë**, si në shfrytëzimin e burimeve energjetike edhe nëpërmjet reduktimit të konsumit të energjisë elektrike, nëpërmjet programeve respektive të efiçencës, për sektorë të ndryshëm, forcimit të kuadrit ligjor për përdorimin ekonomik të energjisë; përmirësimin të punës në zbatim të ligjit për efiçencën e energjisë (e theksuar edhe në kuadër të Partneritetit Europian të vitit 2007); uljes së konsumit të energjisë në sektorin e banesave (ndryshime në strukturën tarifore, nxitja e përdorimit të llampave elektrike ekonomike, përdorimi i termoizolimit etj.); nxitjes së përdorimit të teknologjive moderne në sektorin e industrisë, shërbimeve dhe bujqësisë për furnizimin me energji sa më ekonomike; nxitja e menaxhimit më të mirë dhe e efiçencës më të lartë të sektorit të transportit, që është sektori me pjesën më të madhe në konsumin e burimeve energjetike, etj.
- Rritja e **ofertës energjetike** në bazë të konceptit të planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim sa më të paktë në mjedis. Në këtë kuadër, investimet parashikohen në drejtimet e mëposhtme:

1. Prodhimi

- Rritja e kapaciteteve të instaluara për prodhimin e energjisë elektrike, duke realizuar njëkohësisht dhe diversifikimin e tyre. Për këtë qëllim është parashikuar që domosdoshmërisht të ndërtohen rreth 1000 MW fuqi e instaluar shtesë, prej të cilave rreth 500 MW do të jenë hidrocentrale dhe rreth 500 MW termocentrale, si dhe do të jetë materializuar në projekt konkret, ideja e inicimit të procesit përgatitor për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia bërthamore.

Gjatë periudhës 2007-2013 do të ndërtohen këto hidrocentrale:

- Hidrocentrali i Kalivacit mbi lumin e Vjosës, që është në ndërtim, me 93 MW;
- Hidrocentralet mbi lumin Devoll me fuqi rreth 350 MW;
- Hidrocentrali i Ashtës me fuqi nga 40 deri në 70 MW;
- Hidrocentrale të vegjël dhe të mesëm, me koncesion me fuqi rreth 200 MW;

Janë në proces diskutimi:

- Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës me kapacitet rreth 350 MW;
- Ndërtimi hidrocentraleve mbi lumin Vjosë me kapacitet rreth 400 MW;

Gjatë periudhës 2007 - 2013 do të ndërtohen këto termocentrale:

- Termocentrali i Vlorës me fuqi 97 MW;
- Termocentrali i Fierit me fuqi deri në 200 MW (rehabilitim)

Janë në proces diskutimi:

- Termocentrale të tjera me iniciativë private, prej të cilëve mund të përmendet termocentrali në afërsi të zonës së Semanit në Fier, me disa blloqe 400 MW secili, si dhe termocentrali i Porto Romanos në afërsi të Durrësit (me fuqi nga 800 -1600 MW).
- Gjithashtu do të punohet për bashkëfinancimin e ndërtimit të termocentraleve me linjit në Kosovë.
- Rritja e efektivitetit të investimeve strategjike për **zbulimin e vendburimeve të reja të naftës e gazit**, si dhe për rritjen e prodhimit të naftës në vendburimet ekzistuese në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure që janë lidhur me kompanitë e huaja, për të arritur në një plotësim më të mirë të kërkesave të tregut për nënprodukte nafte, duke u mbështetur në prodhimin vendas.
 - Marrëveshjet hidrokarbure për kërkimin dhe zbulimin e hidrokarbureve në blloqet e kërkimit në det (Blloku Durrës dhe Blloku Jon-5), si dhe në tokë (Blloqet A-B dhe Blloqet D-E);
 - Marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin e prodhimit në vendburimet ekzistuese (Vendburimi Patos Marinë; vendburimi Kuçovë; vendburimet karbonatike Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, si dhe Blloku Delvinë).

2. Transmetimi

- Rritja e kapaciteteve të transmetimit të energjisë elektrike, për ta kthyer Shqipërinë në një nryje të rëndësishme të tranzitimit të flukseve të rajonit në drejtimet veri-jug dhe lindje-perëndim, me qëllim sigurimin jo vetëm të importit të energjisë elektrike të nevojshme, por për të realizuar një tregti efektive të kësaj energjie. Objektet më të rëndësishme që do të realizohen gjatë kësaj periudhe në sektorin e transmetimit janë:
 - Ndërtimi i linjës 400 kV të interkonjeksionit Elbasan-Podgoricë;
 - Ndërtimi i linjës 400 kV të interkonjeksionit Tiranë-Prishtinë;
 - Ndërtimi i nënstacionit të ri 400 kV në Kashar, Tiranë;
 - Ndërtimi i Qendrës së Re Kombëtare Dispeçer;
 - Ndërtimi i linjës 400 kV të interkonjeksionit Maqedoni-Shqipëri-Itali;
 - Rehabilitimi dhe fuqizimi i të gjithë nënstacioneve 220 dhe 400 kV të sistemit.
- Konkretizimi i lidhjes së vendit tonë me rrjetet rajonale të naftës dhe gazit, nëpërmjet konkretizimit të projekteve të paraqitura nga investitorë të huaj strategjikë që janë përfshirë edhe në projektet rajonale sikurse është 'Energy Community Gas Ring'. Ndër propozim-projektet kryesore mund të përmendim:
 - Projekti i gazsjellësit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (TAP) i propozuar nga kompania zvicerane EGL në një bashkim 50% me 50% me kompaninë norvegjeze StatoilHydro;
 - Projekti i gazsjellësit Ionian Adriatic Pipeline (IAP) për lidhjen me rrjetin e gazsjellësit në drejtimin Kroaci, Mali i Zi, Shqipëri;
 - Projekti për ndërtimin e Terminalit të Gazit Natyror të Lëngëzuar e kombinuar me ndërtimin e një TEC-i me kapacitet clori 1200MW. në zonen e Semanit nga kompania zvicerane ASG;
 - Projekti për ndërtimin e Terminalit të Gazit Natyror të Lëngëzuar në bregdetin e Qarkut të Fierit (në veri të grykëderdhjes së lumit Vjosë), nga kompania italo-holandeze Trans European Energy BV;
 - Ndjekja e procedurave për zbatimin e akteve të miratuara për ndërtimin e naftës-jellësit transballkanik AMBO, duke rritur dhe përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit të përfshira në këtë projekt.

3. Shpërndarja

- Gjatë vitit 2008 parashikohet të privatizohet sektori i shpërndarjes së energjisë elektrike, proces që ka filluar nga viti 2007. Pavarësisht nga ky objektivi mjaft i rëndësishëm, për të rritur suksesin në privatizim po punohet për të rritur performancën e sh.a. KESH, duke përmirësuar treguesit e humbjeve dhe të arkëtimeve në këtë sektor, duke realizuar njëkohësisht vendosjen e matësave, mënjanimin e lidhjeve të paligjshme, ndërtimin e linjave 110/20 kV dhe të kabllave nëntokësorë për zonat kryesore urbane, dhe rehabilitimin e rrjetit rural (duke përfshirë edhe ndërtimin e 6800 pikave transformuese me karakteristika të standartizuara).

4. Hidrokarburet

- Diversifikimi i burimeve të furnizimit të tregut me produkte energjetike hidrokarbure nëpërmjet zhvillimit të një infrastrukture moderne dhe efektive të import-eksportit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre përmes realizimit të kontratave koncesionare për ndërtimin e terminaleve bregdetare të import-eksportit të nënprodukteve të naftës në Porto Romano, Durrës dhe në zonën e ish Uzinës së Sodë PVC, në Gjirin e Vlorës.
- Perfundimi i procesit të privatizimit të shoqërisë publike të përpunim-tregtimit "ARMO" sh.a.;
- Zhvillimi i projekteve të integruara për objektet e sektorit energjetik, sikurse është Zona Energjetike dhe Industriale e Porto-Romano, Durrës, në të cilën përfshihen objekte për transportimin, depozitimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve hidrokarbure, objekte për gjenerimin e energjisë elektrike, si dhe një sistem i zhvilluar i transportit të energjisë;
- Rritja e mëtejshme e rolit rregullator të shtetit në tregun e produkteve energjetike hidrokarbure. Realizimi i një furnizimi të sigurt dhe të garantuar të tregut duke respektuar kërkesat e BE për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, përmirësimi i sigurisë dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe të produkteve në treg për arritjen e standardeve të BE;
- Do të punohet për njohjen e rregullave dhe procedurave që mundësojnë në të ardhmen zhvillimin e energjisë bërthamore, gjithmonë në zbatim të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
- Rritja e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme. Në veçanti do të synohet për:
 - Hartimin e një ligji të veçantë për energjitë e rinovueshme, që do të bazohet në Direktivën 2001/77 të Bashkimit Europian dhe që do të përcaktojë qartë procedurat e autorizimit të ndërtimit të tyre, si dhe do të tërheqë investitorë të huaj dhe vendas në këtë biznes, veçanërisht për centralet e erës, për të cilat ka mjaft shprehje interesi;
 - Përmirësimin e kuadrit nënligjor dhe rregullator, për të nxitur përdorimin e paneleve diellore, sidomos në ngrohjen e ujit sanitar dhe teknologjik;
 - Ligji i ri për koncesionet hapi mundësi të medha për thithjen e investimeve private në ndërtimin e HEC-eve të vegjël. Në këtë kuadër do të punohet për përmirësimin dhe kompletimin e të gjithë kuadrit ligjor dhe rregullator;
 - Miratimi i ligjit nr. 9876, datë 14.2.2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport" si një zbatim i detyrimeve të Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë për implementimin e Direktivës 2003/30/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian në 8 Maj 2003, për promovimin e përdorimit të biokarburanteve (lëndëve djegëse organike) ose të karburanteve të tjera të rinovueshme për transportin. Plotësimi i kuadrit ligjor dhe teknik përkatës, krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve për prodhimin dhe përdorimin e biokarburanteve edhe në Shqipëri, duke zhvilluar një aktivitet me ndikim direkt në disa fusha të ekonomisë (energjetika, transporti, bujqësia, etj.).
- Hapja e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja aktive në tregun energjetik rajonal. Kjo do të bëhet në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian për reformimin e

sektorit të energjisë elektrike (Direktiva 54/2003) dhe sipas detyrimeve të marra në kuadër të Traktatit të Krijimit të Komunitetit për Energjinë të Europës Juglindore.

- Këto reforma synojnë që përveç ndarjes në sektorët e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të KESH-it dhe privatizimin e sektorit të shpërndarjes, të hartohet dhe kuadri i nevojshëm ligjor dhe nënligjor për funksionimin e tij. Deri tani është hartuar dhe miratuar Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, është në procedure miratimi amendimi i ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe po përgatitet kuadri rregullator, me qëllim që procesi i privatizimit të sektorit të shpërndarjes të paraqitet me një kuadër të plotë të funksionimit të tregut;
- **Zhvillimi i tregut të gazit natyror**, nëpërmjet krijimit të mundësive për furnizimin e vendit me gaz natyror, si një produkt energjetik që garanton siguri furnizimi me një sjellje miqësore ndaj mjedisit. Kompletimi i kuadrit rregullator ligjor dhe teknik, si dhe e atij institucional, në përputhje me standardet e vendeve të rajonit dhe me Direktivat e BE (Direktiva 2003/55/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 Qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror), si dhe në zbatim të detyrimeve që ka vendi ynë në kuadër të Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë (ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006).

Zbatimi i MSA-së

Çështje të lidhura posaçërisht me sektorin energjetik mbulohen në Nenin 107.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Sfidat

Në kontekstin e angazhimit për të përmbushur direktivat përkatëse të BE lidhur me shërbimin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, vendi përballet me një kompleks problemesh. Problemet kryesore janë:

- Niveli i ulët i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, veçanërisht në zonat rurale, duke e radhitur Shqipërinë në pozicion më të ulët krahasuar me vendet e tjera të Europës;
- Rreziqet potenciale për shëndetin e popullatës si rrjedhojë e pamundësisë për të mbajtur rrjetin e furnizimit me ujë nën presion të vazhduar dhe mungesës së dizinfektimit të ujit;
- Menaxhimi i keq në tërësi, përdorimi me efikasitet të ulët të burimeve njerëzore dhe pamundësia e menaxhimit të kërkesës për ujë si pasojë e mungesës së matësve ka sjellë nivel të lartë humbesh dhe vështirësi financiare të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve;
- Tarifat e ulëta dhe faturat e pabazuara në konsumin e ujit, të cilat nuk stimulojnë kursimin e ujit;
- Niveli i ulët i performancës financiare të shoqërive të ujësjellësve ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen me subvencione nga buxheti i qeverisë për mbulimin e rreth 34% të kostos operacionale të pambuluar nga arkëtimet;
- Investimet në ujësjellësa, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza nuk kanë qenë të orientuar në zonat në zhvillim dhe me potencial për zhvillimin e turizmit;
- Mirëmbajtja e rrjetit jo gjithmonë është parë me vëmendje të veçantë.

Vizioni i sektorit

Vizioni afatgjat për këtë sektor jetik, është zhvillimi në vijimësi për të siguruar kushtet bazë të higjienës sipas standardeve europiane, duke stimuluar një rritje të qëndrueshme ekonomike, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e nivelit të jetesës në vend. Qëllimi final është furnizimi me ujë të pandërprerë e të sigurtë dhe largimi e trajtimi i të gjitha ujërave të ndotura.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Qeveria ka përcaktuar synimet kryesore si më poshtë:

- rritjen graduale të mbulimit me këto shërbime respektivisht për furnizimin me ujë nga 73% në 98% dhe për kanalizimet nga 43% në 80%, deri në vitin 2015;

- rritjen graduale të mbulimit me shërbimin e trajtimit të ujërave të përdorura në 50% të popullsisë, deri në vitin 2015;
- përmirësimin e cilësisë së ujit duke ulur në minimum rastet e ndotjeve në sistem dhe duke siguruar normën e klorit mbetës nga 48% në 100% të kampioneve, deri në vitin 2015;
- përmirësimin e cilësisë së shërbimit duke rritur orët mesatare të furnizimit me ujë në shkallë vendi nga 9.7 orë në ditë në 18 orë në ditë, deri në vitin 2015;
- përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e të ardhurave deri në nivelin e mjaftueshëm për të mbuluar koston totale të shërbimit, duke garantuar një shërbim të përballueshëm edhe për shtresat sociale në nevojë, deri në vitin 2015;
- eliminimin gradual të subvencioneve për shpenzimet operative në periudhën afatmesme me një ulje vjetore mesatare të subvencioneve në të gjithë vendin jo më pak se 10% që në vitin 2008;
- përmirësimin e cilësisë së monitorimit dhe sistemit të vlerësimit të krahasuar; të gjitha rezultatet do të bëhen publike dhe do të përdoren për të orientuar investimet në drejtimet që ndikojnë në përmirësimin e performancës;
- konsolidimin dhe komercializimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat; dhe përmirësimin e performancës financiare përmes liberalizimit të tarifave dhe menaxhimit të kërkesës.

Politikat kryesore për periudhën afatmesme dhe afatgjatë janë si më poshtë:

Në fushën e reformës së **menaxhimit**:

- Instalimi i sistemit të matjes në prodhim dhe në shpërndarje dhe instalimi i sistemit të kompjuterizuar të faturimit dhe arkëtimit për të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve;
- Përgatitja dhe vënia në jetë e një programi kombëtar të kualifikimit të personelit në sektor;
- Forcimi i monitorimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Entit Rregullator të Ujit;
- Fillimi i programeve për ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin e bashkësisë në lidhje me konsumin e ujit të pijshëm;
- Masat afatgjata: realizimi i detyrueshëm i matjes së konsumit për të gjithë; vijimi i monitorimit dhe vlerësimit të krahasuar dhe bërja publike e informacionit përkatës; krijimi i qendrës së formimit profesional me vetëfinancim për punonjësit dhe autoritetet vendore; vazhdimi i sistemit të trajnimit të personelit në qendra të specializuara dhe në shoqëritë e ngjashme në vendet e përparuara; realizimi i detyrueshëm i planit të biznesit për çdo shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve; menaxhimi i kompjuterizuar i sistemeve hidraulike të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në modelet kompjuterike të tyre; dhe mbështetja e programeve për ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin e bashkësisë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Në fushën e reformës **institucionale**:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të shërbimit midis njësive vendore dhe shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve;
- Përfundimi i planeve 5-vjeçare të biznesit për të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve;
- Ndërmarrja e studimit për rajonalizimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi dhe fillimi i procedurave të rajonalizimit;
- Masat afatgjata: përgatitja e akteve nënligjore për të lehtësuar format e përparuara të pjesëmarrjes së sektorit privat; përfundimi i procesit të rajonalizimit dhe krijimi i ekonomive të shkallës.

Në fushën e reformës **financiare**:

- Hartimi dhe zbatimi i programit të përmirësimit të nivelit të arkëtimit me objektiva tremujorë;

- Vendosja e tarifave të studiuara të ujës-jellës-kanalizimeve për të arritur gradualisht nivelin e mbulimit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes brenda një periudhe 4-vjeçare dhe eliminimin e subvencioneve;
- Përfshirja në tarifë e shërbimit për kanalizimet e ujërave të zeza dhe impiantet e pastrimit në të gjitha ndërmarrjet;
- Aplikimi i tarifave të diferencuara për konsumin e ujit përtej normave të miratuara;
- Aplikimi në ndërmarrje për sistemin e kontabilitetit me bazë koston;
- Masat afatgjata: dhënia e subvencioneve vetëm për ato ndërmarrje të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston dhe që arrijnë objektivat në lidhje me cilësinë e shërbimit, performancën financiare dhe mbrojtjen e mjedisit; rritja e tarifave për të mbuluar koston e plotë të furnizimit me ujë si dhe një pjesë të koston së impianteve të pastrimit, përfshirë edhe zhvlerësimin e aktiveve dhe shpenzimet për shlyerjen e borxheve.

Në fushën e reformës sociale:

- Vënia në jetë e planit të furnizimit për nevojat jetësore me një minimum sasi uji falas;
- Subvencionimi i familjeve më të varfra për faturën e ujit me anë të ndihmës sociale;
- Përfshirja e dispozitave për t'u shërbyer të varfërve në të gjitha kontratat e reja që do të hartohen edhe në rastin e pjesëmarrjes së sektorit privat;
- Masat afatgjata: zbatimi i skemës së subvencionimit të të varfërve nëpërmjet ndihmës ekonomike, si dhe garantimi i sasisë minimale jetike uji për një periudhë të kufizuar për jo-paguesit.

Në fushën e reformës teknike:

- Krijimi i normave të reja teknike dhe i standardeve të projekteve teknike;
- Përgatitja e master-planit kombëtar për sistemet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe pastrimit të ujërave të ndotura bazuar në një Sistem Gjeografik Informacioni;
- Përgatitja e një programi afatmesëm me përparësitë për investimet kapitale;
- Përgatitja e një programi afatgjatë për investimet kapitale bazuar në master-planin kombëtar;
- Masat afatgjata: përditësimi i normave teknike dhe hartimi i standardeve të projekteve teknike në përputhje me mundësinë dhe aderimin në BE; përditësimi i programit afatmesëm me përparësi për investimet kapitale.

Mjedisi

Sfidat

Gjendja aktuale në lidhje me përmbushjen e standardeve të BE për mjedisin është si më poshtë:

- Cilësia e ajrit në qendrat kryesore urbane vërteton qartë se nuk respektohen disa norma të cilësisë së ajrit, qoftë europiane, apo kombëtare. Veçanërisht nivelet e pluhurit dhe shkarkimet nga automjetet i kalojnë standardet e vendosura në legjislacionin kombëtar dhe atë europian.
- Cilësia e ujërave të larjes në zonat bregdetare është në nivel mesatar deri në të ulët. Nga 70 stacione monitorimi 60 janë brenda rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Në 10 prej 70 stacioneve të monitorimit vlerat e parametrave mikrobiologjikë në stinën e verës i kalojnë normat e lejuara.
- Zhurmat janë një problem i zakonshëm urban. Burimet e tyre kryesore janë transporti, gjeneratorët, ndërtimet, industria dhe disa aktivitete tregtare. Për këtë qëllim, është miratuar një ligj për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis sipas modelit të direktivës përkatëse të BE dhe janë miratuar nivelet kufi të zhurmave për mjedise të caktuara.
- Prodhimi total i mbetjeve urbane në Shqipëri i kalon të 722.000 tonët në vit. Ritmi mesatar i prodhimit të mbetjeve është 250 kg për frymë të popullsisë në vit në zonat urbane dhe 170 kg në

vit për zonat rurale. Menaxhimi i mbeturinave në Shqipëri është në nivel të ulët dhe paraqet probleme për grumbullimin pranë qendrave urbane dhe sidomos për përpunimin e mbetjeve në pika të caktuara.

- Erozioni i tokës njihet gjerësisht si mjaft problematik dhe shkaktohet nga keqadministrimi i tokës bujqësore dhe i pyjeve. Nivelet e ndotjes kimike të tokave janë relativisht të ulëta. Megjithatë në Shqipëri ekzistojnë ende disa pika të nxehta të ndotjes, të trashëguara nga industria e dikurshme.
- Zonat e mbrojtura përfshijnë sot afërsisht 10,4% të territorit të vendit, ose një sipërfaqe prej 303 000 ha. Megjithatë, rrjeti kombëtar është ende tepër i vogël për të pasur ndikim efektiv afatgjatë në mbrojtjen e biodiversitetit.
- Pyjet dhe kullotat mbulojnë sot rreth 1,5 milionë hektarë ose 52% të sipërfaqes totale të Shqipërisë. Mbështetur në të dhënat kadastrale të vitit 2005, pyjet zënë afër një milion hektarë ose 37% të sipërfaqes totale të Shqipërisë. Statistikat e kohëve të fundit tregojnë se kjo sipërfaqe është relativisht e qëndrueshme.
- Vendi i sektorit të peshkimit në ekonominë shqiptare është ende i vogël. Konsumi i prodhimeve të peshkut është rreth 3,3 kg/frymë në vit nga 15,1 kg/frymë që është për vendet e Mesdheut.

Vizioni

Vizioni është zhvillimi i qëndrueshëm i vendit, duke ruajtur në maksimum burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, duke promovuar vlerat mjedisore.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit janë si më poshtë:

- **Miratimi i standardeve ligjore të Komunitetit European.** Kjo është një kërkesë për procesin e anëtarësimit, kurse veprimet që kërkohen për ta arritur këtë janë përcaktuar në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Legjislacioni i ri do të vendosë objektiva të ndërmjetëm, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve sipas një vlerësimi të kostos, për të krijuar një qasje me faza për arritjen e standardeve;
- **Kontrolli i zbatimit të legjislacionit** përmes fuqizimit të Agjencive Rajonale Mjedisore dhe Inspektorateve përkatëse, përmirësimeve në sistemin e dhënies së lejeve, dhe masa të dukshme kundër shkelësve më problematikë të ligjit;
- **Investimi për mbrojtjen mjedisore** për të arritur standardet e Komunitetit European brenda 20 viteve në fushat e mëposhtme:
 - Trajtimi i ujërave të zeza;
 - Administrimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve të kontrolluara sipas standardeve të BE;
 - Mbyllja e vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane;
 - Rehabilitimi i terreneve të kontaminuara dhe vatrave të ndotjes;
 - Përmirësime teknologjike industriale.

Kostoja e një programi të tillë do të jetë e madhe. Ndonëse komercializimi i shërbimeve është arritur në disa zona, përsëri ai ndodhet në një fazë fillestare. Tarifat aktuale për shërbimet janë relativisht të ulëta dhe nuk mund të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të bërë investime financiare të suksesshme për një operator komercial. Shpenzimet aktuale publike për elementet e këtij programi janë të pamjaftueshme për të arritur një gjë të tillë gjatë periudhës 20-vjeçare të cituar më lart. Për të nxitur investimet në mjedis, qeveria do të krijojë Fondin për Mjedisin që të sigurohen financimet fillestare në projektet e investimeve mjedisore.

- **Menaxhimi i burimeve mjedisore** nëpërmjet një kuadri të qartë ligjor, të zbatuar përmes një sistemi lejesh të monitoruar dhe kontrolluar mirë. Fushat që kërkojnë vëmendje janë: burimet

minerare, zonat e mbrojtura, toka, mbrojtja e florës dhe faunës, burimet ujore dhe të drejtat për ujërat (sidomos një sistem planifikimi dhe fuqizimi i autoriteteve të pellgjeve);

- **Mbrojtja e pyjeve.** Kjo përparësi përfshin: nxitjen e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave drejt konservimit natyror, mirëmbajtjes së biodiversitetit dhe zhvillimit të ekoturizmit; rehabilitimin e pyjeve të degraduara, për t'i kthyer në kushte optimale të stacionit pyjor përkatës; vazhdimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave tek njësitë e qeverisjes vendore; marrjen e masave për prerjet e paligjshme;
- **Menaxhimi i burimeve peshkore.** Kjo përparësi përfshin: shtimin e numrit të anijeve të reja, zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale të peshkimit me infrastrukturën e riparimit, mirëmbajtjes së anijeve në të katër portet e vendit; zhvillimin e akuakulturës; rritjen e përpunimit të prodhimeve peshkore vendase; forcimin e kapaciteteve administrative dhe bashkërendimin në nivel kombëtar e vendor;
- **Përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit.** Niveli aktual i ndërgjegjësimit mjedisor është i ulët, prandaj ka çuar në sjellje dëmtoese nga ana e qytetarëve. Do t'u kushtohet vëmendje masave të cilat ofrojnë informacion për publikun, përmirësojnë ndërgjegjësimin për kërkesat ligjore dhe nxisin sjelljen që nuk e dëmton mjedisin;
- **Përmirësimi i sistemit të monitorimit.** Përcaktimi i objektivave kryesorë kërkon të dhëna për monitorimin e shkarkimeve të gazta dhe për gjendjen e mjedisit, të cilat për shumë çështje nuk janë të disponueshme në Shqipëri. Objektivat konkretë të strategjisë përqendrohen kryesisht në arritjen e uljes së trysnisë mbi mjedisin, në mënyrë që të arrihet zbatimi i standardeve në lidhje me kufizimet e shkarkimeve;

Përmbushja e objektivave në lidhje me cilësinë e mjedisit do të arrihet vetëm në një fazë të mëvonshme; megjithatë, propozohen objektiva për përmirësimin e mjedisit.

- **Cilësia e ajrit:** Përgjysmimi i rasteve të mospërmbushjes së objektivave dhe mënjanimi i shkeljeve të standardeve, të cilat janë më shumë se dyfishi i standardit për vitin 2009, nëpërmjet:
 - Përdorimit të lëndëve djegëse sipas standardit të KE-së në të gjitha mjetet lëvizëse rrugore dhe kontrollit të detyrueshëm efektiv për çlirimin e gazrave për të gjitha mjetet lëvizëse rrugore sipas standardeve të KE-së brenda fundit të vitit 2008;
 - Pakësimit të çlirimeve për të gjitha komplekset industriale brenda vitit 2009; vendosjes së sistemit të lejeve me Kriteret e Parandalimit të Ndotjes së Integruar në vitin 2009;
 - Vendosjes së kodit të industrisë së ndërtimit në vitin 2008 dhe kërkesave për menaxhimin mjedisor për të gjitha kontratat e reja për punë publike në vitin 2010;
 - Zbatimit të sistemit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit në përmbushje të kërkesave ligjore të Komunitetit Europian brenda vitit 2014 sipas hapave ndërmjetës të mëposhtëm: monitorim mjedisor në përmbushje të kërkesave të KE-së në 6 qytete në vitin 2008; inventar kombëtar i çlirimeve në ajër në vitin 2008; monitorim në të gjitha qendrat urbane brenda vitit 2011; dhe monitorim i çlirimeve në përmbushje të kërkesave të KE-së në të gjitha impiantet e lejuara me burime të palëvizshme në vitin 2011.
- **Mbetjet e ngurta:** Menaxhimi i mbetjeve, ndalimi i hedhjes së mbeturinave në vende të palejuara dhe që nuk janë miratuar nga pushteti vendor brenda vitit 2008, arritja e heqjes së sigurtë të 75% të prodhimit të mbetjeve të rrezikshme brenda vitit 2009, dhe largimi i 50% të mbetjeve të ngurta të parrezikshme në vend-depozitime të kontrolluara (landfill) brenda vitit 2013, përmes:
 - Dokumenteve orientuese për autoritetet vendore në lidhje me planifikimin dhe vënien në punë të shërbimeve të mbledhjes e heqjes së mbetjeve, transportit dhe trajtimit të mbetjeve;
 - Hartimi i studimeve dhe projekteve prioritare për menaxhimin e mbetjeve për të siguruar ndërtimin e pesë vend-grumbullimeve rajonale brenda vitit 2009 dhe vend-depozitimeve të kontrolluara sanitare për heqjen e mbetjeve në nivel vendor në mbarë vendin brenda vitit 2013;
 - Krijimi i landfillit për mbetjet e rrezikshme brenda vitit 2009;

- **Mbetjet e lëngëta:** Sigurimi i një shkalle lidhjeje me kanalizimet e ujërave të zeza në qytet prej 75% në vitin 2010 dhe 85% në vitin 2014 dhe i trajtimit të përshtatshëm për të paktën 25% të gjithë ujërave të zeza të mbledhura në vitin 2010 dhe 50% në vitin 2014.
- **Ujërat sipërfaqësore:**
 - Pakësimi i ndotjes në pikën e burimit nga burimet jurbane, duke përfshirë njësitë ekonomike industriale dhe agro-përpunuese.
 - Pakësimi i ndotjes me burime të përhapura përmes futjes në përdorim dhe promovimit të praktikave të mira bujqësore dhe pyjore.
- **Mbrojtja e ujërave nëntokësore:** Zbatimi i zonave të mbrojtura të ujërave nëntokësore brenda vitit 2009;
- **Mbrojtja e tokave:** Rritja e nivelit të mbulimit me pyje në zonat e prekura më shumë me 5% në tërësi brenda vitit 2010, ndalimi i të gjitha nxjerrjeve të palicensuara të zhavorrit të lumenjve dhe vendosja e kufizimeve të rrepta mbi gërmimet e licensuara;
- **Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike:** Rritja e mëtejshme e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në masën 15% të territorit të vendit brenda vitit 2014 (për të siguruar përfaqësimin e të gjitha ekosistemeve dhe zbatimin e elementeve të Rrjetit Ekologjik Paneuropian e për të mbështetur objektivat e planeve të veprimit të llojeve); përgatitja e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura ekzistuese përparësore brenda vitit 2011;
- **Dëmtimi mjedisor:** Ndërmarrja e studimeve të plota të fizibilitetit, dosje projektesh për të gjitha zonat e nxehta dhe arritja e rregullimit të 35% të terrenit të kontaminuar më shumë brenda vitit 2010.

Zbatimi i MSA-së

Çështjet mjedisore përfshihen në Nenin 108.

Ekonomia e tregut

Përvoja në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore që u pranuan në Bashkimin Europian në vitin 2004⁷ tregoi, se instrumenti kyç i rritjes ekonomike është krijimi i institucioneve dhe kuadrit rregullator që sigurojnë një treg ekonomik funksional. Me qëllim që të përdoren aftësitë sipërmarrëse dhe të inkurajohet rritja ekonomike, është e nevojshme që firmave t'u ofrohen mundësi të barabarta për zhvillimin e sipërmarrjes dhe për të ulur shpenzimet e panevojshme të biznesit. Përveç kësaj, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të përkrahen me shërbime mbështetëse, si dhe duke u dhënë mundësi për të përdorur informacionin dhe teknologjitë e komunikimit.

Financat publike

Sfidat

Gjatë shtatë viteve në vijim financat publike do të synojnë arritjen e standardeve të Bashkimit Europian. Politika fiskale dhe administrimi i financave publike do të vazhdojnë të orientohen drejt vendosjes së parimeve dhe standardeve të legjislacionit europian dhe rritjes së kapaciteteve në Ministrinë e Financave për zbatimin e tyre.

Vizioni i sektorit

Vizioni i sektorit të financave publike do të jetë mobilizimi dhe përdorimi me efikasitet, frytshmëri, transparencë dhe integritet, i burimeve financiare të vendit, në përputhje me politikën dhe përparësitë e Programit të Qeverisë dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

⁷ Growth in the Central and Eastern European Countries of the European Union, IMF Occasional Paper 252, 2006

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike janë:

Përmirësimi i menaxhimit financiar publik sipas standardeve ndërkombëtare, i cili do të kryhet në fushat e mëposhtme:

- Përmirësimi i parashikimeve makroekonomike dhe fiskale;
- Programimi buxhetor afatmesëm dhe vjetor, do të mbështesë fuqimisht shpërndarjen e burimeve në fushat me përparësi kombëtare duke forcuar disiplinën fiskale, duke rritur efikasitetin dhe frytshmërinë e shpenzimeve publike, si edhe duke u bazuar në një kostim real të politikave;
- Përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit të investimeve publike, nëpërmjet rritjes së madhësisë mesatare të projekteve dhe pakësimit të numrit të tyre duke u mbështetur në procedurat e reja të menaxhimit të investimeve;
- Rritja e transparencës dhe objektivitetit në shpërndarjen e burimeve drejt njësive të pushtetit vendor, duke dhënë në kohë informacionin për shpërndarjen e fondeve buxhetore lokale, si edhe duke zbatuar të drejtat e huamarrjes lokale;
- Përmirësimi i kuadrit fiskal për qeverisjen vendore, në drejtim të rritjes së shkallës së autonomisë fiskale dhe kapaciteteve vendore për mbledhjen e të ardhurave dhe realizimin e financimeve;
- Përmirësimi i cilësisë së raportimit, transparenca në zbatimin e buxhetit dhe menaxhimi më i mirë i fondeve publike në sistemin e thesarit nëpërmjet zbatimit të sistemit të kompjuterizuar;
- Hartimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe krijimi i një sistemi auditimi dhe kontrolli të brendshëm financiar efektiv e të pavarur në të gjithë sektorin publik;
- Përmirësimi i luftës ndaj transaksioneve jo-ligjore duke u bazuar në: thellimin dhe zgjerimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet hartimit të politikave kombëtare parandaluese; përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar si edhe me homologët ndërkombëtarë; ndërtimin e një platforme të infrastrukturës të teknologjisë së informacionit dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore.

Zgjerimi i bazës tatimore dhe harmonizimi i politikave fiskale me përparësitë kombëtare. Politika tatimore do të ruajë një ekuilibër nëpërmjet sigurimit të të ardhurave për shpenzimet buxhetore, përmirësimin të klimës së investimeve private vendase dhe të huaja dhe ruajtjes së barazisë sociale. Shtylla kryesore e zhvillimit të këtij synimi do të jetë ruajtja e një niveli të ulët të taksave, shoqëruar paralelisht me uljen e evazionit fiskal, zgjerimin e bazës së taksueshme dhe shpërndarjen më të drejtë e pa deformime të barrës tatimore. Mekanizmat kryesorë për zbatimin e kësaj politike do të jenë:

- Zbatimi i taksës së sheshtë;
- Rishikimi i sistemit të taksave me fokus të veçantë: shkurtimi i listës së taksave të zbatueshme në Shqipëri, dhe transferimi i disa taksave kombëtare në taksa vendore;
- Njësimi gradual me standardet europiane i politikave për tatimet indirekte;
- Thjeshtimi i akteve tatimore ligjore dhe nënligjore, përmirësimet administrative me qëllim uljen e pengesave burokratike, shmangia e kontakteve taksapagues-inspektor tatimor, dhe orientimi drejt e-filing.

Rritja e performancës dhe besueshmërisë së administratave doganore e tatimore. Politikat në lidhje me këtë qëllim strategjik synojnë të modernizojnë dy administratat, të rrisin efikasitetin operativ të tyre, dhe të nxisin shlyerjen vullnetare të detyrimeve. Këto politika janë:

- Analiza e rrezikut të tatimpaguesve për identifikimin e burimeve kryesore të evazionit tatimor dhe uljen e tij; forcimi i kontrollit dhe monitorimit të regjistrimit, deklarimit dhe pagesës së detyrimeve dhe thjeshtimi i procedurave të deklarimit të pagesës; përmirësimi në mbledhjen dhe analizën e informacionit;
- Rritja e cilësisë së shërbimit për tatimpaguesit dhe e besueshmërisë ndaj tyre, duke përmirësuar në këtë mënyrë klimën e biznesit;

- Fuqizimi i performancës, i menaxhimit të kontrollit dhe i auditimit të brendshëm në administratat tatimore e doganore, përmes hetimeve të pavarura dhe procedurave ankimore;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në administratat tatimore dhe doganore;
- Informatizimi i plotë i dy administratave.

Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik. Aktiviteti i borxhit publik mbështet strategjinë, nëpërmjet zhvillimit të tregut financiar të brendshëm dhe hyrjes në tregun ndërkombëtar të kapitaleve. Përbërësit kryesorë të kësaj politike janë:

- Menaxhimi i rreziqeve të huamarrjes së brendshëm dhe të kostos së saj duke zgjatur periudhën e maturimit të huamarrjes së brendshme dhe peshën specifike të borxhit me maturim afatgjatë;
- Krijimi i një strukture më të mirë midis borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm, duke rritur peshën specifike të borxhit të jashtëm nëpërmjet hyrjes në tregun e Eurobonove;
- Krijimi i një sistemi të integruar për menaxhimin e borxhit dhe fuqizimi i kapacitetit profesional e teknologjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit për kryerjen e analizave të rrezikut dhe të qëndrueshmërisë.

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Financave është përgjegjëse për zbatimin e Titullit IV në lëvizjen e lirë të mallrave, Kapitullit II të Titullit V për ndërmarrjen, dhe Titullit IX për bashkëpunimin financiar. Gjithashtu, Ministria është përgjegjëse për Nenin 82 në pastrimin e parasë, Nenin 85 në bashkëpunimin kundër krimit të organizuar, Nenin 87 për bashkëpunimin në politikën ekonomike, Nenin 89 në shërbimet financiare, Nenin 90 në auditim dhe kontrollin financiar, dhe Nenin 97-98 në administrimin e taksave e doganave. Zotimet për sistemin e prokurimeve publike janë pasqyruar në Nenin 40 dhe 74.

Ekonomia

Sfidat

Sfidat kryesore me të cilat përballlet ky sektor janë të shumta dhe ndër to mund të përmendim: përmirësimi i klimës së biznesit, thjeshtimi dhe ulja e kostos së regjistrimit dhe licensimit të biznesit, ulja e informalitetit dhe siguri i konkurrencës së ndershme, edukimi dhe kualifikimi i burimeve njerëzore, përmes aplikimit të standarteve që nxisin të mësuarit, inovacionin dhe shpirtin krijues në biznes. Rritja e mundësive të ekonomisë shqiptare për t'u përshtatur në një logjikë internacionalizimi dhe integrimi në tregjet ndërkombëtare, kërkon diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, si dhe krijimin e produkteve me vlerë të shtuar më të lartë. Politikat e këtij sektori kërkojnë bashkërendim midis të gjitha institucioneve, si dhe renditjen sipas përparësive të masave konkrete, si një garanci për zbatimin me efikasitet të tyre.

Imazhi i Shqipërisë si një vend destinacioni për investime është ende i dobët, sipas klasifikimeve ndërkombëtare të cilave u është bërë një publicitet i madh, si Indeksi Botëror i Konkurrueshmërisë i Forumit Ekonomik Botëror apo Sondazhi i Bizneseve i Bankës Botërore. Shifrat e vitit 2006 tregojnë, megjithatë, se Shqipëria po ecën më mirë në krahasim me vendet fqinje në fusha të tilla, si mundësia e kreditimit, por më dobët në fusha të tilla, si zbatimi i kontratave.

Vizioni i sektorit

Vizioni është një rritje ekonomike e qëndrueshme, produktivitet dhe konkurrueshmëri më të lartë, nëpërmjet zhvillimit dinamik të sipërmarrjes, nxitjes së investimeve, shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përsa i përket përmirësimit të klimës së biznesit, qeveria është duke kryer një **reformë rregullatore** të udhëhequr nga 'Task Force', krijuar në tetor 2005 mbështetur në një platformë të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Plani i veprimit përcakton fushat kryesore: (1) zhvillimi dhe menaxhimi i reformës rregullatore; (2) përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues duke mënjanuar pengesat e panevojshme në fushat e regjistrimit, licensimit, doganave, taskave, tokës dhe ndërtimit, inspektimit dhe ankimit administrativ; (3) monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të reformës, duke përfshirë ngritjen e sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator. Kjo reformë do të sigurojë bazën për një

mjedis rregullator të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për të rritur konkurrueshmërinë e bizneseve.

Qendra Kombëtare e Regjistrimit, e cila u krijua në shtator 2007, është një agjenci e pavarur, misioni i së cilës është që të sigurojë në një kohë të shkurtër *regjistrimin e biznesit* nëpërmjet 'one-stop-shop' (një zyrë e vetme për kryerjen e të gjitha veprimeve) duke mbajtur një Regjistër Tregtar të unifikuar, si bazë të dhënash elektronike. Qendra Kombëtare e Regjistrimit do të realizojë regjistrimin e njëkohshëm të biznesit edhe në regjistrin fiskal, të punës dhe të sigurimeve shoqërore dhe do të jetë operacionale në 29 sportele për paraqitje kërkesë nëpër bashki. Në vitet e para të aktivitetit të kësaj qendre do të jetë përparësi fuqizimi i kapaciteteve si dhe konsolidimi i procesit të regjistrimit.

Reforma në sistemin e *licensimit* synon pakësimin e dokumentacionit dhe shkurtimin e kohës së nevojshme për plotësimin e tij, duke zbatuar parimet e OECD-së për cilësinë rregullatore. Ajo zbaton parime të reja, si: (1) kalimi nga parakontrolli tek paskontrolli dhe kontrolli i vazhdueshëm; (2) miratimi në heshtje në rastet kur institucionet përgjegjëse nuk përgjigjen në kohë dhe zbatimi i sanksioneve për këto institucione (përgjegjshmëria e administratës); (3) heqja e të gjitha kërkesave të tepërta për licensimin në një fushë të veçantë. Gjatë viteve të para të zbatimit të reformës do të jetë përparësi monitorimi i shkallës së zbatimit të të gjitha propozimeve për përmirësimin e sistemit të licensimit për të gjitha licensat e lëshuara nga institucionet qendrore.

Qeveria do të shpejtojë përpjekjet për t'u garantuar mjedis të lirë aktorëve në treg dhe për të mënjanuar praktikant antikonkurrese, në përputhje me nenet përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Edhe ndërmarrjet publike do t'i nënshtrohen të njëjtave rregulla. Do të fuqizohet Autoriteti i Konkurrencës, i cili do të botojë një raport të rregullt për gjendjen e konkurrencës. Përparësitë janë fuqizimi i strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore (Drejtorisë dhe Komisionit të Ndihmës Shtetërore) dhe sigurimi i transparencës në zbatimin e parimeve bazë të ndihmës shtetërore. Do të përgatitet harta rajonale e ndihmës shtetërore. Po kështu, Qeveria do të punojë në lidhje me zotimet për tregun e brendshëm, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, siç është lëvizja e lirë e mallrave (në veçanti, çështjet që lidhen me standardizimin dhe certifikimin, akreditimin e metrologjinë).

Në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, politikat e synuara ndjekin Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe Kartën Europiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Objektivat kryesore janë:

- Harmonizimi me strategjitë sektoriale që kanë një impakt në këtë sektor, zhvillimi i një kulture sipërmarrjeje përmes futjes së koncepteve të sipërmarrjes në programet mësimore në të gjitha nivelet arsimore (sidomos në shkollat profesionale) dhe zbatimi i kurseve të trajnimit për të rinjtë, të cilët kërkojnë të hapin një biznes
- Mbështetja për zhvillimin e biznesit përmes hapjes së 'sporteleve me një ndalesë' për regjistrimin, unifikimi i kriterëve të certifikimit dhe procedurave në nivel qendror e vendor, përgatitja e një kuadri të vlerësimit të ndikimit rregullator, dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të biznesit, duke përfshirë njohjen e firmave me sistemet e cilësisë dhe lehtësimi i transferimit të teknologjisë
- Përmirësimi i mbështetjes financiare përmes mbështetjes së institucioneve të mikrokredisë, fondit të garantimit të kredive, si dhe përdorimit të instrumenteve të tjera financiare, si 'factoring' (shitblerjes së borxheve me komisioner) dhe 'leasing' (qira financiare)
- Sigurimi i transparencës së vendimeve, veprimeve dhe masave të ndërmarra që ndikojnë në mjedisin e biznesit, sigurimi i konkurrencës së ndershme dhe mbështetja e integritetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun ndërkombëtar

Në lidhje me eksportet, qëllimi është ruajtja e ritmit të rritjes së eksportit të mallrave mbi 13-15% në vitet e para, rritja e kontributit të sektorit të eksporteve në rritjen e PBB-se duke arritur në 14% e PBB-së në vitin 2013, dhe përmirësimi i bilancit tregtar, përmes rritjes së eksporteve dhe zëvendësimit të importit nga prodhimi vendas, duke arritur në vitin 2013 raportet: 1 njësi eksport me 2 njësi import. Politika e nxitjes së eksporteve përfshin:

- Masa legislative, kryesisht për harmonizimin e ligjeve dhe rregullave në lidhje me financimin, prodhimin dhe shitjen e mallrave të prodhuara në Shqipëri, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë;
- Masa institucionale, të tilla si krijimi i fondit të konkurrueshmërisë, krijimi i fondit shtetëror të garantimit të kredive të eksportit, krijimi i një shërbimi publik për novacionet dhe transferimin e teknologjisë, konsolidimi dhe ndërtimi i institucioneve shtetërore dhe private për vlerësimin dhe certifikimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, të tilla si lëndët e para, kushtet e prodhimit, manipulimit deri në kushtet e ruajtjes dhe konsumit të tyre (metrologjisë-kalibrimit, standardet, konformitetit, akreditimit, analizave laboratorike e mikrobiologjike, kodifikimit);
- Masa të tjera, si krijimi i qendrave të grumbullimit (për përpunimin, standardizimin, ambalazhimin dhe shpërndarjen në treg) për mbështetje të aktivitetit agro-industrial, për të nxitur shoqatat e prodhuesve dhe për t'i shtuar vlerën prodhimit bujqësor dhe ndërtimi i qendrave të përpunimit të eksporteve;
- Promovimi i avantazheve konkurruese; rritja e kapacitetit të prodhimit të sektorëve eksportues, si dhe shtimi i gamës së sektorëve dhe artikujve të rinj për eksport, sidomos në drejtim të mineraleve të reja, artikujve bujqësorë dhe agro-përpunimit; nxitja e vendosjes së prodhimit me fason drejt zonave që kanë papunësi të lartë dhe mundësi zhvillimi të kufizuar;

Politika për tregtinë, në përgjithësi, do të vazhdojë të përcaktohet nga zbatimi i parimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe i angazhimeve të Marrëveshjes së Përkohshme. Në dhjetor 2006 Shqipëria, së bashku me vendet e rajonit, i zëvendësoi marrëveshjet dypalëshe me një marrëveshje të vetme të tregtisë së lirë përmes ndryshimeve e shtesave dhe një zgjatjeje të Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë në Europën Qendrore, e cila do të vërë në jetë një liberalizim të mëtejshëm të tregtisë.

Politika për nxitjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta është e lidhur me imazhin e përgjithshëm të Shqipërisë përpara investuesve të mundshëm, e cila ka të bëjë si me aktivitetet promociionale ashtu edhe me politikat për klimën e biznesit. Masat që do të ndërmerren për të nxitur investimet e huaja të drejtpërdrejta janë:

- Zbatimi i ligjit për koncesionet dhe i nismës "Shqipëria një euro", e parashikuar në këtë ligji, e cila përfshin një paketë asetesh dhe shërbimesh, që shteti u ofron investitorëve të huaj me një çmim simbolik; zhvillimi i projekteve të investimit në partnership me sektorin privat si dhe zbatimi i skemave koncesionare
- Përmirësimi i klimës së biznesit, infrastrukturës fizike, shërbimeve utilitare si dhe i kuadrit rregullator që ndikon direkt në uljen e kostos së investimit; vendosja e konkurrencës dhe eliminimi i informalitetit në ekonomi; garantimi i të drejtave pronësore dhe zgjidhja e konflikteve të trashëguara; liberalizimi i procedurave për hyrjen në treg
- Stimulimi i krijimit të parqeve dhe zonave industriale; krijimi i industrive të reja nga investimet e brendshme, të cilat do të kenë efekt tërheqës për kapitalin e huaj
- Zhvillimi i teknologjisë së informacionit në qendrat urbane dhe më pas në zonat lokale e rurale dhe shpërndarja e shërbimeve të telekomunikacionit dhe internetit në thellësi të rajoneve më pak të zhvilluara
- Përsheptimi i procesit të privatizimeve, sidomos në sektorët strategjikë, si sektori elektroenergjetik, sektori i naftë-gazit dhe sektori i transportit
- Nxitja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në sektorë të veçantë si industria e këpucëve dhe veshjeve, biznesi i shërbimeve dhe i materialeve të ndërtimit

Politikat në fushën e zhvillimit industrial janë: investime në teknologji; rritja e konkurrueshmërisë, modernizimi, diversifikimi dhe specializimi në tregjet e hapura; siguri i informacionit të nevojshëm për shfrytëzimin e burimeve të lëndëve të para dhe zhvillimit industrial; zhvillimi i shërbimit të informacionit dhe i nxitjeve për sektorët industrialë (Fondi i Garancisë, krijimi i një fondi zhvillimi për teknologjitë e avancuara) dhe përgatitja e programeve të ristrukturimit, ashtu siç kërkohet nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Objektivat për industrinë minerare janë: vlerësimi i potencialit mineral-mbajtës të vendit; futja në qarkullim me efektivitet ekonomik i grup-mineraleve tradicionale e të reja, dhe promovimi i tyre; rritja e gamës së mineraleve në qarkullim dhe shfrytëzimi i plotë e racional i tyre.

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar zbatimin e neneve të Titullit IV, për lëvizjen e lirë të mallrave. Në vijim, kjo ministri është përgjegjëse edhe për sigurimin e zbatimit të neneve të mëposhtme: Nenet 49-51 për ndërmarrjet, Neni 56 për industri të caktuara, Nenet 57-58 për ofrimin e shërbimeve, Nenet 71-72 për konkurrencën (së bashku me Autoritetin e Konkurrencës), Neni 73 për pronësinë industriale dhe tregtare, Neni 75 për përputhshmërinë me rregulloret teknike, Neni 87 për bashkëpunimin në politikat ekonomike e tregtare dhe Nenet 91-93 për promovimin e investimeve, zhvillimin industrial dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme. Gjithashtu, kjo ministri ka një rol të ndjeshëm në zbatimin e klauzolave të Marrëveshjes së Përkohshme, si dhe të protokolleve si pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje, përfshirë edhe protokollin 1 për hekurin dhe çelikun.

Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbikëqyrja e tregut

Sfidat

Ndonëse zhvillimet e viteve të fundit kanë sjellë ndryshime pozitive në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, veçanërisht në lidhje me legjislacionin, mbetet për të bërë më shumë në të ardhmen. Ka nevojë për rregulla mbrojtëse shtesë, veçanërisht në fushën e sigurisë së produktit. Duhet të fuqizohen informimi i konsumatorëve dhe edukimi i tyre. Nevojitet të rritet përfaqësimi i interesave të konsumatorëve në shoqërinë civile. Çështjes së zbatimit të legjislacionit në mbrojtje të konsumatorit duhet t'i jepet përparësi e veçantë; duhet të zhvillohen më tej mekanizmat efektivë të dëshmipërlimit dhe kërkohet të ngrihet një sistem i përshtatshëm i mbikëqyrjes së tregut.

Vizioni

Në përputhje me strategjinë e Bashkimit Europian për politikën e konsumatorëve, vizioni është sigurimi i nivelit të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve, kontroll efektiv i përmbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe përfshirja e organizatave të konsumatorëve në procesin e politikëbërjes.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Reformat në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut janë ndër kërkesat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Qeveria do të forcojë bashkërendimin ndërmjet institucioneve qendrore, strukturave të kontrollit të tregut, si dhe shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve e atyre të biznesit. Në veçanti, përparësitë strategjike janë si më poshtë:

- **Të fuqizohen konsumatorët për një zgjedhje reale**, të bazuar mbi informacion të saktë, për vetëvendosje dhe besim që rrjedh nga mbrojtja efektive. Kjo nënkupton zhvillimin e një sistemi informacioni dhe këshillimi për konsumatorët në:
 - nxitjen e edukimit të konsumatorëve në sistemin arsimor, duke përfshirë konceptet e mbrojtjes së konsumatorëve në programet mësimore, trajnimin e mësuesve, bashkëveprimin e shkollave me bashkësitë vendore dhe shoqatat e konsumatorit;
 - trajtimin e ankesave të konsumatorëve në mënyrë më të lirë dhe të shpejtë, përpara se çështjet të kalojnë në gjykatë, me qëllim rritjen e besimit të konsumatorëve;
 - rritjen e ndërgjegjësimin të konsumatorëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe informimin e operatorëve ekonomikë për përgjegjësitë e tyre në treg dhe përkundrejt konsumatorëve.
- **Të mbrohen interesat ekonomikë të konsumatorëve** në çështjet e çmimit, zgjedhjes, cilësisë, llojshmërisë, disponibilitetit dhe sigurisë, nëpërmjet:
 - sigurimit dhe inkurajimit të pjesëmarrjes së organizatave jo-fitimprurëse në procesin e hartimit të politikave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe zbatimin e tyre;
 - ngritjes së një rrjeti kombëtar të këshillimit të konsumatorit, me përfshirjen e shoqatave të konsumatorit, apo aktorëve të tjerë qendrorë dhe vendorë.

- Të ofrohet për konsumatorët mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparencë e tregut, duke vendosur themelet për zhvillimin e tregjeve të sigurta përmes:
 - konsolidimit të bazës legislative nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të ligjeve të reja për mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve, për ushqimin e farmaceutikën; si dhe të akteve nënligjore për produktet në sektorë të veçantë në përputhje me *acquis communautaire*;
 - vendosjes së një sistemi institucional të përshtatshëm e funksional për mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke përfshirë ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, Këshillit Konsultativ për konsumatorët dhe fuqizimin e kapaciteteve të strukturave ekzistuese.
- Të mbrohen konsumatorët në mënyrë efektive nga rreziqet dhe kërcënimet, të cilat ata nuk mund t'i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale. Në veçanti kjo do të përfshijë:
 - ngritjen e mekanizmave për gjurmimin e hershëm të rreziqeve, që nënkupton mbledhjen e të dhënave për produktet e pasigurta që qarkullojnë në treg, duke garantuar edhe një lidhje të ardhshme me sistemet europiane të shkëmbimit të informacionit, siç është Sistemi i Shkëmbimit të Shpejtë të Informacioneve për Produktet Joushqimore (RAPEX) dhe për Ushqimin e Blegtorinë (RASFF);
 - forcimin institucional të inspektorateve shtetërore, ngritjen e Autoritetit të Ushqimit, ngritjen e strukturës së farmakovigjilencës.

Zbatimi i MSA-së

Neni 76 mbulon fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Sfidat

Sektori i telekomunikacioneve është karakterizuar nga zgjerimi i vullshëm i telefonisë celulare. Reformat në fushën e telefonisë fikse, të cilat kishin mbetur në vend, pritet që të zbatohen tani pas privatizimit të Albtelekomit. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim deklaron në strategjinë e saj për Shqipërinë në prill 2006, se "ka një mungesë të theksuar të mekanizmave të përshtatshëm për interkoneksionin dhe tarifikimin" dhe se kapaciteti i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve "kufizohet nga mungesa e akteve të nevojshme nënligjore". Sipas Komisionit European, kuadri rregullator nuk është ende në harmoni me *acquis communautaire*.

Mbështetur në statistika të ndryshme, si p.sh. për mundësinë e lidhjes me komunikimin me zë dhe mundësinë e lidhjes me shërbimet e internetit me shpejtësi të lartë ose me bandë të gjerë, Forumi Ekonomik Botëror ka nxjerrë Indeksin e Gatishmërisë për Rrjet si pjesë të Raportit të vet vjetor për Teknologjinë e Informacionit. Ndër 115 vende të krahasuara, Shqipëria renditej në vendin 106 në vitin 2006. Ekziston nevoja për t'i përqendruar shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për qeverinë dhe për të vazhduar me ngritjen e një rrjeti të përbashkët të shpejtësisë së lartë.

Bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë dhe donatorëve të ndryshëm ka bërë të mundur zbatimin e një rrjeti kompjuterik ndërministror, si dhe përgatitjen e një vargu sistemesh kompjuterike, ku mund të veçohen 'e-procurement' (prokurimi elektronik), 'e-taxes' (taksat elektronike), dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Sidoqoftë, mbeten shumë shërbime të cilat duhen modernizuar me synim ofrimin e tyre 'online' për të rritur transparencën dhe forcuar luftën kundër korrupsionit.

Vizioni

Vizioni është një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë e strategjisë në sektorin e telekomunikacioneve, që mbulohe nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT) janë:

- Miratimi dhe zbatimi i **ligjit të komunikimeve elektronike** në përputhje me *acquis communautaire*;
- **Hartimi i kuadrit rregullator**, në zbatim të ligjit të komunikimeve elektronike nga ERT;
- **Forcimi i kapaciteteve dhe rolit të Drejtorisë së Politikave të Postë Telekomunikacionit** në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve;
- **Nxitja e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve** për shërbime të reja. Meqenëse teknologjitë po shkojnë drejt një konvergjence të plotë, duhet të ofrohen shërbime me vlerë të shtuar, siç mund të jetë IP-TV apo DVBS.

Përparësitë e strategjisë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, që do të bashkërendohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, janë:

- **Përshtatja e kornizës ligjore** në përputhje me *acquis communautaire* përsa u përket 'e-signature' (firma dixhitale), 'e-commerce' (tregtia elektronike), dokumenteve elektronike, krimi kibernetik dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Këto ligje duhen shoqëruar me organe shtetërore mbikëqyrëse;
- Bashkërendimi i të gjitha nismave me qëllim maksimizimin e përfitimeve, standardizimin, si dhe ofrimin e shërbimeve 'online' qytetarëve në një hapësirë informacioni të integruar. Këto shërbime përfshijnë: kartat e identitetit, pasaporta elektronike, regjistrimi i automjeteve, aplikime për përfitimet nga sigurimet shëndetësore, regjistrimi i të papunëve, pagesat për sigurimet shoqërore, evidentimi i pronësisë, kërkesa për leje ndërtimi, deklarimi doganor, transparenca e vendimeve gjyqësore, të gjitha këto duke përdorur firmën digjitale;
- Shfrytëzimi i rrjetit kompjuterik ndërministror për ofrimin e një vargu shërbimesh jo vetëm për qeverinë, por edhe për qytetarët;
- Shfrytëzimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në sistemin arsimor nëpërmjet investimeve dhe kontraktimit të shoqërive private, si dhe me vënien në punë të sistemit të menaxhimit të informacioneve arsimore; do të arrihet përdorimi i kompjuterëve dhe internetit në çdo shkollë, trajnimi i mësuesve për teknikat e mësimdhënies duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe modernizimi i kurrikulave;
- Integrimi i teknologjisë së informacionit dhe i komunikimit në fushën e kulturës, nëpërmjet bibliotekave e muzeve virtuale dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore;
- Zbatimi i rekomandimeve të miratuara të iniciativave eSEE dhe bSEE të Paktit të Stabilitetit;
- Adaptimi i metodologjisë së EUROSTAT për statistikat, si dhe përgatitja e vjetorëve mbi treguesit e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Zbatimi i MSA-së

Neni 103 i referohet shoqërisë së informacionit dhe ndërveprueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve, ndërsa Neni 104 u referohet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

Politika sociale

Rritja e nivelit të punësimit është një nga kushtet kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së investimeve, por gjithashtu edhe përmes investimeve në kapitalin njerëzor. Strategjia ndan të njëjtin qëllim me atë të Axfordës

së Lisbonës për të tërhequr në tregun e punës dhe për të mbajtur të punësuar sa më shumë njerëz, si një instrument jetësor “që mbështet rritjen ekonomike, kohezionin social, si dhe lufton varfërinë”⁸. Në këtë aspekt parashikohet:

- një shërbim punësimi që u përgjigjet ndryshimeve të shpejta ekonomike e shoqërore dhe nevojës për ta kthyer punësimin informal në punësim të rregullt;
- një sistem i mbrojtjes sociale që identifikon më mirë personat në nevojë, si dhe një sistem pensionesh që ka ndikim sa më të vogël në buxhet, mbron sigurinë financiare të të moshuarve dhe inkurajon individët që të marrin pjesë në sistemin kontributiv;
- nxitje për të rritur pjesëmarrjen e gruas në tregun e punës, si dhe në të gjitha aspektet e jetës publike;
- një sistem shëndetësor që u përgjigjet vështirësive të reja të krijuara nga ndryshimi i shpejtë i strukturës demografike, që kujdeset për shëndetin e popullatës, si dhe mënjanton pabarazinë në shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore;
- një sistem arsimimi dhe trajnimi që u përgjigjet sfidave dhe siguron përfshirjen e të gjithë fëmijëve në të.

Punësimi

Sfidat

Sfidat që kanë dalë nga tranzicioni janë përftuar prej reagimit të menjëhershëm ndaj humbjes së forcës punëtore dhe rënies së punësimit të grave gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik dhe diversifikimi do të krijojnë vende pune të reja, qeveria duhet të sigurojë se fuqia punëtore shqiptare i ka aftësitë dhe njohuritë e duhura për t'i përdorur këto vende pune. Prandaj, sfida më e madhe e qeverisë është të luajë një rol ndërmjetësues midis tregut të punës dhe fuqisë punëtore. Kjo do të bëjë të nevojshme sigurimin e trajnimit dhe edukimit të duhur profesional. Një sfidë tjetër për qeverinë është të ndihmojë rolin e ndërmjetësit, duke krijuar mundësi të reja punësimi, si dhe programeve të specializuara punësimi për grupet e pambrojtura e në vështirësi, sidomos të rinjtë e moshës 18-25 vjeç, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe romët. Sfidat e paraqitura nga numri i madh i punonjësve joformalë kërkojnë kthimin e tyre në sektorin formal, duke ruajtur dinamizmin që karakterizon tregun joformal të punës.

Vizioni i sektorit

Vizioni i strategjisë së punësimit dhe formimit profesional, e cila bazohet në axhendën e Lisbonës, është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj të papunëve dhe atyre punëdhënës nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve të punësimit, zbatimit sa më efikas të programeve aktive e pasive dhe arritjes së niveleve të pranueshme për një integrim sa më të shpejtë rajonal e europian.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Krijimi i vendeve të punës është rezultat i një ndërveprimi të ndërlikuar të kushteve makroekonomike, klimës së biznesit, arsimit dhe politikës sociale. Roli i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është të lehtësojë funksionimin e tregut të punës nëpërmjet përmirësimeve në shërbimin e punësimit dhe vazhdimin e programeve të mbështetjes aktive e pasive të punësimit kryesisht në drejtim të mundësive për formim profesional e punësim.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit u ofron shërbime të regjistrimit personave që kërkojnë punë; ndërmjetësim për vendin e punës; orientim dhe këshillim për personat që kërkojnë punë; përgatitjen e dokumentacionit për marrjen e pagesës së papunësisë; orientim dhe regjistrim në kurse të formimit profesional; informacion për tregun e punës; dhe zbaton programe të nxitjes së punësimit. Gjithashtu ofrohen shërbime për imigrantët dhe emigrantët. Drejtimit kryesorë të politikës për të përmirësuar shërbimin publik të punësimit, që përfshihen edhe me rekomandimet e Rishikimit të Politikës së Punësimit të përgatitura nga Zyra Ndërkombëtare e Punës dhe Këshilli i Europës, janë:

⁸ Communication from the Commission, Cohesion Policy in Support of Growth and Jobs: Community Strategic Guidelines 2007-2013, COM(2005) 0299

- Konsolidimi i shërbimit të punësimit në mbarë vendin nëpërmjet përmirësimit dhe unifikimit të metodave të punës, duke përfshirë rritjen e nivelit të aftësive të personelit të zyrave rajonale të punësimit; shqyrtimit të kapaciteteve dhe shpërndarjes së zyrave të punësimit; rritjes së përqindjes së specialistëve të cilët merren me klientët; dhe monitorimit të vlerësimit të shërbimeve;
- Përmirësimi i kontakteve me ndërmarrjet, zhvillimi i partneriteteve dhe përmirësimi i situatës së agjencive private të punësimit në tregun e punës me adaptimin e një kodi etike dhe shkëmbimit të eksperiencave;
- Përdorimi i teknologjisë informatike për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

Ministria do të përmirësojë **programet e mëposhtme aktive dhe pasive të punësimit:**

- *Progamet e nxitjes së punësimit* do të vazhdojnë dhe do të fuqizohen përmes rritjes së mbikëqyrjes për të vënë nën kontroll abuzimet dhe përmes futjes së vlerësimit të programeve;
- Do të vazhdojnë *programet e mbështetjes* për grupet e pambrojtura, sidomos për personat me aftësi të kufizuara, gratë në nevojë dhe romët, kryesisht në drejtim të mundësive për formim profesional;
- Inspektorati Shtetëror i Punës do të përgatisë legjislacionin për *shëndetin dhe sigurinë në punë*, në përputhje me politikën e Bashkimit Europian për të përcaktuar përgjegjësitë përkatëse të punëdhënësve dhe punëmarrësve;
- Masat për të ulur *informalitetin në tregun e punës* do të përfshijnë bashkëpunimin midis Inspektoratit Shtetëror të Punës, administratës së tatim-taksave, doganës, policisë dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit; si dhe zgjerimin e kontrollit përtej zonave urbane;
- Do të fuqizohet *dialogu social*, i drejtuar nga Këshilli Kombëtar i Punës, përmes plotësimit të kuadrit ligjor për të pasqyruar konventat ndërkombëtare dhe përmirësimeve në funksionimin e këshillave konsultativë në nivel rajonal.

Po ashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, do të përmirësohet sistemi i arsimit dhe formimit profesional në drejtimet e mëposhtme:

- *rritja e lëvizshmërisë* përmes ngritjes së një kuadri kombëtar për kualifikimet profesionale dhe ristrukturimit të niveleve të arsimit dhe formimit profesional;
- *modernizimi i kurrikulave* për të plotësuar nevojat e tregut përmes një strukture programesh mësimore me dy nivele (e përcaktuar pjesërisht në qendër dhe që pasqyron pjesërisht kushtet e tregut rajonal dhe të qendrave formuese rajonale) dhe modularizimin hap pas hapi të programeve mësimore;
- *zhvillimi institucional*: fuqizimi i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional si një organ këshillimor tripalësh (me përfaqësim nga qeveria, firmat dhe punonjësit), ngritja e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, fuqizimi i bordeve të shkollave dhe i lidhjeve të tyre me partnerët socialë dhe krijimi i një mekanizmi kombëtar për këshillimin në lidhje me profesionin;
- zhvillimi i kompetencave të instruktorëve;
- *plotësimi i kuadrit ligjor në mbështetje të reformave* në fushat e kuadrit kombëtar për kualifikimet profesionale, ofrimin e arsimit e formimit profesional jopublik dhe angazhimin e shkollave në veprimtari ekonomike;
- *përmirësimi i cilësisë së objekteve dhe ofrim i zgjeruar i materialeve didaktike*: duke vendosur theksin te mundësia për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara, bashkëpunimi me bizneset lokale për ta përdorur infrastrukturën me frytshmëri dhe lidhjet e komunikimit me qendrat e punësimit.

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për zbatimin e Nenit 46-47 për lëvizjen e punonjësve, Nenit 55 në Kapitullin për ndërmarrjen, Nenit 77 për

legjisacionin në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, Nenit 99 për bashkëpunimin në politikat e punësimit, dhe Nenit 100 për rritjen e nivelit të trajnimit dhe arsimit profesional.

Rinia

Sfidat

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja rinore janë shumë të rëndësishme, por mungesa e pjesëmarrjes së të rinjve ka ndikuar në mospërfshirjen e tyre në jetën publike. Të rinjtë janë të aftë për t'u përshtatur dhe integruar në tregun e punës, por migrimi i brendshëm dhe mungesa e politikave të përshtatshme të nxitjes së punësimit kanë krijuar një situatë jo të favorshme. Të rinjtë në Shqipëri përballen me të njëjtat sfida si në vende të tjera në drejtim të çështjeve të shëndetit dhe kujdesit parësor. Megjithatë njohuritë e pakta kanë pasoja në nivelin e mbrojtjes kundrejt drogës, alkoolit, duhanit dhe HIV/AIDS. Ka shumë për të bërë në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve të tjera, si dhe të shkëmbimeve kulturore.

Vizioni

Krijimi i një mjedisi favorizues për angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve shqiptarë, duke u dhënë atyre përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zhvillimet e sotme në vend.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Qëllimi është optimalizimi i burimeve në dispozicion të të rinjve nëpërmjet bashkërendimit të punës së institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si edhe arritja e bashkëfuqizimit nëpërmjet bashkëpunimit shumëpalësh mes qeverisë, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe komunitetit të biznesit. Përparësitë strategjike janë si më poshtë:

- **Bashkërendimi ndërsektorial dhe angazhimi i përbashkët**, duke përfshirë krijimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë si strukturë eksperte për zbatimin e programeve rinore
- **Përfaqësimi dhe pjesëmarrja rinore**, në veçanti nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën publike të vendit, zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore, mbështetja për pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare rinore në aktivitete rajonale e ndërkombëtare dhe përfshirja e të rinjve në votime
- **Fuqizimi ekonomik i të rinjve**, nëpërmjet nxitjes së punësimit të të rinjve dhe zhvillimit të trajnimeve për aftësimin e mëtejshëm të tyre, shfrytëzimit të energjisë intelektuale të të rinjve shqiptarë që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, krijimit të mundësive për të rinjtë që duan të hapin një biznes dhe edukimit të të rinjve si konsumatorë të përgjegjshëm
- **Shëndeti dhe mbrojtja sociale**, duke nxitur të rinjtë për një jetë të shëndetshme përmes përfshirjes në veprimtari njohëse dhe edukuese për parandalimin e fenomeneve negative, si dhe sjelljeve me rrezik social;
- **Nxitja e parimeve europiane**, duke përgatitur të rinjtë përmes edukimit dhe programeve të shkëmbimit rinor, për qytetarinë demokratike, të drejtat e njeriut dhe kulturën e praktikës së vullnetarizmit.

Sportet

Sfidat

Disa nga sfidat në fushën e sporteve janë: niveli i ulët i koordinimit në qendër e bazë dhe me institucionet jo shtetërore; mungesa e strukturës institucionale të sportit për të gjithë; mungesa e transparencës; cilësia e dobët e menaxhimit të fondeve publike; mungesa e infrastrukturës; mungesa e kualifikimit; mungesa e këshillimit shkencor, si dhe pakësimi i të ardhurave nga llotaritë sportive për Fondin Kombëtar të Zhvillimit të Sporteve.

Vizioni i sektorit

Duke ditur që sporti është një aktivitet shoqëror dhe kulturor, i bazuar në zgjedhjen vullnetare që inkurajon kontaktet ndërmjet njerëzve të shtresave të ndryshme dhe element thelbësor i kohezionit

social, vizioni për sportet do të ndërtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse duke nxitur pjesëmarrjen, duke rritur performancën sportive dhe duke përmirësuar infrastrukturën sportive.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike në fushën e sporteve janë si më poshtë:

- Përmirësimi i sistemit të funksionimit dhe bashkërendimit të sportit nëpërmjet: riorganizimit të sportit me një strukturë institucionale me përfaqësim kombëtar; ngritjes së komisioneve ndërinsticionale; ngritjes së strukturave në pushtetet vendore që t'u përgjigjen zhvillimeve të kohës për sportin cilësor dhe sportin për të gjithë; si dhe ngritjes së institucionit koordinues të sportit jo-shtetëror (konfederata e sportit, federata e sportit për të gjithë, federata e sportit shkollor dhe universitar)
- Përsosja e funksionimit të organizatave sportive kombëtare e lokale, federatave dhe klubeve sportive nëpërmjet: hartimit të statuteve mbështetur në parimet bazë të demokracisë në përputhje me Kartën Europiane dhe dokumentet ligjore të organizatave sportive ndërkombëtare; ngritjes së sektorit të transparencës, statistikës dhe informacionit; shoqatizimit dhe shoqërizimit të klubeve sportive
- Mbështetja cilësore e sportit dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive nëpërmjet ngritjes së Qendrës Kombëtare të Përgatitjes dhe Shërbimeve të Ekipeve Kombëtare e Olimpikë pranë klubit sportiv 'Dinamo'; ngritjes së Qendrës Sportive Universitare pranë klubit sportiv 'Studenti'; rikonstruksionit të objekteve sportive dhe ndërtimeve të mjediseve të reja; ngritjes së 5 qendrave stërvitore nga viti 2008-2013 (Shkodër, Korçë, Vlorë, Durrës dhe Elbasan); si dhe përmirësimit të ligjit për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet për rritjen e kontributit të llotarive sportive në Fondin Kombëtar të Zhvillimit të Sporteve
- Rritja e autonomisë financiare të organizatave sportive kombëtare dhe stimulimi i përfshirjes së biznesit në sport, nëpërmjet përmirësimit të ligjit të sponsorizimit

Barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës në familje

Sfidat

Transformimi i thellë social dhe ekonomik solli ndryshime të dukshme në strukturën e ekonomisë dhe prishjen e ekuilibrit gjinor në shoqëri. Megjithëse gjatë tranzicionit Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm pozitivë drejt ndërtimit të një shoqërie demokratike, liritë e të drejtat që u fituan nuk kanë ndikuar në mënyrë të barabartë tek gratë/vajzat dhe burrat/djemtë. Kushtetuta e sanksionon barazinë ndërmjet burrave e grave, por në praktikë ata nuk gëzojnë të njëjtat të drejta. Pabarazitë në respektimin e të drejtave të grave/vajzave thellohen edhe nga niveli i ulët i përfaqësimit të tyre në procesin e vendimmarrjes, si edhe nga vëmendja e pamjaftueshme e shoqërisë për edukimin mbi çështje, norma dhe vlera që lidhen me pabarazinë gjinore si brenda familjes, ashtu edhe në jetën shoqërore. Tradicionalisht gratë mbajnë barrën kryesore në familje edhe pse ato kanë më pak mundësi se burrat të përdorin burimet dhe mjetet që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë e mësipërme. Pjesëmarrja e grave/vajzave në tregun e punës ka rënë ndjeshëm gjatë viteve të tranzicionit si pasojë e problemeve të shumta që ato hasin për të hyrë në këtë treg.

Gjithashtu, Kushtetuta sanksionon mbrojtjen e të drejtave e lirive të individit dhe ndalimin e diskriminimit, por në praktikë studime të ndryshme tregojnë se dhuna në familje është gjerësisht e pranishme në shoqërinë shqiptare dhe në shumicën e rasteve gratë janë viktima. Dukuria e dhunës në familje amplifikohet edhe nga qëndrimi i përgjithshëm i shoqërisë ndaj saj, si një çështje private, që tërheq pak ose aspak vëmendjen e shoqërisë për parandalim. Shkallëzimi i dhunës brenda familjes çon deri në marrjen e jetës së njerëzve të afërt, apo deri në vetëvrasje dhe prek fëmijët, gratë e të moshuarit.

Vizioni

Vizioni është barazia gjinore nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave/vajzave dhe e burrave/djemve në jetën shoqërore, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për shërbime publike, duke siguruar rezultate të barabarta për të dyja gjinitë, në mënyrë që të gëzojnë të gjithë të drejtat e tyre dhe t'i vënë në shërbim të shoqërisë potencialet individuale. Vizioni

përbëhet gjithashtu nga trajtimi i viktimave të prekura nga dhuna në familje, dhënia e informacionit për mbrojtjen e tyre nëpërmjet legjislacionit penal e civil, këshillimi shëndetësor dhe mbështetja sociale, parandalimi dhe trajtimi i shenjave të hershme të dhunës, si dhe vënia përpara ligjit e dhunuesve.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike janë si më poshtë:

- **Përmirësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe institucional**, i cili garanton barazinë gjinore përmes ndryshimeve dhe shtesave në legjislacionin për barazinë gjinore e sigurimet shoqërore, krijimi i një baze të dhënash për dhunën në familje, si dhe krijimi i një institucioni ankimi në rolin e komisionerit për rastet e diskriminimit gjinor; ngritja e strukturave të reja ndërmministrorë, që do të sigurojnë ndërveprimin e kësaj strategjie me strategji të tjera, sidomos në strategjinë e punësimit, të sigurimeve shoqërore, të shëndetësisë dhe të arsimit;
- **Rritja e përfaqësimit të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse** përmes ndryshimeve në ligjin zgjedhor, si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për pjesëmarrjen aktive të grave në strukturat politike dhe ekzekutive;
- **Fuqizimi ekonomik i grave** përmes rritjes së numrit të tyre si sipërmarrëse, duke u dhënë më shumë mundësi për të pasur pronë, kapital dhe kreditime, sidomos për ato të zonave rurale, dhe përmes programeve të posaçme të nxitjes së punësimit të grave;
- **Mënjanimi i dallimeve gjinore në arsim** nëpërmjet promovimit të mundësive të barabarta të grave dhe vajzave për marrjen e arsimit cilësor dhe me anë të përmirësimit të programeve mësimore dhe teksteve shkollore që promovojnë barazinë gjinore;
- **Mbështetja për gratë dhe vajzat e pambrojtura** përmes fuqizimit të strukturave publike, të cilat trajtojnë viktimat e dhunës dhe të trafikimit, sidomos në fshat, dhe të programeve të cilat synojnë t'i integrojnë këto viktimat;
- **Përmirësimi i reagimit të sistemit shëndetësor dhe rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë** në lidhje me nevojat shëndetësore të grave/vajzave dhe burrave/djemve; nxitja e masave të cilat u japin zgjidhje rreziqeve shëndetësore në një fazë të hershme;
- **Parandalimi i dhunës në familje** nëpërmjet: edukimit të fëmijëve, të rinjve dhe publikut të gjerë, për të krijuar marrëdhënie familjare të shëndetshme dhe për ta konsideruar dhunën në familje si krim dhe si të papranueshme; përmirësimit të programeve të lëndëve mësimore, të teksteve shkollore dhe teksteve jashtëshkollore; trajnimit të profesionistëve të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe të arsimit për të identifikuar viktimat e abuzimit sa më herët dhe për të ofruar mbështetje;
- **Mbrojtja dhe drejtësia për viktimat** nëpërmjet: sigurimit të gjithë atyre që preken nga dhuna në familje; përfshirjes së viktimave në procedurat e mbrojtjes së dëshmitarit; zbatimit të dënimeve e sanksioneve që i përgjigjen dhunës në familje; ndërgjegjësimit për ligjin e dhunës në familje; mbrojtjes maksimale për të gjithë viktimat në mënyrë që të mos përsëriten rastet e dhunës në familje; trajnimit të punonjësve të gjyqësorit dhe të policisë mbi dhunën në familje dhe vendosja e masave të veçanta për viktimat;
- **Mbështetja sociale për viktimat** nëpërmjet: krijimit të strehëzave; ofrimit të shërbimeve sociale për viktimat e dhunës dhe dhunuesit; ofrimit të shërbimeve speciale shëndetësore në nivel lokal, si dhe mundësive të tjera për të rindërtuar jetën e tyre; vendosjes së një linje 24-orëshe pranë njësive të pushtetit vendor për viktimat që të raportojnë dhe të marrin mbështetjen e duhur dhe të shpejtë; si dhe krijimit të një sistemi koordinimi për të ngulitur një rutinë të mirë midis institucioneve dhe organizatave që punojnë kundër dhunës në familje

Zbatimi i MSA-së

Barazia gjinore trajtohet në Nenet 77 dhe 99 mbi mundësitë e barabarta në punë dhe në legjislacionin përkatës.

Mbrojtja sociale

Sfidat

Shpërndarja e fondeve për programin kryesor të asistencës sociale, ndihma ekonomike, ka rënë nga 0.8% në 0.4% të PBB-së gjatë periudhës 2000-2005. Pagesat e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë ndjekin një procedurë që kalon në dy faza. Së pari, pushteti qendror jep grantet në bllok për bashkitë dhe komunat. Një hartë e varfërisë e mbështetur në të dhënat e zbërthyer të REPOBA 2001 dhe LSMS 2002 dëshmon se një numër i madh i njësive vendore kanë marrë grante në përpjesëtim të zhdrejtë me nivelin e vlerësuar të varfërisë. Së dyti, njësitë vendore shpërndajnë ndihmë ekonomike për familjet që e meritojnë sipas një grupi të ndërlikuar kriteresh, të cilat shpesh duket sikur janë hartuar për t'i përjashtuar kërkuesit dhe jo për të vlerësuar nevojat e tyre. Megjithatë, mungesa e përgjithshme e efikasitetit në lidhje me shpërndarjen nuk është shumë më e madhe se në vende të tjera të krahasueshme. Problemi kryesor i programit është se mbulimi dhe nivelet e pagesave janë të ulëta, çka ka bërë që efekti i tij në uljen e varfërisë të jetë shumë i vogël. Pagesa mesatare është e barabartë me më pak se 15% të kufirit të varfërisë; për rrjedhojë, përfituesve u duhet të gjejnë burime të tjera shtesë për mbështetje.

Po ndihmohen grupe të tjera të pambrojtura në kuadër të sistemit të kujdesit social, i cili ofron shërbime rezidenciale dhe ditore. Këto institucione u shërbejnë jetimëve, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të trafikimit dhe personave me probleme sociale, përfshirë këtu problemet psikiatrike dhe përdorimin e lëndëve narkotike. Qeveria ka nisur një reformë, e cila synon zhvillimin e shërbimeve në nivel komuniteti, për t'iu gjendur më pranë përfituesve dhe familjeve të tyre. Kjo bëhet që të ndihmohen këta persona që jetojnë vetëm, të mbajnë veten dhe të kenë të njëjtat të drejta sikurse edhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Kjo reformë përputhet plotësisht me procesin e decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësive për t'ia kaluar ato pushtetit vendor. Megjithatë, mungon një strategji financimi për të mundësuar kalimin gradual të pronësisë së institucioneve të autoritetit e pushtetit vendor.

Vizioni i sektorit

Shqipëria do të ketë vendosur në vitin 2013 një sistem të tillë, i cili të sigurojë mbrojtjen e duhur sociale për qytetarët e saj. Politikat e mbrojtjes sociale do të shkojnë drejt përputhjes me konceptet të cilat po vihen në jetë aktualisht nga vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Përparësitë strategjike dhe politikat

1. Asistenca sociale

Qëllimi kryesor strategjik është pakësimi i shkallës së varfërisë absolute për frymë në 10% deri më 2013 sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes. Kjo kërkon rritjen e efikasitetit të menaxhimit të programeve kryesore të pagesave me para në dorë. Veçanërisht:

- Përmirësimi i targetimit për skemën e ndihmës ekonomike. Masa për familjet më të varfra të përfshira në skemë u rrit nga 24.6% në vitin 2002 në 32.5% në vitin 2005, por është ende e ulët. Gjithashtu, masa e familjeve jo të varfra që e përfitojnë pagesën u rrit nga 57% në vitin 2002 në 64% në vitin 2005, sidomos në zonat malore dhe bregdetare. Kjo kërkon:
 - Përdorimin e informacionit të përmirësuar. Numri i familjeve të varfra dhe fondet e duhura për bllok grantet e ndihmës ekonomike për çdo njësi të pushtetit vendor do të vendosen nëpërmjet hartës së varfërisë, e cila bazohet në Regjistrimin e Popullsisë e Banesave dhe anketat e familjeve;
 - Rritjen e masës së mbulimit të nevojave të familjeve të varfra përfituese. Deri në vitin 2013, propozohet që masa e ndihmës ekonomike për familje të synojë arritjen e treguesit të nivelit të varfërisë për person, por brenda një kufiri tavan që nuk e kalon nivelin e pensionit minimal në shkallë vendi. Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë do të vazhdojë të llogaritet në përputhje me strukturën e familjes, të diferencuar për grupet e ndryshme të anëtarëve të saj, në varësi edhe nga karakteristikat e varfërisë;
 - Përmirësimin e vlerësimit të familjeve kërkuese. Thjeshtimet dhe përmirësimet e propozuara do të lehtësojnë dokumentacionin dhe vëllimin e punës për kërkesat.

- Shtirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në të gjithë territorin. Synimi është rritja e transparencës në shpërndarjen e fondeve, ulja e numrit të familjeve dhe përfituesve abuzivë dhe rritja e të ardhurave për familje që angazhohen me punë në bashkësi.
- Përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë.

2. Kujdesi social

Politika për kujdesin social do të nxisë ofrimin e shërbimeve për personat në nevojë në familjet dhe bashkësitë e tyre, pa i futur në qendra banimi. Më poshtë jepen përparësitë strategjike të reformës:

- **Decentralizimi i shërbimeve sociale.** Vendimet në lidhje me planifikimin, ofrimin dhe realizimin e shërbimeve duhet të merren në nivel vendor (bashki dhe komuna) ku jetojnë përfituesit. Rregullat për ofrimin e shërbimit do t'i vendosë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila, përmes një inspektorati të ri do të monitorojë cilësinë dhe eficensën. Do të ndiqen dy drejtime për të kryer decentralizimin e shërbimeve të kujdesit social:
 - Qendrat e shërbimeve rezidenciale do t'u kalohen njësisive të qeverisjes vendore. Gjatë periudhës kalimtare, Shërbimi Social Shtetëror do të vazhdojë të bashkërendojë procesin e shpërndarjes së personave në nevojë në qarqe sipas mundësive në dispozicion.
 - Do të ngrihen shërbime të reja sociale në bashkësi sipas nevojave të identifikuar nga njësitë e qeverisjes vendore.
- **Institucionalizimi i marrëdhënies me organizatat joqeveritare** si ofrues të shërbimeve sociale dhe si mbrojtës të të drejtave dhe interesave të grupeve në nevojë. Të gjitha organizatat që ofrojnë shërbime sociale do të liçensohen. Gjithashtu, do të krijohet edhe mjedisi i nevojshëm ligjor për t'u dhënë mundësi njësisive të qeverisjes vendore të prokurojnë shërbime sociale.
- **Shndërrimi shkallë-shkallë i shërbimeve rezidenciale në shërbime të lëvizshme dhe të bazuara në bashkësi.** De-institucionalizimi është pjesë e procesit nga shërbimet sociale rezidenciale të shërbimit në bashkësi. Do të parandalohen pranimet e panevojshme në institucionet rezidenciale. Do të ofrohen alternativa për strehimin, trajtimin, arsimimin dhe riaftësimin e personave që nuk kërkojnë shërbime rezidenciale, sidomos për fëmijët. Do të përmirësohet trajtimi në institucionet rezidenciale.
- **Të sigurohet që njësitë e pushtetit vendor me të ardhura buxhetore të kufizuara të mbështeten përmes buxhetit qendror gjatë kohës që ato zhvillojnë shërbimet e reja sociale.**
- **Të gjitha shërbimet do të duhet të garantojnë një cilësi minimale sipas *standardeve* të hartuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.** Standardet do të përcaktojnë në mënyrë transparente dhe të matshme kriteret që duhet të plotësojë një shërbim. Ato do të përbëjnë një dokument publik dhe do të shërbejnë si bazë për mbikëqyrjen. Sistemi monitorues do të mbështetet në mekanizmat rregullatore, siç janë licensimi dhe inspektimi. Inspektimi në fillim do të ketë karakter këshillimor për të siguruar njohjen me standardet, por më pas do të jetë i detyrueshëm për të gjithë ofruesit e shërbimeve.

Përfshirja sociale

Sfidat

Përveç shërbimeve sociale, grupet e prekshme kanë nevojë për mundësi që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në zhvillim.

- **Fëmijët:** Ndërsa Shqipëria ka një skemë vaksinimi të detyrueshme, e cila e mban normën e imunitetit tek fëmijët në shkallë të lartë, fëmijët nga disa grupe pakicash nuk vaksinohen ashtu si pjesa dërrmuese e popullsisë. Më pak se 50% e fëmijëve janë të regjistruar në institucionet e fëmijërisë së hershme, publike ose private. Nuk merret asnjë masë ndaj prindërve që braktisin fëmijët e tyre ose që nuk i dërgojnë në shkollë. Për fëmijët e familjeve të varfra në Shqipëri është e zakonshme që të punojnë sidomos në tregun informal duke shitur cigare, duke larë

makina apo duke lypur. Së fundi, legjislati nuk ka një instrument për trajtimin e fëmijëve që bien viktimë të shfrytëzimit, abuzimit ose dhunës.

- **Romët:** Fëmijët romë shpenzojnë në sistemin arsimor mesatarisht më pak se gjysmën e kohës së fëmijëve të tjerë nga shumica e popullsisë. Për rrjedhojë, një në katër romë është i paarsimuar. Rreth 20% e fëmijëve romë (deri në moshën 14 vjeç) nuk janë vaksinuar, krahasuar me rreth 3% të shumicës⁹. Shkak për mungesën e vaksinimit të plotë, shpesh herë është informacioni i pamjaftueshëm apo identifikimi mjekësor. Ndryshimet e shpeshta të vendbanimit, martesat e hershme, mosnjohja e ligjit kanë bërë që romët të mos jenë të regjistruar. Për këtë shkak ata nuk mund të paraqesin kërkesa për asistencë, të cilën kanë të drejtë ta marrin sipas ligjit.
- **Personat me aftësi të kufizuara:** Ka patur një rritje të shpejtë të numrit të përfituesve në vitet e fundit, ndërsa shpenzimet reale nga viti 2000 në vitin 2005 pothuajse janë dyfishuar. Megjithatë, nuk është përpunuar akoma një metodë e integruar dhe e qëndrueshme për rehabilitimin e tyre.

Vizioni

Një zhvillim i qëndrueshëm dhe i shpejtë ekonomik do të ndihmojë për nxjerrjen e njerëzve nga varfëria. Zhvillimi shoqëror do të bëjë të mundur pjesëmarrjen e të gjithëve në shoqëri. Çdo fëmijë do të ketë mundësi sa më të mira për të filluar jetën. Të gjithë njerëzit e aftë për punë do të kenë mundësi të punojnë dhe ata që nuk mund të punojnë, do të kenë të ardhura të mjaftueshme për një jetë dinjitoze. Asnjë njeri nuk do të përjashtohet apo lihet pas.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale përqendrohet te rreziqet e varfërisë që ekzistojnë edhe pas rritjes ekonomike. Ajo përmbledh strategjitë sektoriale, të cilat kanë synim të ndihmojnë personat e prekshëm, familjet dhe grupet në bashkësi, me qëllim që këta të mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, të sigurojnë të ardhura dhe të kenë të njëjtat të drejta si dhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

Qëllimet strategjike përfshijnë edhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në lidhje me zbutjen e varfërisë, vdekshmërinë foshnjore dhe furinizimin me ujë e sanitetin. Kuadri i monitorimit të strategjisë është bazuar mbi treguesit e Bashkimit Europian dhe në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës që përsëritet çdo tre vjet. Strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale është përgatitur sipas modelit të Planit Kombëtar të Veprimeve për Përfshirjen Sociale, që çdo vend anëtar i Bashkimit Europian është i detyruar të dorëzojë. Përparësitë strategjike të kësaj strategjie janë:

- rritja e mundësive të individëve për të krijuar të ardhura
- lehtësimi i mundësive për të marrë pjesë në shërbime
- ndihma ndaj grupeve të prekshme

Në lidhjen me përparësinë e tretë, strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale përmbledh disa nga tekstet strategjike mbi grupet më të prekshme.

Fëmijët. Strategjia kombëtare e fëmijëve mbulon të gjitha aspektet e jetës së fëmijës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë që punon kundër varfërisë së fëmijëve. Përveç reformës në lidhje me shërbimet për fëmijët, masa të tjera përfshijnë:

- **Në fushën e drejtësisë:** ndarjen e të miturve nga të rriturit në trajtimin e çështjeve penale dhe procedura të përmirësuar për të miturit; kushte të përmirësuar në burgjet për fëmijët; përdorimin e gjerë të punonjësve socialë; shërbime të piketuara që ofrohen nga gjykatat dhe ngritjen e Institutit të Riedukimit të të Miturve
- **Në fushën e shëndetësisë:** menaxhimin e integruar të pacientit, ku përfshihen ekzaminimi, trajtimi dhe këshillimi, për sëmundjet kryesore të fëmijërisë
- **Në fushën e arsimit:** ngritja e njësive shumë profesionale në nivelin e pushtetit lokal, të cilat do të merren me problemet e ndryshme që pengojnë integrimin dhe zhvillimin e barazisë tek fëmijët

⁹ Në rrezik: Prekshmëria shoqërore e romëve në Shqipëri, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, gusht 2006

- Zbatimin e arsimit të detyrueshëm dhe krijimin e mundësive për formimin profesional, që parandalojnë punën e fëmijëve
- Ngritjen e strukturave në nivel vendor për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Romët. Qeveria do të bashkëpunojë me romët për përmirësimin e statusit të bashkësisë rome në Shqipëri nëpërmjet institucionalizimit të politikave dhe programeve për pakësimin e varfërisë, mposhtjen e diskriminimit dhe sigurimin e integritetit. Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome mbulon fushat e mëposhtme:

- regjistrimi i romëve për të bërë të mundur mbrojtjen e të drejtave dhe përfitimin nga shërbimet
- motivimi për ndjekjen e shkollës fillore, mbështetje për fëmijët që të mësojnë gjuhën shqipe, sigurimin e mësuesve që flasin gjuhën rome dhe programet e arsimit të të rriturve
- ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe të familjes, ku përfshihet edhe ruajtja e traditave dhe fuqizimi i grave dhe vajzave
- mundësi e përmirësuar për të përfituar nga shërbimet, përfshirë edhe ndihmën ekonomike
- mbulimi i shërbimeve shëndetësore në bashkësitë rome dhe nxitja e planifikimit familjar, imunizimi dhe kujdesi para dhe pas lindjes së fëmijës
- ndërtimi i shtëpive të thjeshta dhe i kalimeve rrugore në zonat e romëve
- përmirësimi i mundësive për të marrë pjesë në rendin publik nëpërmjet rekrutimit të romëve si policë

Personat me aftësi të kufizuara. Qeveria do të integrojë politikën dhe masat që nxisin përfshirjen e plotë në të gjitha fushat e jetës të personave me aftësi të kufizuara. Strategjia kombëtare për personat me aftësi të kufizuara përqendrohet më shumë tek aftësitë dhe kompetencat e individit sesa tek paaftësia e tij dhe mbulon fushat e mëposhtme:

- sigurimin e mundësisë duke hequr pengesat e ndryshme për të përfituar nga infrastruktura dhe ndërtesat publike
- hartimin e programeve për zbulimin e hershëm dhe parandalimin e paaftësisë, bashkërendimin e shërbimeve shëndetësore dhe shoqërore, në përputhje me politikën e decentralizimit të kujdesit shoqëror, integrimin e programeve dhe të proceseve mësimore
- përmirësimin e kushteve për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara nëpërmjet mbrojtjes në punë dhe përfshirjes në programe profesionale trajnimi
- ngritjen e kapaciteteve në strukturat shtetërore që kanë të bëjnë me politikën për njerëzit me aftësi të kufizuara
- përmirësimin e legjisllacionit dhe të ndërgjegjësimit për legjisllacionin, duke përfshirë procedurën të thjeshtuar

Sigurimet shoqërore

Sfidat

Pensionet janë pjesë e një sistemi kontributiv që ka objektiv sigurimin e mbrojtjes së pleqërisë. Parashikimet demografike dhe analiza e treguesve të sistemit të sigurimeve shoqërore tregojnë se në të ardhmen ky sistem do të përballë me sfida të mëdha për një numër arsyesh:

- numri i ulët i personave të punësuar në tregun e ligjshëm të punës
- norma relativisht të larta të kontributeve krahasuar me përfitimet nga kontributet
- nevoja e përmirësimit të administrimit të mbledhjes së kontributeve për uljen e evazionit në pagesën e tyre
- përzierja e skemës së pensioneve me atë të ndihmës ekonomike për disa kategori të veçanta pensionesh

Edhe studimet e realizuara kohët e fundit për sistemin e sigurimeve shoqërore¹⁰ argumentojnë nevojën e ristrukturimit të tij për ta bërë atë të qëndrueshëm në një plan afatgjatë, duke mbajtur parasysh nivelin relativisht të lartë të popullsisë që nuk do të jetë e mbuluar me pensione në të ardhmen dhe prirjen në rënie të normës së zëvendësimit, të shprehur në raportin e pensionit kundrejt pagës mesatare.

Vizioni i sektorit

Vizioni është ristrukturimi i sistemit publik të pensioneve. Përbushja e këtij vizioni do të synojë përfitimin e pensioneve më të mira për ata që paguajnë kontribute dhe sidomos për lidhjen më të mirë të përfitimeve me kontributet e paguara. Njëkohësisht do të nxitet futja në skemën kontributive të atyre që nuk paguajnë kontribute dhe të krijohet një mjedis i favorshëm për zhvillimin e tregut financiar të sigurimeve pa cenuar të drejtat e fituara të pensionistëve dhe të punonjësve që kanë derdhur kontribute në skemën aktuale.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Realizimi i synimeve të mësipërme do të kërkojë: ristrukturimin dhe reformimin e sistemit ekzistues njëshytllësh 'pay-as-you-go' (kontributet e sotme paguajnë pensionet e sotme), kalimin gradual dhe në klimën e një konsensusi politik drejt një sistemi shumëshytllësh të pensioneve, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e kolonës së tretë të pensioneve. Ndër masat më të rëndësishme përfshihen:

- Krijimi i një mjedisi të favorshëm për licensimin dhe ushtrimin e aktivitetit në fushën e sigurimeve nga kompani private me kapacitet dhe reputacion të lartë në tregun financiar
- Rritja e besimit të publikut tek skemat private të pensioneve dhe nxitja e tij për të marrë pjesë në skemat e pensioneve të kapitalizuara
- Forcimi i kontrollit dhe rregullimi i aktivitetit të kompanive të licensuara të investimeve për t'u kujdesur që investimet të jenë të sigurta dhe të mbrojtura nga rreziqet
- Zbatimi i kontrolleve të rrepta për përdorimin e fondeve të investuara nga kompanitë e licensuara, duke u siguruar që niveli i kapitalit të detyrueshëm të jetë në përputhje me kuadrin Bazel II
- Monitorimi i rregullt i gjendjes financiare të kompanive të licensuara të investimeve për të garantuar që fondet të jenë të sigurta, kthimin e investimeve të mira dhe mbojtjen e të drejtave të investuesve

Përgatitja e sistemit për të kaluar drejt një sistemi shumëshytllësh do të bëhet nëpërmjet:

- **Forcimit të masave për zbatimin ligjor të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore:**
 - Përmirësimi i metodave për të evidentuar, kontrolluar dhe dënuar rastet e moszbatimit ligjor
 - Zbatimi i penaliteteve përkatëse në rastet e evazionit
- **Reformimit të sistemit aktual nëpërmjet:**
 - Lidhjes më të mirë midis kontributeve dhe pensioneve
 - Krijimit të një skemë të pastër pensionesh të bazuar dhe të balancuar me kontribute
 - Përmirësimin të administrimit të skemës duke forcuar kontrollin mbi pagesat e sigurimeve shoqërore dhe në tërësi të ndryshimit të imazhit për sigurimet shoqërore, duke rritur ndërgjegjësimin në zbatimin e ligjeve që rregullojnë sistemin
- **Hartimit të kuadrit ligjor për një mirëfunksionim të kontrolluar të sistemit shumëshytllësh**
 - Hartimi i strategjisë së reformimit të sistemit aktual dhe përcaktimi i formës së sistemit shumëshytllësh (normës së kontributeve, moshës dhe vitit të futjes së shtyllës së dytë), nga

¹⁰ Rishikimi i sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri, Banka Botërore, shtator 2006

një grup teknik pune me pjesëmarrjen e ekspertëve përfaqësues të qeverisë, partive politike opozitare, si edhe organizatave joqeveritare

- Përgatitja e ligjit dhe e akteve normative për licensimin dhe standardet e funksionimit të sistemit shumëshyllësh
- Licensimi i institucioneve me kapacitete të mjaftueshme dhe të sigurta për të investuar fondet e pensioneve
- Krijimi dhe forcimi i një sistemi mbikëqyrës bashkëkohor për performancën e institucioneve të investimeve të fondeve të pensioneve
- **Forcimit të shtyllës së tretë ekzistuese, private dhe fakultative**
 - Krijimi i një sistemi të diversifikuar me shumë shtylla do të bëhet krahas me forcimin dhe përmirësimin e mjedisit për sigurimet vullnetare: harmonizimi i zhvillimit të shtyllave të sistemit do të bëhet duke zbatuar dy parimet
- **Ruajtjes së të drejtave të punonjësve që kanë paguar kontribute në sistemin aktual**
 - Ruajtja e pensioneve ekzistuese
 - Mbajtja dhe përmirësimi i shtyllës publike për punonjësit në moshë mesatare dhe afër pensionit, që kanë derdhur kontribute në këtë skemë
 - Njohja e të drejtave të fituara nga punonjësit në moshë të re që kanë derdhur kontribute në skemën publike
- **Planifikimit dhe menaxhimit të kalimit drejt sistemit të ri me shumë shtylla**
 - Hartimi i kuadrit ligjor për krijimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e shtyllës së dytë
 - Hartimi i një plani për financimin e kostos së transferimit të një pjese të kontributeve në shtyllën e dytë
 - Informimi i publikut në lidhje me sistemin e ri të pensioneve dhe mënyrën e funksionimit të tij
 - Kryerja e ndryshimeve të nevojshme institucionale dhe zhvillimi i kapaciteteve
 - Përgatitja dhe zbatimi i një plani veprimi për kalimin drejt sistemit të ri, në klimën e konsensusit politik

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të mbështesë sistemin e ri në drejtimet e mëposhtme:

- Fuqizimi i kapacitetit institucional të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare
- Përmirësimi i administrimit të kërkesave në lidhje me Detyrimin për Palët e Treta dhe ristrukturimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit
- Vlerësimi i politikave të kontrollit të rrezikut dhe parashikimi i masave institucionale për risigurimin

Zbatimi i MSA-së

Çështja e sigurimeve shoqërore përfshihet në Nenin 48 mbi lëvizjen e punës dhe në Nenin 99 mbi bashkëpunimin.

Shëndetësia

Sfidat

Sistemi i kujdesit shëndetësor përballet me sfida të reja, me ndryshimin e profilit epidemiologjik të popullsisë¹¹. Sëmundjet jongjitëse, kryesisht sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceroze, po kthehen në shkakun kryesor të vdekjeve. Faktorë të tjerë të rrezikshmërisë përfshijnë konsumin e lartë të duhanit dhe ndryshimin e dietës. Për rrjedhojë, duhet që sistemi i kujdesit shëndetësor të ndryshojë për t'iu përshtatur trajtimeve të gjata në kohë dhe të kushtueshme për këto lloj sëmundjesh, si dhe në të njëjtën kohë t'i kushtojë një vëmendje të veçantë kujdesit shëndetësor profilaktik dhe fushatave të shëndetit publik.

Sistemi i financimit të shëndetësisë është i copëzuar. Ka nisur t'i jepet zgjidhje këtij problemi nëpërmjet transferimit të financimit të kujdesit shëndetësor parësor në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) duke filluar nga viti 2007. Sigurimet shëndetësore si pjesë e kontributeve të mbajtura mbi pagën çojnë në pabarazi të tjera në lidhje me mundësinë e përdorimit të kujdesit shëndetësor. Vetëm një pjesë e vogël e popullsisë paguan kontribute si pasojë e mungesës së një tregu të ligjshëm pune, të kapacitetit administrativ dhe të strukturave kontrolluese.

Vizioni i sektorit

Sistemi shëndetësor do të ofrojë shërbime shëndetësore bazë për të gjithë, me cilësi të pranueshme dhe efikasitet. Kërkohe ndryshimi i mekanizmave bazë të organizimit, menaxhimit, financimit dhe modaliteteve të nxitjes së iniciativës private që të arrihet një vizion për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të popullatës.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike të sektorit të shëndetësisë janë si më poshtë:

- **Rritja e kapacitetit për të menaxhuar shërbimet dhe institucionet në mënyrë efikase:**
 - Vendosja e një kombinimi të ri publik-privat dhe e skemave krijuese organizative. Do të futet një koncept i ri në riorganizimin e strukturave publike dhe private, si bashkëplotësuese të njëra-tjetrës, duke synuar privatizimin e shërbimit të kujdesit parësor dhe të specialiteteve publike jo me shtretër.
 - Përmirësimi i menaxhimit klinik dhe të institucioneve në të gjitha nivelet. Përmirësimi i efikasitetit kërkon një menaxhim më të mirë dhe më efikas të institucioneve të ofrimit të shërbimit e të skemave klinike që përdoren për të drejtuar trajtimin e pacientëve.
 - Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe sigurisë së sistemit shëndetësor. Nevojitet përsosja e cilësisë së shërbimit të ofruar, duke u bazuar në sistemin e formimit të vazhdueshëm, si dhe akreditimi i institucioneve ku ofrohet kujdes shëndetësor në bazë të standardeve të miratuara dhe të publikuara paraprakisht.
 - Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve shëndetësore. Nevojiten përpjekje lidhur me trajnimet dhe formimin e vazhdueshëm për të përmirësuar njohuritë e aftësitë menaxheriale të vendimmarrësve, si dhe për të forcuar kapacitetet e personelit në pozicione kyçe të sistemit shëndetësor.
- **Rritja e mundësisë për marrjen e shërbimeve shëndetësore efektive:**
 - Pakësimi i pengesave financiare, gjeografike, kulturore dhe profesionale. Do të krijohet një grup shërbimesh, të cilat njerëzit mund t'i njohin lehtë si shërbime që duhet të merren falas dhe të cilat janë të përballeshme për vendin. Do të sigurohet në të gjithë vendin një shpërndarje e baraspeshuar e shërbimeve sipas shpërndarjes gjeografike dhe numrit të popullatës. Do të promovohet e drejta e punonjësve për mbrojtje, informim dhe kujdes shëndetësor në mjediset e qendrat e punës publike dhe private.

¹¹ Studim për sektorin e shëndetësisë, Banka Botërore, shkurt 2006

- Qartësimi i hallkave të një rrjeti shërbimesh në gjendje për të garantuar vazhdimësinë e kujdesit. Një Kujdes Shëndetësor Parësor i qëndrueshëm duhet të veprojë si një 'portier' i sistemit shëndetësor, duke u bazuar në efikasitetin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit.
- Ofrimi falas i shërbimeve më të domosdoshme të shëndetit publik të përhapura gjerësisht.
- Ofrimi i një mbulesë të qëndrueshme me barna. Medikamentet luajnë rol të rëndësishëm në çdo skemë të ofrimit të kujdesit shëndetësor.
- **Përmirësimi i financimit të sistemit shëndetësor:**
 - Rritja e mbulesës me parapagim. Grumbullimi i parave në një fond është e vetmja mënyrë për të mbrojtur shtresat më të dobëta të popullatës, pavarësisht nga aftësia e tyre paguese.
 - Reduktimi i rrjedhës jozyrtare të parave në sistem. Përparësia e mësipërme duhet të shkojë paralel me një pakësim të ndjeshëm të pagesave jo-zyrtare edhe nëpërmjet vendosjes së mekanizmit të bashkëpagesës.
 - Përmirësimi i alokimit të burimeve nga një blerës i vetëm strategjik. Një blerës i vetëm strategjik dhe efikas do të përqendrojë në mënyrë të baraspeshuar të gjitha vendimet për ndarjen e burimeve publike.
- **Përmirësimi i qeverisjes së sistemit shëndetësor:**
 - Forcimi i kapacitetit të Ministrisë së Shëndetësisë për të përgatitur politika e strategji dhe për të planifikuar në nivel kombëtar. Ajo do të përmirësojë aftësitë e saj për të siguruar drejtimin politik, duke e lënë ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve shëndetësore për të tjerët.
 - Rregullimi më i mirë. Një kuadër rregullator më i qartë dhe më shtrëngues nevojitet për të garantuar respektimin e të drejtave të gjithë aktorëve kur trajtohen çështje të tilla, si përgjigjja ndaj qytetarëve, e drejta për shërbime të veçanta, privatizimi, roli i organizatave profesionale, legjislativi i punës për profesionistët shëndetësorë etj.
 - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies. Një element kritik në qeverisjen e sistemit shëndetësor në Shqipëri është aftësia për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e tij.
 - Ngritja e një sistemi të informacionit mjekësor. Të nxitet ngritja e një qendre të posaçme, të aftë që në bazë të punës kërkimore dhe evidencës shkencore të disponueshme të japë përgjigje për zgjidhjet alternative me kosto efektive në shëndetësi.

Arsimi parauniversitar

Sfidat

Shqipëria ka tregues më të ulët të ndjekjes së shkollës së mesme në krahasim me vendet e rajonit. Shpenzimet e përgjithshme publike për arsimin kanë pësuar rënie gjatë periudhës së tranzicionit (3.1% të PBB-së në vitin 2004), ndërkohë që mesatarja e vendeve anëtare të BE është 4.9%. Si reflektim i përparësisë që Qeveria Shqiptare i ka kushtuar arsimit në vitin 2006 shpenzimet e përgjithshme publike për arsimin u rritën në 3.4% të PBB-së. Shkollat, përgjithësisht, kanë trashëguar mangësi në materialet didaktike, pajisjen me laboratorë dhe në mirëmbajtje. Qeveria arriti që për një periudhë dyvjeçare të ngrrej laboratorët e informatikës në të gjitha shkollat e mesme dhe pritet t'i mbulojë me internet brënda vitit 2008. Shkollat në qytete dhe në zonat periferike urbane punojnë mbi kapacitetin e tyre, ndërsa në disa zona rurale raporti nxënës-mësues është shumë i ulët, kurse infrastruktura e dobët e transportit vështirëson përqendrimin e shkollave. Rritja e përqindjes së regjistrimit në arsimin e mesëm të ulët, sidomos në zonat rurale, e në veçanti e vajzave, është një përparësi në kuadrin e Partneritetit Evropian. Shtrirja dhe rritja cilësore e arsimit profesional nuk u përgjigjet kërkesave të tregut, ka ende lidhje të dobëta me të dhe me partnerët socialë.

Vizioni i sektorit

Garantimi i një sistemi arsimor kombëtar modern, i cili nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rrit konkurrueshmërinë në rajon e më gjerë dhe konsolidon ndërgjegjen qytetare.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike të sektorit të arsimit parauniversitar janë si më poshtë:

Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikëbërës, menaxhues dhe vendimmarrës, është një nga përparësitë afatmesme në kuadër të Partneritetit Evropian:

- *Në nivel qendror:* Ristrukturimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve të varësisë duke ndërtuar një skemë të qartë menaxhimi me bazë performance.
- *Në nivel rajonal:* Ristrukturimi i Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore me objektiv rritjen e kapaciteteve në ndihmë të shkollave.
- *Në kuadër të decentralizimit:* Decentralizimi dhe transferimi i përgjegjësive dhe autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror në nivelin lokal të qeverisjes.
- *Në nivel shkolle:* Zbatimi i autonomisë shkollore në fushat e programeve të lëndëve, financimit, personelit dhe menaxhimit në nivel shkolle e më lart duke e plotësuar me bazën ligjore dhe organizmat realizues përkatës.
- *Zhvillimi i politikave dhe marrja e vendimeve qendrore, lokale e shkollore bazuar në kërkim dhe orientuar nga të dhënat:* Funksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në arsim.

Përmirësimi i cilësisë së procesit të mësimit përfshin disa drejtime:

- *Modernizimi i kurrikulës 1-12:* Ristrukturimi i arsimit të mesëm të lartë, hartimi i një kornize të re të programit të lëndëve, një shërbim arsimor cilësor njëherësh kombëtar dhe evropian.
- *Zhvillimi profesional i mësuesve:* Zbatimi i një reforme tërësore të zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave i mbështetur në kredite.
- *Përmirësimi i teksteve shkollore:* Përsosja e reformës së liberalizimit të botimeve të teksteve.
- *Përmirësimi i vlerësimit të nxënësve:* Konsolidimi i Maturës Shtetërore dhe i reformimi i Provimeve të Lirimit, si dhe rritja e transparencës dhe besueshmërisë së publikut ndaj institucioneve arsimore.
- *Zgjerimi i tregut të shërbimit arsimor privat,* i kombinuar me një mbikëqyrje të cilësisë së këtyre shërbimeve.

Përmirësimi i frytshmërisë së financimit në arsim përfshin disa drejtime:

- *Rritja e mbështetjes financiare të arsimit bazë nga qeveria qendrore dhe lokale*
- *Përmirësimi i skemës së financimit i mbështetur në numrin e nxënësve,* zvogëlimi gradual deri në eliminimin e dallimeve rajonale të trashëguara arsimore, ekonomike e sociale dhe racionalizimi i shkollave bazuar në prirjet e ndryshimeve demografike.
- *Sigurimi i rritjes së të ardhurave për arsimin* nëpërmjet përjashtimit nga taksat të investimeve jopublike sidomos në infrastrukturën arsimore

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore përfshin disa rrafsh:

- *Profesionalizimi i mësimdhënie-mësimnxënies:* Hartimi i standardeve të mësuesit dhe të statusit të tij, si dhe hartimi i standardeve dhe objektivave të arritjeve të nxënësve, me bazë performancën.
- *Inspektimi dhe ndihma:* Ndryshimi i rolit të inspektorëve nga një rol kryesisht kontrollues dhe ndëshkues, në një rol kryesisht mbështetës dhe përfshirja e inspektorëve në zhvillim intensiv profesional.
- *Motivimi i mësuesve:* Dyfishimi i pagave të mësuesve brenda vitit 2009 (tanimë në progres), sigurimi i kompetencave për mësimdhënie-mësimnxënie.

Zhvillimi i arsimit profesional përfshin:

- *Politikën e re të formimit dhe zhvillimit profesional* (tanimë të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta: këto aspekte janë trajtuar më

hollësisht në pjesën e strategjisë së punësimit) dhe krijimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me kërkesat e tregut.

- *Fuqizimin dhe shtimin e arsimit profesional* duke ngritur infrastrukturën e duhur.

Zgjerimi i ofrimit të arsimit parashkollor përfshin:

- *Futjen e një viti përgatitor para fillimit të shkollës fillore*, i cili synon rritjen e aftësisë për shkollë dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët e vegjël të grupeve të prekshme, sidomos (por jo vetëm) në Shqipërinë verilindore dhe për romët.
- *Modernizimin e arsimit parashkollor*: Përgatitja e mësuesve-edukatorë, ndërtimi i kopshteve dhe ngritja e kopshteve pranë institucioneve private dhe publike.

Tabela paraqet një listë të përzgjedhur të objektivave të përgjithshëm të strategjisë, në përputhje me dokumentin e Projektit 'Cilësi dhe Barazi në Arsimit'.

Treguesi i performancës	2006	2012	2004 BE
Pritshmëria shkollore për pesëvjeçarët (vite)	11.1	14	17.4
Koha mesatare vjetore e mësimin të detyrueshëm për shtatë- dhe tetëvjeçarët (orë)	570	660	750
Shkalla neto e rregjistrimit në arsimin e mesëm (%)	55	75	85
Përqindja e vajzave nga 15 deri 24 vjeç në arsim dhe trajnim (%)	33	50	66
Shpenzimet publike gjithsej për arsimin si përqindje e shpenzimeve publike gjithsej (%)	10,7	12,0*	10,8
Përqindja e shpenzimeve publike gjithsej e akorduar për zëra të shpenzimeve të përvitshme jo-paga (%)	10,0	13,0	19,9
Numri mesatar i nxënësve pesëmbëdhjetëvjeçarë për kompjuter në shkollat e sektorit publik	900	100	10
Rezultatet mesatare të nxënësve pesëmbëdhjetëvjeçarë në shkallën e aftësisë matematikore PISA	381	425	495

Burimi: Aneks 3 - Results framework and monitoring, Project Appraisal Document, Projekti i Cilësisë dhe Barazisë në Arsimit, Banka Botërore, maj 2006

* Kjo shifër paraqet vetëm shpenzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Bashkë me shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe pushtetit vendor për arsimin kjo shifër arrin në 16,8%.

Zbatimi i MSA-së

Neni 100 shpreh kërkesën për dhënien e mundësisë së arsimimit të të gjitha niveleve, për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi.

Arsimi i lartë

Sfidat

Ligji i ri "Për arsimin e lartë" u hap rrugën zhvillimeve të rëndësishme të arsimit të lartë. Në këtë zhvillim, universitetet kanë liri akademike, organizative, si dhe autonomi financiare. Po punohet për të plotësuar kuadrin ligjor me akte nënligjore që rrjedhin nga ligji i ri. Për zbatimin e procesit të Bolonjës është krijuar grupi i ndjekjes, i cili udhëheq punën për realizimin e këtij procesi. Në këtë kuadër është realizuar:

- Reformimi i sistemit të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në tre cikle, si dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Reformimi i kurrikulës në programet e studimit të ciklit të parë dhe tashmë 70% e përmbajtjes është e njëjtë në programe studimi të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë të vendit.
- Ngritja e sistemit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në institucionet publike të arsimit të lartë. Akreditimi i disa programeve të studimit me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private.
- Po përfundon hartimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në arsimin e lartë.

- Zbatimi i sistemit të krediteve 'European Credit Transfer and Accumulation System' (ECTS) dhe i Suplementit të Diplomës.
- Lehtësimi i procedurave për njohjen e diplomave të fituara jashtë shtetit.
- Rishikimi i ngarkesës së punës për personelin akademik të institucioneve të arsimit të lartë.
- Rritja e mobiliteteve të studentëve dhe stafit si brenda edhe jashtë vendit.

Është pranuar nevoja që universitete të ndryshme të kenë misione të ndryshme. Universitetet rajonale në veçanti nuk kanë një rol në zhvillimin lokal. Arsimit të lartë po orientohet drejt një formimi sa më të profilizuar. Gjatë këtyre viteve janë organizuar ndarje të programeve të studimit në profilizime në funksion të kërkesave të tregut të punës. Megjithëse me ligjin e ri të arsimit të lartë universiteteve u jepet autonomi, funksionimi aktual i saj është një detyrë për institucionet e arsimit të lartë. Ato nuk kanë një kuadër të drejtimit të brendshëm dhe as mekanizma të jashtëm të llogaridhënies. Nuk ka rregullime për menaxhimin e performancës në universitete. Kontrolli i cilësisë duhet të mbulojë edhe kurset me kohë të pjesshme. Mënyra e mësimdhënies në universitet, nuk ka ndryshuar. Përsa i takon përmbajtjes, kurset janë shpesh të ngushta e tradicionale dhe nuk kanë module që do t'u jepnin studentëve një lloj fleksibiliteti për lëndët që duhet të ndjekin. Pak vëmendje i kushtohet trajnimit didaktik të personelit mësues.

Mësimdhënia (në institucionet e arsimit të lartë) dhe kërkimi (në institutet kërkimore) kanë qenë të ndarë nga njëri-tjetri dhe sistemi i kërkimit shkencor është në reformim. Institucionet kërkimore të Akademisë së Shkencave dhe në varësi të ministrive të ndryshme tashmë janë pranë institucioneve të arsimit të lartë (kryesisht të Tiranës), gjë që do të japë një dimension të ri në zhvillimin e kërkimit.

Me gjithë investimet e bëra është e nevojshme të përmirësohet cilësia e infrastrukturës, disa prej ndërtesave, pajisjeve dhe bibliotekave nuk janë në standardet ndërkombëtare. Financimi nga buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm. Ka pak transparencë se si përdoren të ardhurat e universiteteve. Edhe mekanizmi për të mbështetur studentët me të ardhura të pakta (bursat) nuk është i orientuar mirë.

Vizioni i sektorit

Sistemi i arsimit të lartë dhe i veprimtarisë kërkimore-shkencore do të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë dijet përmes mësimdhënies, punës përkatëse kërkimore-shkencore dhe ofrimit të shërbimeve. Ai do të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe do të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike në arsimin e lartë janë si më poshtë:

Rritja e përqindjes së grupmohës së studentëve në arsimin e lartë. Në vitin 2007, 97,3% të atyre që kërkuan të ndjekin shkollat e larta në vitin arsimor 2007-2008 arritën të shpallen fitues të testimeve përkatës. Objektivi është të rrisë numrin e pranimeve të studentëve, për t'iu përgjigjur ritmit të rritjes vjetore të kontigjentit të nxënësve që përfundojnë me sukses shkollën e mesme, si dhe pakësimi i braktisjes së studimeve dhe rritja e numrit të studentëve që përfundojnë studimet në afatin normal të tyre. Numri shtesë i studentëve si dhe synimi për arritjen e standardeve të raportit studentë/personel akademik do të kërkonte rritjen e numrit të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë. Një pjesë e nevojave për pedagogë mund të mbulohet nga integrimi i instituteve kërkimore-shkencore në universitete. Nga ana tjetër, shtimi dhe përmirësimi i mjediseve universitare, infrastrukturës laboratorike, si dhe shfrytëzimi më eficient i mjediseve ekzistuese do të ndihmojnë në përballimin e rritjes së numrit të studentëve. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të përmirësojë gjithashtu skemën e pranimit dhe shpërndarjes së studentëve në institucionet e arsimit të lartë. Një pjesë e rritjes do të jetë në programe studimi dyvjeçare të nivelit jouniversitar. Universitetet rajonale janë më të përshtatshme për të rritur numrin e pranimeve, përmes ofrimit të këtyre programeve në ndihmë të ekonomive vendore. Mbetet detyrë e rëndësishme e institucioneve të arsimit të lartë rritja e bashkëpunimit me shkollat e mesme për orientimin e maturantëve drejt karrierës së tyre universitare.

Ristrukturim më efikas i misioneve të formimit universitar në ciklet e ndryshme të studimit. Objektivat e përgjithshëm *për ciklin e parë* janë rritja e numrit të pranimeve në institucionet e arsimit të lartë për të mundësuar thithjen e fluksit të rritur që vjen nga shkollat e mesme, përmirësimi i cilësisë së formimit, sigurimi i instrumenteve efektive që studentët të fitojnë dije dhe

kompetenca të nevojshme për punë dhe profesion. Objektivat *për ciklin e dytë* janë rritja e nivelit të formimit të studentëve, për të garantuar një përvetësim më të mirë të dijeve e praktikave lidhur me punën dhe profesionin, bashkë me një specializim të dijeve dhe kompetencave, respektivisht spektrit më të gjerë të formimeve në ciklin e parë. Është e nevojshme të ketë programe të posaçme kushtuar formimit për kërkim që synojnë rritjen e kompetencave dhe aftësime të studentëve për kërkim shkencor. Objektivi *për ciklin e tretë* është rikonceptimi i doktoratave e specializimeve afatgjata. Forma e studimit me kohë të pjesshme, do të reformohet drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës me synimin që diplomat e marra nëpërmjet këtij sistemi studimesh të kenë të njëjtën cilësi me ato të formës së studimit me kohë të plotë.

Sigurimi i një sistemi efektiv të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë është ngritur në vitin 1999 për të licensuar, akredituar dhe kontrolluar cilësinë e universiteteve. Ajo do të kryejë kontrollin e jashtëm të cilësisë duke i bërë publike raportet e veta. Përparësi do t'i jepet sigurimit të brendshëm të cilësisë nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Objekti i saj do të jenë edhe kurset me kohë të pjesshme, programet e diplomave dyvjeçare, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies.

Rritja e nivelit të autonomisë institucionale. Autonomia akademike, strukturore, administrative dhe financiare e dhënë nga ligji për arsimin e lartë duhet të përfshihet në statutet dhe rregulloret e universiteteve. Megjithatë, autonomia duhet të ekuilibrohet me një llogaridhënie të jashtme më të fortë dhe procese menaxhimi të brendshme transparente. Lidhur me përgjegjshmërinë e *jashtme*, në universitete do të funksionojnë Këshillat Administrativë me anëtarë nga personeli akademik, studentë dhe anëtarë që përfaqësojnë grupe interesi nga bashkësia. Këshillat Administrativë mbikëqyrin dhe kontrollojnë veprimtarinë menaxhuese administrative, financiare dhe të pronave të institucioneve të arsimit të lartë sipas një rregulloreje të veçantë të miratuar për këtë qëllim. Çdo universitet do të botojë edhe një raport vjetor, me rezultatet e arritura sipas treguesve të përcaktuar të performancës si edhe rezultatet e procesit të kontrollit të jashtëm të cilësisë. Në lidhje me kërkesat e menaxhimit të *brendshëm*, universitetet do të propozojnë procese drejtimi dhe struktura për marrjen e vendimeve, sipas udhëzuesve, që të ketë më shumë transparencë në marrjen e vendimeve dhe më shumë llogaridhënie të brendshme për këto vendime nga ana e rektorit përpara niveleve më të ulëta. Pas miratimit të tyre, këto do të përfshihen në statutet e universiteteve.

Integrim më i mirë i mësimdhënies me punën kërkimore. Është ngritur Grupi i Strategjisë për Punën Kërkimore i cili do të caktojë përparësitë (p.sh. studime albanologjike, bujqësi dhe ushqim, burime natyrore, etj.). Puna kërkimore do të financohet me projekte në fushat me përparësi, përmes një procesi konkurrimi. Shumica e punës kërkimore do të bëhet brenda tre universiteteve kryesore në Tiranë, në të cilët janë përfshirë institute kërkimore, si dhe në Qendrën e Studimeve Albanologjike, por edhe universitetet rajonale do të kenë mundësi të marrin pjesë në konkurrimin për një projekt kërkimor-shkencor. Megjithatë, funksioni kryesor i tyre pritet të jetë arsimit profesional dhe do të jenë përfituesit kryesorë të fondeve të zhvillimit për këtë qëllim. Gjithashtu, do të ketë stimuj si dhe thjeshtim të procedurave të miratimit të kontratave për universitetet rajonale për të pasur lidhje më të forta me bashkësinë, ofrimin e konsulencës, punën shkencore të zbatuar dhe shërbime të tjera. Në shërbim të këtij objekti është edhe investimi për ngritjen e laboratorëve kërkimorë në universitete, investim që do vazhdojë edhe në vitet e ardhshme për vetë nevojën që ka infrastruktura kërkimore për t'u rinovuar dhe pasuruar.

Përmirësimi i mësimdhënies. Filozofia e reformës së arsimit të lartë synon t'i pajisë të diplomuarit me aftësi të transferueshme dhe të përgjithshme, siç janë ato të analizës, të të menduarit, arsyetimit, prezantimit dhe komunikimit. Për të nxitur përdorimin e metodave ndërvepruese mësimdhënëse me studentin në qendër, universiteteve do t'u jepen fonde të posaçme investimi. Universitetet do të përgatisin një sistem të zhvillimit të performancës dhe karrierës për personelin akademik, duke vendosur theksin te cilësia e mësimdhënies. Do të reformohet dhe përmbajtja e mësimdhënies në përputhje me procesin e Bolonjës. Do të nxiten fakultetet dhe universitetet për të ofruar programe studimi më të gjera e ndërdisiplinore si punë e përbashkët mes dy fakulteteve ose edhe mes universiteteve.

Përmirësimi i financimit. Institucionet e arsimit të lartë lypset të kenë një të ardhme financiare të shëndetshme; shteti do të mbetet burimi kryesor i financimit të tyre. Niveli i përgjithshëm i shpenzimeve publike për çdo universitet do të përfaqësojë performancën dhe do të mbështetet në një formulë financimi e cila ponderon numrin e studentëve për lëndë dhe nivelin e studimit. Fondet e investimeve do të akordohen sipas projekteve, të shoqëruara me kosto të përgatitura nga secili

universitet. Do përmirësohet përdorimi më eficient i ndërtesave. Do të merren në konsideratë edhe dy burime të tjera të ardhurash për të shtuar ato publike si shitja e shërbimeve, ku mund të përfshihen dhe studime kërkimore për nevoja të të tretëve ose trajnimit të mësuesve nëpërmjet praktikës, kurse tarifa e shkollimit, e cila aktualisht mbulon rreth 22% të kostos së plotë, do të rritet shkallë-shkallë (25-30%). Çdo universitet do të lejohet t'i mbajë fondet që i ka fituar vetë dhe t'i shpërndarjë ato. Skema e tanishme e mbështetjes për studentët e varfër do të zëvendësohet me një sistem të ri burse, i cili do të përdoret më mirë dhe do të nxisë arritje të larta shkollore.

Zbatimi i MSA-së

Arsimi i lartë dhe çështjet e kërkimit përcaktohen në Nenin 54 për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve, Neni 100 për vendosjen e kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, dhe Neni 109 për bashkëpunim në fushën e kërkimit.

Zhvillimi urban, rural dhe rajonal

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ka për qëllim të parandalojë zhvillimin e pabarabartë, që ky të mos bëhet pengesë e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Si pikënisje në planifikimin hapësinor, shërben kuadri i ri ligjor, i cili do të përqendrohet në zhvillimin e planeve rregulluese me pjesëmarrje, për të trajtuar në mënyrë koherente problemet e atyre zonave, të cilat kanë dëshmuar nivelet më të larta të rritjes në Europë gjatë viteve të fundit. Në zhvillimin rural dhe rajonal, strategjia propozon politika dhe struktura zbatimi të reja, të cilat përgatisin administratën për një përdorim frytdhënës të instrumenteve financiare, që do të jenë të disponueshme në 7 vitet e ardhshme. Në zonat rurale, politikat udhëhiqen nga nevoja për të siguruar ekzistencën e shërbimeve të ofruara, të cilat mbështesin aktivitetin ekonomik dhe nxisin larmishmërinë ekonomike. Varësia e shumë zonave rurale nga turizmi pritet të rritet dhe kjo kërkon një qasje të integruar që siguron qëndrueshmëri, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e historike.

Planifikimi hapësinor

Sfidat

Informaliteti është një nga sfidat kryesore me të cilat përballet zhvillimi territorial dhe hapësinor në Shqipëri gjatë këtyre viteve. Sfida të tjerat të rëndësishme të zhvillimit territorial dhe hapësinor janë:

- Lëvizjet demografike dhe urbanizimi i shpejtë. Këto dukuri janë shoqëruar me mungesën e planifikimit urban në qytete dhe shpeshherë me zbatimin sipas rastit të rregullave për ndërtimin. Në mungesë të planeve rregulluese, zhvillimi urban bëhet kryesisht pa marrë parasysh efektin që ka plani mbi infrastrukturën ekzistuese dhe mjedisin.
- Ndarja jo e qartë e kompetencave midis nivelit vendor dhe qendror. Shumë funksione të menaxhimit të territorit urban u janë kaluar shkallë-shkallë njërive të pushtetit vendor, ndërkohë që autoritetet vendore shpeshherë nuk kanë pasur burimet e nevojshme për t'i kryer këto funksione me efektivitet.
- Niveli i ulët i kapaciteteve profesionale në fushën e planifikimit.
- Korrupsioni i lartë në administratë.

Vizioni i sektorit

Politika e planifikimit hapësinor do të nxisë dhe do të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm territorial, për të mundësuar përdorimin racional të tokës dhe burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, krijimin e kushteve të përshtatshme për banim, aktivitet ekonomik e shoqëror për të gjitha kategoritë sociale në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike për planifikimin hapësinor janë:

- Ristrukturimi i kuadrit ligjor të planifikimit të territorit, duke iu përgjigjur më mirë sfidave të zhvillimit të vullshëm ekonomik-social të vendit. Këtu do të përfshihen:

- hartimi i instrumenteve të njëtrajtshme të kontrollit të zhvillimit, siç janë: kodet e ndërtimit, rregullorja e përdorimit të tokës, rregullorja e nënndarjes së tokës, ngrirja e ndërtimeve, servituti publik ose rezervimi i tokës publike; këto janë kufizimet ligjore të mbështetura nga një procedurë, në kuadër të së cilës duhet vërtetuar përmbushja e detyrimeve ligjore, të cilat nëse nuk arrihen, atëherë zbatohet një sanksion ose një gjobë
- thjeshtëzimi i proceseve të lejeve të zhvillimit dhe atyre të ndërtimit, të cilat do të shndërrohen në një akt të thjeshtë administrativ, i mbuluar nga Kodi i Procedurës Administrative
- ndryshimi i niveleve të planifikimit e të kontrollit sipas kompetencave e funksioneve të dhëna me ligj
- Nxitja e krijimit të mekanizmave që lehtësojnë **angazhimin aktiv dhe pjesëmarrjen e publikut** e të gjithë të interesuarve. Kjo pjesëmarrje, veçanërisht e bashkësive dhe qytetarëve në nivel vendor në vendimmarrjen për planifikimin hapësinor, garanton transparencë të procesit.
- **Forcimi i institucioneve dhe mekanizmave bashkërendues**, duke siguruar nga njëra anë bashkëpunim 'horizontal' ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për politikat hapësinore dhe sektoriale në secilin nivel administrativ, dhe nga ana tjetër, bashkëpunimin 'vertikal' ndërmjet nivelit qendror dhe atij vendor. Kjo do të jetë në funksion të garantimit të një strukture efikase të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor.
- **Forcimi i kontrollit mbi territorin** për të siguruar zhvillimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi

Planet rregulluese do të miratohen nga këshillat komunalë/bashkiakë. Ky sistem do të respektojë parimin e subsidiaritetit në ndarjen e pushteteve, duke decentralizuar pushtetin vendimmarrës në mënyrë që të përfitohet më mirë nga perspektivat e zhvillimit lokal dhe të ulen kostot e sektorit privat. Do të ofrohet mbështetje financiare dhe teknike për përgatitjen e planeve rregulluese për disa qytete.

Shkurtimisht, kuadri ligjor do të sigurojë që ndërtimet e reja të jenë në përputhje me planet rregulluese, të cilat do të hartohen dhe miratohen përmes një procesi transparent e me pjesëmarrje të palëve të interesuara. Së bashku me trajnimin e ofruar për njësitë vendore, si dhe me ligjin e ri për inspektimin e ndërtimeve, këto masa do të ndikojnë ndjeshëm në zbatimin e planeve rregulluese dhe do të shkurtojnë e thjeshtojnë procedurat për lëshimin e lejeve të ndërtimit, duke ulur mundësinë e korrupsionit të zyrtarët. Qeveria do të sigurojë që dinamika e ndryshimeve, e cila pritet nga mbarimi i proceseve të kthimit, regjistrimit dhe legalizimit, të përdoret më mirë përmes këtij kuadri të ndryshuar të planifikimit hapësinor.

Në fushën e **strehimit**, politikat do të arrijnë grupet më të varfra në mënyrë sa më efikase dhe të frytshme, do të mbështesin sektorin e banesave me qira dhe do të përmirësojnë fondin e banesave. Në veçanti:

- banesat sociale me qira do të përbëjnë të paktën 1% të fondit të përgjithshëm të banesave
- banesat me kosto të ulët do të përbëjnë rreth 5% të fondit të përgjithshëm të banesave nëpërmjet skemave të partneritetit
- do të rritet mundësia për të marrë kredi hipotekore në 20-30%
- do të rehabilitohet rreth 1% e fondit të banesave të privatizuara; dhe
- do të rehabilitohen deri në masën prej 50% vendbanimet e bashkësisë rome

Zhvillimi rajonal

Sfidat

Shqipëria ka probleme serioze të pabarazisë rajonale. Qeveria ka identifikuar nevojën për një politikë të integruar, koherente rajonale, bazuar në shqetësimin e saj në rritje për hendekun që po thellohet gjithnjë e më shumë në performancën social-ekonomike ndërmjet pjesëve të ndryshme të vendit. Është shumë e nevojshme të sigurohet që të gjitha zonat e vendit të jenë të afta të konkurrojnë në tregun e bashkuar të Europës. Qeveria është e ndërgjegjshme për rëndësinë e

zbatimit të Parimit të Partneritetit si një nga parimet kryesore të miratuara në programimin e fondeve të BE dhe do të ndërmarrë konsultime përkatëse me aktorë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

Vizioni

Vizioni është një zhvillim i ekuilibruar dhe i qëndrueshëm i rajoneve të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe zonave malore e periferike, në veçanti, me qëllim që të mbështetet zhvillimi i shpejtë i të gjithë vendit.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Duke pasqyruar kërkesat e zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal dhe përfaqsimin e tyre me politikat e vendeve anëtare të BE, roli koordinues i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do të forcohet. Vizioni do të realizohet përmes dy objektivave strategjikë:

- Të gjitha qarqeve do t'u jepet mundësia të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrueshmërinë. Objektivi do të arrihet nëpërmjet dy përparësive:
 - Forcimi i kapacitetit të qarqeve në të gjithë vendin për të përdorur dhe menaxhuar potencialin e tyre të zhvillimit. Si instrument i politikës për arritjen e tij do të shërbejë *Programi Kombëtar për Zhvillimin e Qarqeve*, i cili synon të lehtësojë formimin e një sistemi unik menaxhimi e planifikimi dhe do të sjellë elemente të reja në politikën rajonale:
 - (1) Një kuadër unik politikash për zhvillimin social dhe ekonomik të qarqeve, duke marrë tërësisht parasysh nevojat e tyre specifike të zhvillimit;
 - (2) Një partneritet midis palëve të interesuara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
 - (3) Një dokument unik programimi për zhvillimin social dhe ekonomik të qarkut, *Strategjia e Zhvillimit të Qarkut*, dhe një agjenci lokale për të koordinuar zbatimin e saj, *Agjencia e Zhvillimit të Qarkut*;
 - (4) Koncepti i *Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut*, një plan financiar dhe operacional strategjik të pranuar, që përcakton mbështetjen e qeverisë qendrore për zhvillimin e prioritetëve në secilin prej qarqeve
 - (5) Një sistem efektiv monitorimi, vlerësimi dhe raportimi
 - Mbështetja e zonave jo të favorizuara për t'i aftësuar të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme kombëtare. Si instrument i politikës për arritjen e tij do të shërbejë *Programi për Zhvillimin e Zonave të Pafavorizuara*, i cili parashikon zhvillimin dhe realizimin e një Plani për Zhvillimin e Zonave të Pafavorizuara dhe caktimin e një linje të veçantë buxheti për mbështetjen e zhvillimit të tyre.
- Do të krijohet një kuadër efikas menaxhimi i zhvillimit rajonal, një kuadër i unifikuar ligjor dhe një infrastrukturë institucionale efikase dhe e koordinuar për politikën rajonale. Objektivi do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të dy përparësive:
 - Krijimi i kuadrit ligjor për menaxhimin efikas të politikës rajonale. Si instrument i politikës për arritjen e tij do të shërbejë ligji i propozuar për Zhvillimin Rajonal dhe aktet nënligjore përkatëse.
 - Sigurimi i kuadrit institucional të nevojshëm për koordinimin, administrimin dhe menaxhimin efikas të politikës rajonale në të gjitha nivelet. Si instrument i politikës për arritjen e tij do të shërbejnë dy kategori strukturash:
 - (1) Strukturat këshillimore
 - (i) Këshilli i Partneritetit Kombëtar që do të monitorojë efektivitetin e zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal, si dhe arritjen e konsensusit;
 - (ii) Këshillat e Partneritetit të Qarqeve, që do të planifikojnë strategjinë e zhvillimit të qarkut dhe monitorojnë efektivitetin e zbatimit të saj, si dhe arritjen e konsensusit
 - (2) Strukturat zbatuese
 - (i) Në nivel kombëtar, për një menaxhim efektiv të politikës rajonale dhe për zbatimin në të ardhmen të politikës rajonale të BE nëpërmjet adaptimit të Kapitullit 22 të acquis communautaire;
 - (ii) Në nivel rajonal, Agjencia e Zhvillimit të Qarkut do të asistojë Këshillin e Partneritetit të Qarkut.

Zbatimi i MSA-së

Neni 110 trajton çështje të bashkëpunimit në politikat e zhvillimit rajonal. Gjithashtu, Neni 71 parashikon përputhjen e rregullave shqiptare të ndihmës shtetërore dhe përkufizimin e ndarjes së zonave dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.

Zhvillimi rural

Sfidat

Niveli i jetesës në zonat rurale është shumë më i ulët se në zonat urbane. Dimensionet kryesore të varfërisë rurale janë: të ardhura për frymë të ulëta, incidenca relativisht e lartë e sëmundshmërisë dhe zhvillimi i pamjaftueshëm i shërbimeve mjekësore, mundësi të kufizuara për shkollim të mirë dhe shërbime publike të pamjaftueshme. Varfëria është më e thellë për pjesën e popullsisë që merret me bujqësi.

Pakësimi i varfërisë është i lidhur ngushtë me rritjen e prodhimit bujqësor, si burim bazë për rritjen e të ardhurave, por edhe me punësimin jashtë fermës, prandaj modernizimi i fermës dhe diversifikimi i aktiviteteve që japin të ardhura në zonat rurale (zhvillimi i agropërpunimit, shërbimeve, tregtisë dhe artizanatit) do të jenë drejtimet kryesore. Pakësimi i varfërisë rurale do të varet edhe nga rritja e cilësisë së produkteve që prodhohen në fermë, nga nxitja e prodhimit të produkteve me vlerë të lartë (fruta dhe perime), çka do t'i bëjë fermat më konkurruese, produktet e tyre më të kërkuara në treg dhe, për pasojë, do të rriten edhe të ardhurat e fermës.

Në zonat rurale gjenden potenciale të mjaftueshme. Këtu hyjnë kushtet natyrore dhe pozita gjeografike e favorshme, popullatë relativisht e arsimuar ku përfshihen edhe mjaft të rinj, traditë e mirë në punët e bujqësisë, kultura lokale të stabilizuara mirë, perspektiva optimiste për përmirësimin e furnizimit me energji, dhe zotime serioze për përmirësimin e infrastrukturës fizike rurale (rrugë dhe sisteme ujitëse).

Vizioni

Vizioni i strategjisë është të kontribuojë për zhvillimin rural në mënyrë të barabartë në të gjithë rajonet e vendit, për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e jetës në këto zona dhe për të ulur varfërinë e popullsisë së këtyre rajoneve.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike të strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rural janë:

- Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues me ndërmarrjen e masave për modernizimin e fermës, si dhe duke mbështetur ristrukturimin dhe zhvillimin e veprimtarive që sjellin vlerë të shtuar
- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit përmes menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat rurale
- Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e diversifikimit të veprimtarive ekonomike në zonat rurale për të krijuar vende të reja pune
- Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve lokale për të menaxhuar me efektivitet programet e zhvillimit rural

Qëllimi i strategjisë për zhvillimin rural është të ofrojë një marrëveshje në nivel kombëtar, e cila të jetë në përputhje me politikën e qeverisë, për hartimin dhe zbatimin e programeve operative të zhvillimit rural, të cilat do të përgatiten sipas nevojave të rajoneve. Strategjia mbështetet në Rregulloren e BE për Zhvillimin Rural dhe në udhëzimet strategjike të BE për zhvillimin rural për periudhën 2007-2013. Në bazë të strategjisë do të përgatitet në vitin 2008-2009 një program operativ për zhvillimin rural. Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural përmban nëntë politika të organizuara në katër boshte, të cilave u korrespondojnë disa masa të përzgjedhura të Rregullores së BE për Zhvillimin Rural.

- Boshti 1. Konkurrueshmëria e bujqësisë, agrobiznesit dhe pyjeve
 - Modernizimi dhe ristrukturimi i bujqësisë, kryesisht përmes modernizimit të tokave bujqësore dhe mbështetjes së fermerëve për t'iu përshtatur standardeve të legjislacionit të BE

- Rritja e vlerës së shtuar dhe cilësisë së prodhimit dhe përpunimit, kryesisht nëpërmjet mbështetjes së fermerëve që marrin pjesë në skemat e cilësisë së ushqimeve, dhe grupeve të prodhuesve për aktivitete informuese dhe promovionale për produkte të përfshira në skemat e cilësisë ushqimore
- Menaxhimi i pyjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe të frytshme, kryesisht përmes investimeve për të përmirësuar vlerën ekonomike të pyjeve dhe mbështetjes për grupet prodhuese të pyjeve
- Rritja e nivelit të aftësive praktike dhe të punësimit, e cila është pjesë e pandarë e procesit të përshtatjes me standardet e BE, që synojnë zhvillimin e potencialit njerëzor për të krijuar aftësi drejtuese tek fermat bujqësore, si dhe do të mbështesë fermerët aktivë të bashkësisë rurale
- Boshti 2. Ruajtja e peizazhit dhe mbrojtja mjedisore
 - Ruajtja e peizazhit në zonat më pak të favorizuara nëpërmjet zhvillimit të metodave bujqësore në përputhje me ruajtjen e mjedisit, kompensimin e prodhuesve të zonave malore për ta mbajtur tokën në kushte të mira dhe për ruajtjen e peizazheve kulturore të rëndësishme
 - Ruajtja e praktikave bujqësore tradicionale dhe e potencialit gjenetik duke futur prodhimet e kontrolluara e organike dhe duke parandaluar degradimin e vlerave ushqyese të tokës.
- Boshti 3. Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe promovimi i shumëllojshmërisë së ekonomisë rurale
 - Krijimi i vendeve të punës në zonat rurale përmes rritjes së potencialit për biznes në zonat rurale me anën e diversifikimit të fermave bujqësore në aktivitete jobujqësore, si dhe duke promovuar krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve familjare apo bizneseve të vogla të mbështetura në avantazhet konkurruese të zonave rurale
 - Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale, për shembull, nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të fshatrave (rrugë lokale, ujësjellës e kanalizime) dhe mbështetjes për ruajtjen e trashëgimisë rurale
- Boshti 4. Pjesëmarrje në zhvillimin rural
 - Futja e qasjes LEADER, një nga iniciativat e BE për të mbështetur bashkësitë rurale, si një instrument për qeverisjen e decentralizuar, bazuar në përvojën ekzistuese të Agjencisë për Zhvillimin e Zonave Malore dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin, për të siguruar që financimi i zhvillimit rural të ketë një përmasë bashkësie, për shembull, përmes krijimit të grupeve lokale të aksionit

Bujqësia

Sfidat

Sektori bujqësor vuan nga madhësia e vogël e fermës dhe copëzimi i pronës tokësore.

Konkurrueshmëria e produkteve është e ulët, për shkak të kostos relativisht të lartë dhe cilësisë së ulët të produkteve të prodhuara nga ky sektor, që shkaktohen kryesisht nga niveli i pamjaftueshëm i teknologjive dhe njohurive bujqësore, por edhe nga shkalla e ulët e organizimit të fermerëve, mungesa relative e informacionit të tregut dhe infrastruktura e pazhvilluar tregtare.

Aktualisht, mundësitë e eksportit për produktet bujqësore dhe agro-ushqimore janë shumë të kufizuara si rrjedhojë e nivelit të ulët të prodhimit bujqësor dhe industrisë agro-përpunuese; mungesës së lehtësive të tregtimit; standardeve të ulëta të sigurisë ushqimore dhe shkallës së ulët të konkurrueshmërisë. Plotësimi i kushteve veterinarë, fitosanitare dhe të sigurisë ushqimore të Marrëveshjes së Përkohshme të MSA-së do të jetë një sfidë e vështirë. Standardet që duhen përmirësuar përfshijnë një fushë shumë të gjerë, në të cilën përfshihen prodhimi, marketingu, kushtet e certifikimit të sigurisë dhe cilësisë së produkteve e shërbimeve, përpunimi, si dhe shërbimet e inspektimit dhe kontrollit.

Vizioni i sektorit

Sigurimi i një produktiviteti dhe konkurrueshmërie të lartë të sektorit bujqësor dhe atij të agro-përpunimit në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Rritja e konkurrueshmërisë, si pasojë e uljes së kostos dhe rritjes së cilësisë, sigurisë dhe standardeve ushqimore, do të forcojë pozitat e fermerëve në treg, do të rrisë të ardhurat e tyre dhe do të sjellë në treg produkte më të sigurta për fermerët.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë e qeverisë për bujqësinë janë si më poshtë:

- **Rritja e mbështetjes financiare** për fermat, bizneset bujqësore dhe ato agro-përpunuese, dhe në mënyrë të veçantë për pemët frutore, vreshtat, perimet dhe blegtorinë, kurse në përpunimin industrial të frutave, rrushit, perimeve, qumështit dhe mishit, në bazë të avantazheve në zona të ndryshme të vendit. Instrumentet kryesore politike do të jenë:
 - mbështetja e drejtpërdrejtë me fonde shtetërore, ose me fonde komunitare europiane e lidhur me arritjen e statusit të kandidatit për anëtarësimin në BE
 - përmirësimi i skemave të kredive me kushte lehtësuese, me qëllim modernizimin e fermave e bizneseve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve, përmes mbështetjes së bankave rurale dhe garancive për kreditë
 - zgjerimi i sistemit bankar rural nëpërmjet stimujve fiskalë dhe mobilizimit të kursimeve brenda sektorit përmes mbështetjes së skemave efektive të kursim-kreditit
- **Përmirësimi i menaxhimit, ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore**, në dy faza:
 - Gjatë periudhës 2007-2009: rehabilitimi i mbi 120.000 ha infrastrukturë kulluese; thellimi i shtretërve të lumenjve dhe sistemimi i përrenjve malorë (përmes pyllëzimit të brigjeve) për të pakësuar gërryerjen e tokës; rehabilitimi i mbi 120.000 ha infrastrukturë ujitëse dhe transferimi i menaxhimit të tyre te shoqatat e përdoruesve të ujit; rehabilitimi i 35 digave të dëmtuara; rritja e rolit të njësisë të qeverisjes vendore për menaxhimin e skemave të ujitjes e të kullimit dhe rritja e rolit të sektorit privat për ndërtimin dhe menaxhimin e skemave të vogla të ujitjes e kullimit
 - Gjatë periudhës 2010-2013: përmirësim i mëtejshëm i qëndrueshmërisë së menaxhimit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes së tokës për të siguruar ujitjen e 360.000 ha me 3500-5000 m³/ha (me mbështetjen e shoqatave të përdoruesve të ujit), dhe kullimin e 280.000 ha (me mbështetjen e bordeve të kullimit, të cilat do të jenë pjesërisht me vetëfinancim)
- **Përmirësimi i marketimit të produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara** për të rritur konkurrueshmërinë e bujqësisë vendase, duke e vënë theksin në:
 - rritjen e efikasitetit të tregjeve ekzistuese të shitjes me shumicë, përmes futjes së instrumenteve ose skemave mbështetëse që përmirësojnë menaxhimin e tyre
 - ngritjen e tregjeve të reja
 - fuqizimin e strukturave publike të mbikëqyrjes dhe analizës së tregjeve
 - mbështetjen për pikat e grumbullimit, standardizimin dhe ambalazhimin
 - përmirësimin e informacionit tregtar për fermerët dhe operatorët e tjerë të tregut të mallrave bujqësore dhe agro-industriale
- **Rritja e nivelit dhe cilësisë së teknologjive, informacionit e njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve** përmes mbështetjes për Qendrat e Informacionit Bujqësor (QIB) dhe Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB). Instrumentet kryesore politike do të jenë:
 - forcimi institucional, si dhe mbështetja më e mirë teknike dhe financiare e këtyre qendrave
 - trajnimet dhe marrja e përvojave brenda e jashtë vendit
 - përgatitja e materialeve informuese dhe paketave teknologjike për varietetet dhe racat kryesore
 - nxitja e akt-marrëveshjeve me fermerët

- forcimi i metodave të reja të ekstensionit, si Shkollat Fushore të Fermerëve dhe Zhvillimi me Pjesëmarrje i Teknologjive, duke realizuar edhe ristrukturimin e përputhjen më të mirë të kërkimit në fermë me nevojat reale të fermerëve
- Rritja e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara
 - përmirësimi i kuadrit ligjor për kryerjen e kontrollit zyrtar të produkteve ushqimore të prodhuara në vend dhe të importuara sipas standardeve të cilësisë dhe sigurisë të produkteve ushqimore në BE
 - mbështetje në përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës për kryerjen me efikasitet të kontrollit të produkteve ushqimore, ndjekjen e problemeve të ndryshme, si falsifikimi, ambalazhimi, tregtimi dhe importi i produkteve ushqimore, si dhe shkëmbimi i informacionit ndërrajonal
 - zbatimi i sistemeve ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë si HACCP dhe ISO
 - forcimi i zbatueshmërisë së sistemeve të cilësisë dhe sigurisë nga subjektet prodhuese të produkteve ushqimore
 - nxitja e përdorimit të praktikave të mira bujqësore dhe praktikave të tjera dashamirëse ndaj mjedisit
 - hartimi i politikave të përshtatshme për rritjen e prodhimit të produkteve organike

Zbatimi i MSA-së

Kapitulli II i Titullit III (dhe anekset përkatëse) për lëvizjen e lirë të produkteve bujqësore. Gjithashtu, Neni 95 ka të bëjë me kooperimin në çështjet bujqësore.

Turizmi

Sfidat

Për vitin 2007 numri total i vizitorëve deri në muajin nëntor arriti në 2,1 milionë, përfshirë këtu edhe emigrantët jo rezidentë në Shqipëri, sipas përcaktimeve nga Organizata Botërore e Turizmit, duke u klasifikuar kështu si periudha më e suksesshme gjatë dhjetë viteve të fundit. Numri i vizitorëve të huaj arriti në 1,1 milionë. Viti 2007, krahasuar me vitin 2006 shënoi një rritje prej 19% për vizitorët e huaj, me rritjen më të madhe në muajt janar 31%, mars 30%, qershor 27% , tetor 31%, duke treguar për një prirje shtrirjeje të sezonit turistik përgjatë gjithë vitit.

Ka një periudhë më se 7-vjeçare që sektori i turizmit luan një rol shumë të rëndësishëm në eksportet e vendit, duke përfaqësuar mesatarisht 77% të tyre. Të ardhurat nga turizmi kanë treguar përparim të dukshëm në rritje. Në bazë të anketave tremujore të kryera në pikat kufitare numri total i vizitorëve është rritur më shumë se dy herë nga viti 2000 deri në vitin 2005 dhe ka një rritje prej 23% për vitin 2006, në krahasim me vitin 2005. Sipas Bankës së Shqipërisë, shpenzimet mesatare ditore të vizitorëve janë rritur. Të ardhurat gjithsej nga turizmi për vitin 2006 llogariten në €805 milionë, ndërsa për vitin 2007 ato llogariten të jenë rreth €1 miliard. Rreth 60% e vizitorëve të huaj që vijnë në Shqipëri janë vizitorë apo turistë nga Kosova dhe Maqedonia.

Një nga arritjet në fushën e turizmit shqiptar ishte edhe miratimi i ligjit të ri "Për turizmin" në maj të vitit 2007. Kuadri i ri ligjor ka për qëllim krijimin e një sektori me standarde ndërkombëtare dhe për të ndihmuar konkretisht zhvillimin e industrisë turistike në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit. Gjatë viteve 2006-2007, qeveria ka alokuar fonde për investime në sinjalistikë turistike dhe zyrat e informacionit turistik në disa qytete të vendit, duke realizuar kështu dy nga objektivat strategjike me përparësi për zhvillimin e turizmit në Shqipëri.

Vendi ofron potenciale për dhjetëra aktivitete të ndryshme turizmi në dhjetëra destinacione. Është kombinimi i saktë i aktiviteteve dhe destinacioneve brenda vendit ai që ofron mundësitë më të mira për ndërtimin e një sektori të suksesshëm turizmi. Ajo çka e bën unike Shqipërinë është larmia e madhe e anëve tërheqëse dhe afërsia relative e këtyre atraksioneve në një kontekst unik kulturor. Për herë të parë në fushatat promovionale të turizmit në Shqipëri, gjatë vitit 2008, do të shfaqet një spot publicitar në rrjetin e njohur televiziv CNN. Është një nga sfidat e vitit që synon të konsolidojë pozicionin e Shqipërisë në tregun turistik europian dhe më gjerë.

Me gjithë potencialin e madh, zhvillimi i sektorit të turizmit kushtëzohet nga infrastruktura e dobët në disa zona turistike, mungesa e sistemeve eficiente të trajtimit të mbetjeve të ngurta, mungesa e një kontrolli të rreptë për zhvillimet ndërtimore informale nga pushteti vendor, financimet jo të mjaftueshme për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e zonave me interes natyror dhe kulturor, burimet njerëzore të patrajnuara si në sektorin publik, ashtu dhe atë privat, të drejta të paqarta mbi pronat dhe moszbatimi i kuadrit ligjor në tërësi dhe akteve normative për ndërtimet në veçanti, mungesa e bashkëpunimit mes sektorit privat e publik dhe e një shoqate ombrelë të vetë sektorit privat.

Vizioni i sektorit

Vizioni i strategjisë së turizmit për Shqipërinë është që ajo të njihet si një destinacion turistik i sigurtë, me vlerë të lartë, që karakterizohet nga një larmi e pasqorë e bukuri natyrore dhe kulturore e klasit botëror, në një sipërfaqe të vogël gjeografike, e menaxhuar në mënyrë të përgjegjshme mjedisore dhe sociale, lehtësisht e mbërritshme nga tregjet turistike europiane.

Përparësitë strategjike dhe politikat

Produktet e specializuara të turizmit duhet të zhvillohen nën një ombrelë të përgjithshme, ku të integrohen llojet e mëposhtme të turizmit, duke u përpjekur për një balancë gjeografike në shpërndarjen e aktiviteteve turistike në të gjithë vendin:

- Turizmi i diellit dhe plazhit, në periudhën afatgjatë
- Turizmi i interesave të veçantë (siç janë ekoturizmi, turizmi rural, turizmi natyror, aventurier, turizmi kulturor dhe turizmi malor), në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme
- Turizmi për biznes dhe konferenca, në periudhën afat-shkurtër dhe afatmesme

Vihet re se dy vitet e fundit turizmi i interesave të veçantë është në rritje me 15-20% dhe përfaqëson rreth 25% të tregut, ndërsa turizmi i diellit dhe plazhit përbën ende segmentin më të madh të turizmit ndërkombëtar, me një rritje prej 2-4% në vit.

Përparësitë strategjike të këtij sektori janë:

- **Ndërgjegjësimi dhe marketimi** në Shqipëri do të arrihet duke punuar në shumë nivele për zhvillimin e turizmit vendas, për konsolidimin dhe unifikimin e produkteve të turizmit të vendit me ato ndërkombëtare, për krijimin e një imazhi bindës për drejtuesit e opinionit të tregut për vlerat e vendit nëpërmjet kompanive të specializuara të udhëtimit, kompanive lokale të turizmit dhe internetit, pjesëmarrjes intensive në panairët ndërkombëtarë të turizmit, si dhe duke ftuar mediat e huaja të vizitojnë Shqipërinë.
- **Zhvillimi dhe diversifikimi i produktit turistik** do të përqendrohet në zbulimin e Shqipërisë nëpërmjet natyrës dhe kulturës së saj. Kjo do të realizohet dhe varet nga aftësia e zonave lokale për t'u organizuar në mënyrë efektive për t'i shndërruar vlerat e tyre natyrore dhe kulturore në produkte frutdhënëse turistike, të kompletuara me vendet dhe aktivitetet e rekomanduara, me informimin dhe përkthimin, bujtjen, ushqimin, shërbimin e guidave dhe me një larmi të karakteristikave të tjera që përcaktojnë vlerën e një destinacioni. Hartimi i itinerareve të reja turistike në zona rurale të Shqipërisë, të pasura me burime natyrore e kulturore, do të diversifikojë produktin e ofruar.
- **Investimet në zonat natyrore dhe në kulturë** do të arrihen veçanërisht nëpërmjet krijimit të mekanizmave financiarë afatgjatë dhe zhvillimit e miratimit të planeve të turizmit, të cilat inkurajojnë investitorët duke u dhënë drejtimit kryesorë të zhvillimit dhe duke zbatuar një politikë stimuluese për investimet potenciale në turizëm.
- **Menaxhimi i burimeve njerëzore**, duke përfshirë krijimin e një elite udhërrëfyesish turistike (guidat), trajnimin e menaxherëve të vendeve turistike, trajnimin e profesionistëve dhe personelit të mikpritjes, dhe ngritjen e aftësive gjuhësore, ndërsa këto do të mundësohen nëpërmjet pasurimit të programeve mësimore me lëndë profesionale për turizmin, sidomos në arsimin e lartë.
- **Klima e biznesit**: Sektorët e biznesit rriten në mënyrë më të suksesshme me një kuadër rregullator që është i qartë dhe siguron që të gjithë aktorët luajnë me të njëjtat rregulla. Kjo do të arrihet nëpërmjet një partneriteti të ngushtë me sektorin publik, me kalibrimin e standardeve ndërkombëtare të turizmit dhe hartimin e platformave të përbashkëta për zhvillimin e turizmit.

- **Menaxhimi i të dhënave dhe të informacionit** është thelbësor për planifikimin e turizmit, marketingun dhe monitorimin. Për këtë do të ndihmojnë Zyrat e Informacionit Turistik në rrethe, si dhe do të krijohet një zyrë për grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave.
- **Planifikimi territorial** do të mbështetë gjerësisht zhvillimin e turizmit me anën e planeve rregulluese, me studimet urbanistike, si dhe me investime infrastrukturore të tilla si në portet ose në menaxhimin e mbetjeve. Kjo qasje ka filluar të zbatohet përmes projektit të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare të jugut të Shqipërisë, si dhe miratimit të ligjit "Për planifikimin e territorit".

Strategjia e zhvillimit të turizmit synon që në vitin 2013:

- Numri i vizitorëve gjithsej të arrijë në 3,5 milionë
- Vizitorët me kombësi dhe shtetësi jo shqiptare si pjesë e totalit të vizitorëve të jenë 60%
- Të ardhurat bruto nga turizmi të arrijnë në €2,5 miliardë
- Rritja e të ardhurave mesatare nga çdo vizitor krahasuar me vitin 2006 të jetë 35-40%

Zbatimi i MSA-së

Neni 94 trajton çështje të bashkëpunimit në turizëm.

Kultura

Sfidat

Kultura është një ndër fushat që do të ndikojë fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit, si dhe për riafirmimin e identitetit kulturor shqiptar në rajon dhe si pjesë përbërëse të identitetit kulturor evropian. Në veçanti, trashëgimia kulturore është pjesa më e rëndësishme e artit, kulturës dhe traditave shqiptare. Në të dy format e saj, materiale dhe shpirtërore, provon edhe faktin se ky identitet i përket trashëgimisë europiane.

Vizioni i sektorit

Vizioni për kulturën është rritja e standardeve të menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe përafrimi i tyre me standardet e vendeve europiane, duke u mbështetur në politikën komunitare "të bashkuar në diversitet".

Përparësitë strategjike dhe politikat

Përparësitë strategjike në fushën e kulturës janë si më poshtë:

- **Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptarë.** Kjo nënkupton:
 - krijimin e një klime mbështetëse për krijuesit shqiptarë; zgjerimin e industrive krijuese dhe krijimin e lehtësive fiskale për produktet kulturore; rritjen e cilësisë estetike dhe profesionale të produkteve artistike dhe përmirësimin e statusit shoqëror e të gjendjes së krijuesve
 - krijimin e mundësive dhe e lehtësirave për promovimin e vlerave më përfaqësuese të kulturës shqiptare në vendet europiane e më gjerë nëpërmjet: botimit të veprave letrare të emrave të njohur të letërsisë së traditës dhe asaj bashkëkohore në gjuhë dhe në kultura të ndryshme
 - organizimin e simpoziumeve ndërkombëtare në funksion të krijimit të dialogut ndërkulturor
 - pjesëmarrjen e shkrimtarëve, botuesve, artistëve, producentëve të artit, kulturës dhe kinematografisë në edicione të festivaleve ndërkombëtare, ekspozitave dhe panairove ku të prezantohen pjesa më e arrirë e artit bashkëkohor shqiptar
- **Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe promovimi i turizmit kulturor:** mbrojtja, katalogimi dhe paraqitja e vlerave kulturore të Shqipërisë duke vënë theksin në diversitetin kulturor; krijimi i lehtësive për publikun që të njohë e shfrytëzojë pasuritë kulturore të Shqipërisë; ndërtimi i një sistemi menaxhimi modern të trashëgimisë kulturore; përfshirja e restaurimit dhe konservimit të monumenteve në planet urbanistike e mjedisore; hartimi i një pakete me lehtësira fiskale për personat fizikë apo juridikë, të cilët investojnë në trashëgiminë kulturore; rehabilitimi i qendrave

e qyteteve muze dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturave, duke pasur si qëllim shndërrimin e tyre në qendra të hapura ndaj vizitorëve vendas dhe të huaj; forcimi i rolit të institucioneve të ruajtjes së kujtesës (bibliotekave, arkivave, muzeve etj); krijimi i bazës së të dhënave me pasuritë që këto institucione zotërojnë, digjitalizimi i tyre dhe publikimi nëpërmjet botimeve të posaçme dhe 'online'; si dhe përfshirja në programe specifike të këtyre institucioneve, me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me institucionet e ruajtjes së kujtesës të vendeve të rajonit, Europës e më gjerë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet respektive.

- **Rritja e rolit të kulturës në jetën shoqërore dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës**, që përfshin pjesëmarrjen e gjerë të publikut në jetën kulturore; ndërhyrje në sistemin arsimor dhe rritjen e vetëdijes së publikut për dobinë e produkteve kulturore në përmirësimin e jetës së tyre
- **Integrimi i kulturës shqiptare në kulturën europiane dhe atë botërore**. Kjo kërkon në radhë të parë nxitjen e marrëdhënieve ndërkombëtare për rritjen e nivelit të njohjes dhe përhapjes së kulturës shqiptare, si një prej faktorëve më të rëndësishëm të identitetit, komunikimit dhe integritetit europian. Bashkëpunimi i ndërsjellë me strukturat homologe të vendeve të rajonit e më gjerë është një përparësi kyç. Në veçanti, këtu përfshihet edhe bashkërendimi i politikave dhe i veprimtarive kulturore me institucionet e kulturës në Kosovë dhe vendet e rajonit. Duke patur parasysh objektivat e BE në fushën e kulturës, Shqipëria është e angazhuar për të përmbushur tri qëllime strategjike në fushën e integritetit të kulturës: forcimi i vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut, forcimi i besimit dhe respektit reciprok, dhe promovimi i ndërgjegjes së komunitetit kulturor europian dhe të diversitetit të tij.
- **Mbrojtja e pronësisë intelektuale nëpërmjet, midis të tjerave, forcimit dhe konsolidimit të Zyrës të së Drejtës së Autorit**

Zbatimi i MSA-së

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjëse për zbatimin e Nenit 73 për të drejtat e pronësisë intelektuale, Nenit 101 për bashkëpunimin kulturor dhe Neni 102 për bashkëpunimin në fushën audio-vizuale.

4. Perspektiva makroekonomike dhe fiskale

Zhvillimet në ekonominë shqiptare tregojnë se ajo po ecën brenda kuadrit të përcaktuar në programin e zhvillimit afatmesëm të vendit. Në përgjithësi, ka patur një ecuri të kënaqshme në drejtim të konfirmimit të ritmit të programuar të rritjes ekonomike, të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik dhe të vazhdimin të reformave strukturore në ekonomi. Analiza makroekonomike është bazuar në një kuadër makroekonomik që garanton një lidhje logjike midis treguesve kryesorë makroekonomikë, historikë dhe atyre të parashikuar. Analiza shpjegon politikat makroekonomike, si për taksapaguesit shqiptarë ashtu dhe për komunitetin ndërkombëtar. Megjithatë, duhet theksuar që kryerja e analizave makroekonomike në vendin tonë kushtëzohet nga mungesa e statistikave të plota ekonomike.

Rritja ekonomike

Përvoja e vendeve të tjera të ngjashme me Shqipërinë, tregon se pak vende kanë patur një normë të rritjes ekonomike relativisht të lartë, prej rreth 6%, dhe njëkohësisht të qëndrueshme për më shumë se 5 vjet. Gjithashtu, zbatimi i politikave të përmendura në kapitujt e mëparshëm do të bëjë të mundur që ekonomia shqiptare të këtë normë rritjeje edhe më të lartë se vitet e fundit për periudhën e ardhshme afatmesme. Reformat e ndërmarra nga Qeveria demonstrojnë qartë orientimin e rritjes ekonomike drejt filozofisë së ofertës në ekonomi. Në këtë kontekst, në termat afatgjatë krahas përparimit teknologjik dhe reformës strukturore, burim i rritjes së qëndrueshme pritet të jetë edhe akumulimi i kapitalit. Karakteristikat e faktorëve kryesorë me ndikim pozitiv në rritjen ekonomike janë si më poshtë:

- Besimi i biznesit po rritet vazhdimisht si rezultat i stabilitetit makroekonomik dhe i progresit drejt integritetit në BE. Qeveria po bën hapa përpara në heqjen e barrierave institucionale, në sistemin rregullator të biznesit dhe në atë fiskal, çka bën të mundur rritjen e investimeve dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë kyç.
- Investimet publike janë rritur në vitet e fundit, dhe do të vazhdojnë të ndjekin një prirje rritëse në vitet e ardhshme, duke ndikuar sidomos në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shërbimeve, arsimit dhe shëndetësisë, si edhe të furnizimit me energji elektrike. Edhe investimet private kanë arritur nivele të larta vitet e fundit, duke u përqendruar në ndërtim, kryesisht për procesin e prodhimit, sektorin e shërbimeve dhe për banim.
- Është rritur cilësia e menaxhimit dhe eficensa e shpenzimeve publike me qëllim që sektori publik të mbështesë aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe të realizohet një lidhje më e fortë ndërmjet investimeve publike dhe atyre private me politikat prioritare.
- Rritja e investimeve për makineri, pajisje, trajnime, si edhe politikat mbështetëse fiskale për nxitjen e investimeve dhe zhvillimin teknologjik do të rrisin produktivitetin e fuqisë punëtore.
- Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë shqiptare bazuar në: zbatimin e një sërë politikash mbështetëse për sektorë të ndryshëm, siç është ai i bujqësisë dhe energjisë; në shfrytëzimin gjithnjë e më tepër të avantazheve krahasuese në përputhje me kapacitetet potenciale që ofron ekonomia vendase, do të rrisë gradualisht vëllimin e eksporteve dhe do të pakësojë në mënyrë konstante rritjen e importeve si rrjedhim i liberalizmit tregtar.
- Privatizimi i sektorëve strategjikë, si ai i shpërndarjes së energjisë elektrike, telekomunikacionit, nxjerrjes dhe përpunimit të naftës etj., do të ndihmojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e eficensës prodhuese.
- Rritja, përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit financiar, bankar e jo-bankar, bazuar në: një sistemin financiar shqiptar me likuiditet të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për biznesin; përmirësimin e aksesit në të drejtat e pronësisë; përmirësimin e marrëdhënieve të institucioneve financiare me një gamë më të gjerë klientësh që çon në një rritje të transaksioneve; rritjen e shpejtë të nivelit të kreditimit privat, nga sektori bankar ashtu edhe nga institucionet financiare

jo-bankare, si ato mikrofinanciare, shoqëritë e kursim-kredisë, apo futja e shërbimeve të lizingut, për të arritur nivelet e standardeve ndërkombëtare.

- Rritja e masave të mbikëqyrjes së cilësisë së huadhënies nga sistemi bankar e jo-bankar dhe vazhdimi i procesit të rritjes së shkallës së ndërmjetësimit financiar nëpërmjet: (i) përmirësimit të cilësisë së sistemit të pagesave; (ii) mbajtjes së normave reale pozitive të interesit; (iii) përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredive nga tregu bankar e jo-bankar; dhe (iv) rritjes së shkallës së qarkullimit të mjeteve monetare nëpërmjet sistemit bankar.

Duke patur parasysh faktorët e mësipërm pritet që norma e rritjes të arrijë në 7% në vit (Tabela 4.1).

Tabela 4.1 Parashikimet e rritjes ekonomike

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Rritja reale e PBB-së (%)	5,5	6,0	6,0	6,5	7,0	7,0	7,0	7,0
Investimet totale (% e PBB-së)	25,1	26,5	26,9	27,8	28,7	28,8	29,0	29,6

Burimi: Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe INSTAT (për vitin 2006)

Bilanci i pagesave

Perspektivat e bilancit të pagesave pritet të jenë pozitive, me flukse të mëdha hyrëse të transfertave dhe kapitalit, të cilat do të jenë të mjaftueshme për të financuar deficitin tregtar. Gjithashtu, niveli i rritjes së eksporteve pritet të jetë më i lartë se ai i importeve.

Transfertat private nga jashtë janë zgjeruar në mënyrë konstante gjatë pesë viteve të fundit, duke reflektuar rritjen e aktivitetit të punës së shqiptarëve në vendet e Bashkimit Europian dhe në vendet e tjera. Kjo prirje do të vazhdojë pasi zbatimi, në kuadrin e integritit europian, i një vargu masash do të lehtësojë dhe formalizojë lëvizjen e njerëzve. Kjo mund të ndihmojë edhe për ndryshimin e natyrës së aktiviteteve të shqiptarëve jashtë Shqipërisë, nga punonjës të huaj në biznesmenë me lidhje tregtare me Shqipërinë dhe me më shumë investime formale në Shqipëri.

Megjithëse grantet janë pakësuar gjatë viteve të fundit, mund të pritet një rritje e tyre me afrimin e anëtarësimit në BE. Huatë zyrtare kanë rënë dhe shlyerjet janë rritur dhe priten të jenë më të larta në të ardhmen. Si pasojë e konsolidimit gjithnjë e më tepër të stabilitetit politik-ekonomik si dhe e një vargu politikash nxitëse që po ndërmerren, fluksi i investimeve të huaja direkte do të jetë gjithnjë në rritje.

Pas vitit 2010, bilanci i pagesave pritet të përmirësohet. Eksportet, të cilat do të përfitojnë nga investimet private, kostoja e ulët e fuqisë punëtore, rritja e produktivitetit të fuqisë punëtore dhe thellimi i lidhjeve tregtare e zgjerimi i përdorimit të shërbimeve financiare do të kenë rritje të vazhdueshme dhe deficitin tregtar do të ngushtohet.

Tabela 4.2 Parashikimet e bilancit të pagesave

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Norma e këmbimit valutor (Lek/€)	123	122	122	122	122	122	122	122
Bilanci tregtar (milion €)	-1685	-1888	-1965	-2062	-2167	-2227	-2309	-2387
Remitencat (milion €)	966	1,059	1,133	1,212	1,300	1,394	1,494	1,602
Bilanci i përgjithshëm (milion €)	207	129	115	96	148	178	229	279

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sektori monetar

Politika afatmesme e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, për normën e synuar të inflacionit do të mundësojë mbajtjen nën kontroll të këtij treguesi. Objektivi i politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë konsiston në mbajtjen e inflacionit në nivelin 3 për qind me mundësi luhatjeje ± 1 pikë përqindjeje, gjë që do të mundësohet edhe nga ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe e ritmeve të rritjes ekonomike.

Tabela 4.3 Parashikimet e sektorit monetar

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Inflacioni (%)	2,4	2,9	3,0	3,0	3,0	3,0	3,0	3,0
Kredia për sektorin privat (% e PBB-së)	21,2	27,9	34,1	40,0	44,9	48,4	51,3	52,0
Oferta monetare (% e PBB-së)	74,1	78,9	83,3	87,3	90,6	92,4	93,9	94,1

Burimi: Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe INSTAT (për inflacionin e viteve 2006 dhe 2007)

Sasia e parasë jashtë sistemit bankar do të bjerë, por kjo do të kompensohet nga një rritje e depozitave private në banka, duke çuar në një rritje të ofertës monetare, e shprehur si përqindje e PBB-së, nga 74,1% në vitin 2006 në 94,1% në vitin 2013.

Me gjithë gjendjen e qëndrueshme të aktiveve të jashtme neto dhe të huamarrjes së qeverisë, rritja e ofertës monetare do të çojë në një zgjerim të mëtejshëm të kredisë për sektorin privat, e cila do të arrijë 44,9% në vitin 2010. Kjo është pasojë e rritjes së vullshme të aftësisë huamarrëse të ndërmarrjeve, e shoqëruar nga nivele të larta të investimeve private dhe përmirësime në legjislacionin e aktiveve. Përmirësimet në mbikëqyrjen e bankave dhe rritja e besimit të bankat e huamarrësit do të sigurojnë që shërbimet financiare të shtrihen në një gamë më të gjerë klientësh, përfshirë këtu ndërmarrjet e vogla, por pa dobësuar cilësinë e alokimit të kredisë. Pas vitit 2010, pritjet që kredia për sektorin privat të vazhdojë të rritet, ndonëse me një ritëm më të ngadaltë. Kjo pasqyron pritshmërinë e stabilizimit të raportit të ofertës monetare mbi PBB-në, duke qenë se paraja jashtë bankave dhe depozitat private do të arrijnë nivele normale. Ndërkohë, rritja më e ngadaltë e kredive private do të mundësohet nëpërmjet limiteve në huamarrjen qeveritare për të arritur objektivat për borxhin publik.

Financat publike

Në këtë pjesë paraqiten parashikimet e financave publike të cilat përmbledh Tabela 4.4 dhe janë shpjeguar si më poshtë:

Parashikimet e të ardhurave

Të ardhurat e buxhetit të shtetit janë parashikuar duke u bazuar në kuadrin makroekonomik të paraqitur më sipër, si edhe duke konsideruar:

Të ardhurat nga TVSH. Gjatë viteve të ardhshme norma e TVSH-së do të jetë 20%. Parashikimi i të ardhurave nga TVSH-ja është bazuar në normën e rritjes ekonomike dhe normën e inflacionit. Si rrjedhojë, mbështetur në këta tregues, si edhe të përmirësimit administrativ dhe të përmirësimit të strukturës së PBB-së, në dobi të sektorëve që paguajnë TVSH, baza e tatueshme e TVSH-së do të rritet. Në këtë kontekst, mund të përmendet rritja e konsiderueshme e nivelit të investimeve publike gjatë vitit 2008, e cila do të sjellë efekte pozitive në të ardhurat nga TVSH-ja.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin. Duke filluar nga 1 janari 2008, norma e tatim-fitimit do të përgjysmohet, nga 20% që është aktualisht në masën 10%. Megjithëse përgjysmimi i normës së tatimit mbi fitimin do të ketë ndikim negativ në buxhetin e shtetit, kjo masë fiskale parashikohet të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit, pasi do të rritet baza e taksueshme, biznesi vendas do të inkurajohet të deklarojë shifra reale të balanceve kontabël, dhe klima do të jetë më tërheqëse për investimet, veçanërisht investimet e huaja direkte dhe indirekte. Parashikimi i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin për tre vitet në vazhdim është mbështetur në rritjen e bazës tatimore (fitimi total i biznesit) si pasojë e rritjes së ekonomisë dhe përmirësimit administrativ e strukturor (rritja e PBB orientohet nga sektorët që paguajnë tatim fitimi).

Tabela 4.4 Parashikimet e financave publike

	Si përqindje e PBB-së (%)						Në miliardë lekë		
	2006	2007	2008	2009	2010	2013	2007	2010	2013
Të ardhurat									
Nga tatimet dhe dogana	17,2	18,3	18,2	18,5	18,7	19,1	180	241	329
Pushteti vendor	1,2	1,4	1,5	1,6	1,6	1,7	13	21	29
Sigurimet shoqërore	4,4	4,4	4,8	5,1	5,3	5,3	43	68	91
Jotatimore	1,8	2,5	1,5	1,5	1,5	1,4	24	19	24
Grantet	0,9	0,4	0,4	0,4	0,5	0,5	4	6	9
Gjithsej	25,5	26,9	26,4	27,1	27,6	28,0	264	356	482
Shpenzimet									
Paga	6,3	6,3	6,4	6,3	6,3	6,2	62	81	107
Operative dhe mirëmbajtje	2,5	2,5	2,6	2,7	2,9	3,1	25	37	53
Interesa	2,8	2,9	3,1	3,1	3,0	2,9	28	39	50
Subvencione	0,4	0,8	0,2	0,2	0,2	0,2	8	3	3
Sociale	8,2	8,7	8,5	8,5	8,5	8,5	85	110	146
Të tjera	2,5	3,1	3,8	3,8	3,9	4,0	31	50	69
Kapitale	5,7	7,1	9,8	6,4	6,4	6,1	70	83	105
Gjithsej	28,8	31,5	34,3	31,0	31,2	31,0	309	403	534
Bilanci	-3,3	-4,6	-7,9	-3,9	-3,6	-3,0	-45	-46	-52
Financimi									
Privatizimi	0,2	1,5	0,4	0,1	0,1	0,1	15	1	2
Huamarrja e brendshme	2,3	1,8	2,4	2,3	2,3	2,0	17	30	34
Huamarrja e jashtme neto	0,6	1,3	5,2	1,5	1,2	0,9	13	15	16

Burimi: Të dhënat aktuale për vitin 2006; vlerësime dhe parashikime nga Ministria e Financave për vitet 2007-2013

Të ardhurat nga akciza. Parashikimi i të ardhurave nga akciza është mbështetur në ndryshimet e akcizës për disa mallra, të miratuar gjatë vitit 2007, duke e përafëruar me nivelin e akcizave të vendeve të rajonit. Rritja e të ardhurave nga akciza do të jetë rrjedhim edhe i rritjes së importeve të zhdoganuara, prodhimit vendas të këtyre mallrave, si dhe i rritjes së përmirësimit të administrimit doganor.

Tatimi mbi të ardhurat personale. Duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2007, është vendosur taksa e sheshtë në masën 10% për tatimin mbi të ardhurat personale. Zbatimi i taksës së sheshtë në masë të zvogëluar gjykohet të japë ndikim pozitiv, veçanërisht në kategorinë e të punësuarve me të ardhura të larta, kryesisht në sektorin privat, kategori e cila pas zbatimit të kësaj masë fiskale mendohet se do të jetë plotësisht e motivuar për të deklaruar të ardhurat reale. Me këtë masë, hiqet tatimi progresiv dhe thjeshtohen edhe procedurat e deklarimit dhe llogaritjes së këtij tatimi. Parashikimi i të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale do të ruajë tendencë rritëse, dhe merr parasysh si rritjen e numrit të punonjësve të deklaruar, ashtu edhe rritjen e pagave.

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera. Parashikimi i të ardhurave nga taksat nacionale është bazuar në tendencën historike të këtyre të ardhurave. Në parashikimin e të ardhurave nga taksat nacionale është marrë parasysh edhe rritja e taksës së importimit të automjeteve të përdorura, si edhe ndryshime të tjera në taksat nacionale, të hyra në fuqi gjatë vitit 2007, që janë ulja e taksës portuale dhe e taksës për ditë qëndrimi të automjeteve të huaja.

Të ardhurat nga taksat doganore. Parashikimi i të ardhurave nga taksat doganore bazohet në përmirësimin e administrimit dhe të vlerësimit doganor, si edhe në efektet negative mbi të ardhurat të pakësimit të tarifave doganore, për shkak të OBT, MTL me Turqinë, dhe MSA. Është ulur në zero taksa doganore për automjetet e reja si dhe automjetet e përdorura, për të cilat zbatohet taksa e importimit të automjeteve të përdorura (taksë e mjedisit). Prirja e të ardhurave nga taksa doganore është drejt rënies, si pasojë e pakësimit të normës së tarifave doganore.

Të ardhurat nga pushteti vendor. Parashikimi i të ardhurave është mbështetur në rritjen e bazës tatimore si pasojë e rritjes ekonomike dhe e tendencës historike të të ardhurave nga pushteti vendor. Ndikim pozitiv në të ardhura do të ketë dhe rritja e taksës vendore mbi ndërtesat në pronësi ose përdorim në territoret e fshatrave turistike, të hyra në fuqi gjatë vitit 2007, si edhe ndryshimet dhe përmirësimet fiskale që do të ndërmerren në kuadër të decentralizimit fiskal, duke kaluar disa taksa kombëtare në taksë vendore, si taksa mbi pasuritë e paluajtshme, taksa e rentës minerare, kalimi i shumë prej tyre në tarifa shërbimi, si edhe rishikimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja.

Të ardhurat nga kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Rritja e parashikuar e të ardhurave nga kontributet do të jetë rrjedhojë e rritjes ekonomike, formalizimit të tregut të punës ndërmjet përmirësimit të regjistrimit me anë të pajisjes me kartë identiteti, si edhe e heqjes graduale të raportit midis normës së kontributeve që paguan punëdhënësi dhe asaj që paguan punëmarrësi, për të arritur në nivelin e vendeve të tjera. Gjithashtu, këto të ardhura do të jenë subjekt ndryshimi për shkak të ndryshimit dhe reformimit të skemës ekzistuese të pensioneve.

Të ardhurat jotatimore. Parashikimi i të ardhurave jotatimore është bazuar në supozimin që transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë për tre vitet e ardhshme do të jetë konstant. Të ardhurat nga institucionet buxhetore do të rriten, duke pasqyruar si rritjen e inflacionit, ashtu edhe rritjen e shërbimeve ndaj publikut, ndërsa të ardhurat nga dividendi do të jenë përsëri objekt rishikimi për shkak të procesit të privatizimit të aksioneve të Qeverisë në ndërmarrjet publike.

Të ardhurat nga ndihmat dhe grantet. Parashikimi i të ardhurave nga ndihmat dhe grantet është bazuar në PBA 2008-2010, si dhe në parashikimet e pritshme të granteve nga BE.

Të ardhurat nga privatizimi. Të ardhurat nga privatizimi janë parashikuar në nivele modeste, pasi nuk është përfshirë privatizimi i sektorëve strategjikë. Të ardhurat nga privatizimet strategjike do të bëhen pjesë e buxhetit kur të realizohen dhe do të përdoren për shpenzime kapitale dhe uljen e borxhit publik.

Huamarrja e brendshme. Niveli i huamarrjes së brendshme parashikohet të arrijë në rreth 2% të PBB, mbështetur në objektivat për një nivel të përgjithshëm të deficitit buxhetor prej 3% të PBB në vitin 2013.

Huamarrja e huaj. Niveli i huamarrjes së huaj është parashikuar në bazë të marrëveshjeve dhe kontratave të lidhura me institucionet financiare ndërkombëtare dhe qeveritë e huaja, si dhe atyre të parashikuara për të ardhmen.

Parashikimet e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Shpenzimet buxhetore parashikohen që gjatë tre viteve të ardhshme të qëndrojnë në intervalin 30-32% të PBB, ku përjashtim bën viti 2008 që ndikohet nga rritja e financimit të huaj për rrugën Durrës-Kukës-Morinë. Thëksojmë që në këtë vlerësim nuk përfshihet përdorimi i të ardhurave nga privatizimet strategjike.

Shpenzimet për personelin. Shpenzimet për personelin e administratës publike do të qëndrojnë konstante në vitet në vijim në raport me PBB, që do të thotë një indeksim i plotë me nivelin e inflacionit dhe rritje reale e diferencuar për sektorë prioritarë, në përputhje me objektivat e reformës në administratën publike.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes parashikohet të rriten në terma realë për tre vitet e ardhshme. Kjo rritje do të orientohet kryesisht në shpenzimet e mirëmbajtjes, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të investimeve gjatë këtyre viteve. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet operative të parashikuara për administratën do të vijnë duke u ulur në raport me PBB, duke krijuar mundësinë për rritje më të shpejtë të shpenzimeve për mirëmbajtjen në sektorët prioritarë, si infrastrukturë, arsim e shëndetësi, por edhe të shpenzimeve për politika specifike sektoriale siç janë ato të mbështetjes në bujqësi, nxitjes së eksporteve, mjedisit etj.

Shpenzimet për interesat. Parashikimi i shpenzimeve për interesa është bazuar në strategjinë e financave publike. Borxhi publik në përqindje të PBB do të bjerë. Megjithatë, për parashikimet afatgjata ka një rregull shtesë, i cili e kufizon rritjen e borxhit publik me 4% në vit. Kjo siguron që borxhi publik të mos rritet kur kemi një rritje ekonomike të konsiderueshme. Në të ardhmen ky rregull synon t'i mundësojë borxhit qeveritar të reagojë sipas ciklit të biznesit, duke lejuar huamarrje

paksa më të lartë gjatë viteve me rritje të ulët. Mbi një e dyta e deficitit financohet nga huamarrja e brendshme, shpesh me kushte disi të dobëta.

Shpenzimet për subvencione. Shpenzimet për subvencione janë parashikuar duke u bazuar në politikat ekzistuese të subvencioneve, si dhe në politikën buxhetore për pakësimin e tyre në vazhdimësi.

Tabela 4.5 Supozimet për kostimin e politikave kryesore të SKZHI-së

Mbrojtja	Zotimi për të alokuar 2% të PBB-së për mbrojtjen si pasojë e respektimit të zotimeve për anëtarësimin në NATO. Raporti aktual midis shpenzimeve të përvitshme dhe kapitale vazhdon të jetë i njëjtë.
Drejhtësia	Shifrat për drejtësinë përfshijnë edhe institucionet e pavarura të mëposhtme: Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Shkolla e Magjistraturës dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
Çështjet e brendshme	Për policinë, pas vitit 2010, shtohen rreth 0,7 miliardë lekë për çdo vit, në nivelin e shpenzimeve korrente dhe rreth 1 miliardë lekë për çdo vit, në nivelin e shpenzimeve kapitale. Për gjendjen civile, niveli i shpenzimeve kapitale i vitit 2008 mbetet i njëjtë për tre vitet e mëposhtme.
Transporti	Në periudhën 2011-2013, niveli mesatar i shpenzimeve korrente për rrjetin kombëtar rrugor do të jetë 5 miliardë lekë; niveli mesatar i shpenzimeve kapitale për rrjetin kombëtar rrugor do të jetë 28 miliardë lekë dhe niveli mesatar i shpenzimeve kapitale për portet do të jetë 4 miliardë lekë. Kostot e rrugëve rurale nuk janë përfshirë.
Ujësjetës kanalizime	Në periudhën 2011-2013, niveli mesatar i shpenzimeve kapitale do të jetë 11 miliardë lekë. Niveli i subvencioneve për ndërmarrjet e ujësjetës-kanalizimeve do të ulët më 10% për çdo vit në terma realë pas vitit 2010.
Mjedisi	Në periudhën 2011-2013, është parashikuar që niveli i shpenzimeve kapitale do të rritet me 1,5 miliardë Lekë për aktivitetet e rehabilitimit të 'zonave të nxehta' ('hot spots') dhe për ndërtimin e vendgroposjeve të mbetjeve të rrezikshme.
Ekonomia	Shifrat për shpenzimet kapitale bazohen në strategjinë sektoriale (shtrirë gjatë një periudhë 15-vjeçare) dhe përfshijnë promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, promovimin e eksporteve, parqet industriale dhe promovimin e investimeve të huaja direkte.
Mbrojtja sociale	Në periudhën 2011-2013, niveli mesatar i shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe pagesat e personave me aftësi të kufizuara do të jetë 17,8 miliardë Lekë.
Sigurimet shoqërore	Niveli i subvencionit të skemës së sigurimeve shoqërore do të mbetet konstant në nivelin 1,5% të PBB-së deri në vitin 2013.
Shëndetësia	Pagat do të rriten në të njëjtin nivel me pagat e tjera të sektorit publik pas vitit 2010. Shpenzimet e tjera korrente dhe kapitale do të kenë një rritje prej 25% në terma realë pas vitit 2011.
Sigurimet shëndetësore	Niveli i subvencionit të skemës së sigurimeve shëndetësore do të mbetet konstant në terma realë deri në vitin 2013.
Arsimi	Pagat do të rriten në të njëjtin nivel me pagat e tjera të sektorit publik pas vitit 2010. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes do të arrijnë 14% të shpenzimeve korrente totale deri në vitin 2013. Shpenzimet kapitale do të jenë 15% e shpenzimeve totale për arsimin bazë deri në vitin 2013. Shpenzimet kapitale do të jenë 30% e shpenzimeve totale për arsimin e lartë deri në vitin 2013.
Bujqësia dhe zhvillimi rural	Komponenti për zhvillimin rural i Instrumentit të Para-Aderimit do të ofrojë mbështetje për zhvillimin rural. Duke u nisur nga shpenzimet mesatare për frymë në vendet që ishin kandidatë për anëtarësim, mbështetja do të fillojë në vitin 2010 dhe pritet që niveli i saj të jetë rreth €17 milionë në vit deri në vitin 2013.
Planifikimi hapësinor, zhvillimi rajonal dhe turizmi	Shifrat përfshijnë institucionet e mëposhtme: Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (programet e urbanistikës dhe shërbimeve publike); Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore; dhe Fondin e Zhvillimit Shqiptar. Supozohet që niveli mesatar i shpenzimeve kapitale për rrugët rurale në periudhën 2011-2013 do të jetë 14 miliardë Lekë.

Shpenzimet për transfertat. Shpenzimet për pagesë papunësie, ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, parashikohen të mbeten konstante në raport me PBB. Këtu do të mbahet parasysh politika për një rritje të diferencuar midis zërave përbërës të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet kapitale. Shpenzimet kapitale për tre vitet e ardhshme parashikohen mesatarisht në nivelet mbi 6% e PBB, kjo në varësi edhe të nivelit dhe ecurisë së disbursimeve të financimeve të huaja. Pas ritmeve të larta të investimeve në vitet 2007-2008, investimet do të stabilizohen në këto nivele, duke mundësuar që një pjesë e mirë e alokimeve buxhetore të fillojë të kalojë tek mirëmbajtja. Investimet do të vazhdojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si arsim, shëndetësi e infrastrukturë.

Parashikimet e shpenzimeve sipas klasifikimit funksional

Tabela 4.6 paraqet koston vjetore mesatare të sektorëve. Për vitet 2007-2010, kostoja është bazuar në buxhetin e vitit 2007 dhe PBA 2008-2010. Për vitet 2011-2013, kostoja është bazuar në strategjitë sektoriale, kur këto paraqesin një kostim domethënës, dhe në disa hipoteza shtesë të paraqitura në tabelën 4.5. Nëse nuk ka specifikim, është supozuar që niveli i shpenzimeve korrente dhe kapitale pas vitit 2010 mbetet në të njëjtin nivel me atë të vitit 2007, në terma realë.

Tabela 4.6 Kostimi indikativ i zbatimit të SKZHI-së

	2007-2010				2011-2013			
	Shpërndarjet sipas buxhetit/PBA-së				Kostimi indikativ i zbatimit të SKZHI-së			
	Korrente Lek mld	Kapitale Lek mld	Gjithsej Lek mld	Gjithsej %	Korrente Lek mld	Kapitale Lek mld	Gjithsej Lek mld	Gjithsej %
Integrimi								
Mbrojtja	16,3	5,8	22,1	9,6	23,4	8,1	31,5	9,6
Demokratizimi dhe shteti i së drejtës								
Drejhtësia	5,9	1,4	7,3	3,2	6,1	2,1	8,2	2,5
Çështjet e brendshme	13,1	1,7	14,7	6,4	14,9	3,4	18,2	5,6
Infrastruktura								
Transporti	2,9	43,2	46,1	20,1	5,8	37,6	43,4	13,3
Ujë dhe kanalizimet	0,9	7,5	8,5	3,7	0,9	15,1	16,0	4,9
Mjedisi	1,0	0,9	2,0	0,9	1,5	2,7	4,2	1,3
Tregjet								
Financa publike	3,8	0,4	4,2	1,8	4,2	1,2	5,5	1,7
Ekonomia	0,8	1,6	2,4	1,1	0,7	3,1	3,8	1,2
Politika sociale								
Punësimi dhe mbrojtja sociale	18,1	0,4	18,4	8,0	28,1	0,8	28,9	8,8
Sigurimet shoqërore	15,2		15,2	6,6	23,6		23,6	7,2
Shëndetësia	15,3	5,0	20,3	8,8	26,0	8,8	34,8	10,6
Sigurimet shëndetësore	6,0		6,0	2,6	6,6		6,6	2,0
Arsimi	32,2	7,9	40,2	17,5	48,0	10,8	58,8	18,0
Zhvillimi urban, rural, rajonal								
Bujqësia dhe zhvillimi rural	2,7	2,5	5,2	2,2	3,1	5,6	8,7	2,7
Planifikimi hapësinor, zhvillimi rajonal dhe turizmi	2,2	4,2	6,4	2,8	2,5	17,9	20,4	6,2
Të tjera	9,2	1,8	11,0	4,8	11,7	3,0	14,6	4,5
Gjithsej	145,6	84,4	230,0	100,0	207,1	120,1	327,1	100,0

Kostimi i SKZHI-së në tabelën 4.6 tregon se shpenzimet mesatare për periudhën 2011-2013 për të gjithë sektorët do të jenë 327 miliardë Lekë, në terma nominalë. Sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave në kuadër të SKZHI-së, shpenzimet publike mesatare (duke përfshirë interesat, shpenzime për buxhetin lokal dhe fondi rezervë) do të jetë 298 miliardë lekë, gjithashtu në terma nominalë. Kostimi i SKZHI-së tregon se kostoja e realizimit të politikave të SKZHI-së është 10% më e lartë ose 30 miliardë lekë më shumë se niveli i burimeve që mund të jenë të disponueshme. Shpenzimet shtesë përbëhen pothuajse kryesisht nga shpenzimet kapitale. Kjo diferencë mund të

justifikohet duke përmendur faktorë potencialë, që do të bëjnë të mundur pakësimin ose eliminimin e kësaj difference nëpërmjet rritjes ekonomike që mund të jetë më e madhe se parashikimi, një administrimi më efikas të të ardhurave tatimore përtej parashikimit, që do të vënë në dispozicion më shumë burime financiare, nëpërmjet privatizimeve strategjike që nuk janë përfshirë në parashikimet makroekonomike dhe fiskale për 2007-2013, zvogëlimin të disa prej kostove nëpërmjet aplikimit të metodës së partneritetit publik-privat, sidomos në sektorin e transportit, projekteve të financuara nga institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë e huaja, të paparashikuara dhe të paraportuara në buxhet për periudhën 2007-2013. Megjithatë synimi i vazhdueshëm i qeverisë është përmirësimi i kostimit të politikave të saj. Kostimi i mëtejshëm i përparësive të SKZHI-së do të jetë i nevojshëm gjatë procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm.

Kostimi i SKZHI për vitet 2011-2013 propozon një drejtim të përgjithshëm të shpërndarjes së të ardhurave të ndryshëm nga alokimet ekzistuese, gjë që do të ndihmojë në financimin e atyre përparësive që janë më të rëndësishme në procesin e anëtarësimit në BE. Pjesa e transportit në shpenzimet kapitale do të vazhdojë të jetë më e madhe deri në vitin 2010, ndërsa për periudhën 2011-2013 propozohet të jetë në rënie për shkak të përfundimit të pritshëm të projekteve madhore në rrjetin rrugor kombëtar. Në të njëjtën kohë, pjesa e zhvillimit rajonal në shpenzimet kapitale propozohet të rritet duke pasqyruar përshpejtimin e investimeve në rrjetin rrugor dytësor. Sektori i furnizimit me ujë do të zgjerohet në mënyrë që sektori të arrijë sa më shpejt standardet e BE. Sektorë të tjerë që propozohet të përfitojnë më shumë shpenzime kapitale janë zhvillimi rural dhe mjedisi, të cilat në vendet anëtare të BE zënë një pjesë të madhe të shpenzimeve, si dhe shëndetësia.

Figura 4.1 paraqet ndryshimet që kërkohen në nivelin e shpenzimeve korrente në krahasim me nivelin mesatar të parashikuar në periudhën 2007-2010 ndërkohë që Figura 4.2 paraqet ndryshimet përkatëse që kërkohen në nivelin e shpenzimeve kapitale.

Figura 4.1 Ndryshimet indikative në shpërndarjen e shpenzimeve korrente





Figura 4.2 Ndryshimet indikative në shpërndarjen e shpenzimeve kapitale



5. Llogaridhënia

Qeveria është e angazhuar për të rritur transparencën. Pjesëmarrja në formulimin e planeve strategjike do të bëjë të mundur që të ketë më shumë informacion gjatë zgjedhjeve të politikave. Llogaridhënia në lidhje me përdorimin e burimeve publike është një hap thelbësor në drejtim të demokratizimit dhe të përmirësimit të qeverisjes. Ky kapitull trajton procesin e gjerë të pjesëmarrjes gjatë përgatitjes së SKZHI-së. Gjithashtu kapitulli përshkruan se si do të monitorohet përparimi në zbatimin e SKZHI-së.

5.1 KONSULTIMI

Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale

Grupet Këshillimore

Mbasi strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale e kishin përvijuar thelbin e SKZHI, u hartua procesi i konsultimit në mënyrë që të nxiteshin ministritë e linjës të kërkonin në mënyrë aktive sugjerime nga palët e interesuara joqeveritare. U arrit të mendimi që përgjegjësia për procesin e konsultimit të ishte e ministrive të linjës, meqenëse përvojat e mëparshme kanë treguar se mbështetja tek asistenca teknike nuk ka sjellë rezultate të qëndrueshme.

Grupi Këshillimor përfaqëson palët e interesuara joqeveritare për çdo strategji. 10-15 anëtarët e këtyre grupeve përfaqësojnë, në varësi të strategjisë, pushtetin lokal, sindikatat, dhomat tregtare, akademikë dhe ekspertë të tjerë, organizata jo-qeveritare, shoqatat e qytetarëve, shoqata e biznesit dhe punëdhënësve. Anëtarësia në çdo grup dhe termat e referencës janë vendosur me vendim ministri. U sugjerua që ministritë t'i linin kohë të mjaftueshme procesit të këshillimit për të marrë komente. Grupet Këshillimore u nxitën t'ua jepnin ministrive me shkrim komentet e tyre të konsoliduara.

Në rastet kur një grup me funksione të njëjta ishte krijuar më parë, nuk është krijuar grup i ri. Raste të tilla janë Komisioni i Reformës Ligjore për strategjinë sektoriale të drejtësisë, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës për strategjinë sektoriale të arsimit të lartë, dhe Grupi i Ekspertëve për Decentralizimin për strategjinë ndërsektoriale të decentralizimit.

Ministritë u nxitën të vendosnin partneritete afatgjata, të cilat do të ishin një ndihmesë e mirë jo vetëm gjatë përgatitjes së strategjive, por edhe gjatë fazës monitoruese të zbatimit.

Komisionet parlamentare

Projektet e përparuara të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale u janë dërguar kryetarëve të komisioneve parlamentare. Pasi komisionet parlamentare të shikojnë dokumentin, ato mund të ftojnë ministritë për të diskutuar përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

Komuniteti i donatorëve

Grupet e punës për asistencën e jashtme teknike nuk e përmbushnin plotësisht nevojën e procesit të planifikimit strategjik. Për shembull, disa grupe nuk takoheshin rregullisht, ndërkohë që grupe të tjera takoheshin pa pjesëmarrjen e qeverisë. Përgatitja e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale shihej si një mundësi për ministritë që të riformulonin marrëdhëniet e tyre me donatorët. Projekte të përparuara të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale janë konsultuar me përfaqësues nga komuniteti i donatorëve që kanë treguar interes në fusha të ndryshme të politikave.

Rishikimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale

Projekte të mëpasme të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale janë rishikuar nga specialistë të ndryshëm të ftuar nga DBSKNH dhe në përbërje të tyre kishin përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritimit Europian dhe INSTAT-it. Në rast se quhej e nevojshme, u kontaktuan këshilltarët e Kryeministrit për komente shtesë. Këto prurje janë konsoliduar me komentet e DBSKNH në një përgjigje zyrtare të vetme dhe i janë dërguar ministrisë përgjegjëse nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Disa nga projekt-strategjitë përfundimtare janë dorëzuar pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik për rishikim. Për ato strategji të cilat kanë implikime domethënëse politike, ministrat u ftuan të bënin paraqitje të shkurtra në KPS, me qëllim që të mbështesnin debatet dhe të përmirësonin cilësinë e vendimmarrjes. Më pas, strategjitë u dërguan në Këshillin e Ministrave për miratim.

Strategjia kombëtare

Procesi i këshillimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim kishte për qëllim:

- Mbledhjen e komenteve nga palët e interesuara për përmirësimin e mëtejshëm të tij, duke e vënë theksin veçanërisht në mënyrën se si dokumenti identifikon përparësitë strategjike dhe nxjerr në pah alokimin e burimeve të ardhshme financiare.
- Arritjen e një konsensusi sa më të gjerë mbi çështjet kryesore të dokumentit
- Shpërndarjen e rezultatit të një pune prej gati një viti e gjysmë

Procesi i këshillimit u zhvillua në formën e një serie tryezash të rrumbullakëta të cilat përfshinë:

- tri tryeza të rrumbullakëta tematike kushtuar përparësive strategjike: integrimi në BE dhe NATO, zhvillimi ekonomik e social dhe demokratizimi e shteti i së drejtës
- dy tryeza të rrumbullakëta që u fokusuan në grupe të veçanta: një seminar ku morën pjesë të ftuar nga shoqëria civile, ndër të cilët përfaqësues nga Grupet Këshillimore si dhe nga organizata të tjera jo qeveritare; dhe një seminar me komunitetin e donatorëve, në të cilin morën pjesë shefat e misionëve të zhvillimit si dhe këshilltarë të asistencës së huaj teknike në Shqipëri
- katër tryeza të rrumbullakëta rajonale: në qytetet e Lezhës, Peshkopisë, Fierit dhe Pogradecit

Të gjithë pjesëmarrësit në këto tryeza u pajisën me pyetësorë me qëllim që ata të jepnin në to komentet e tyre, në formë të shkruar. Projekti për konsultim publik i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, gjithashtu është shpërndarë edhe në komisionet parlamentare sipas fushave përkatëse për komente.

Në mënyrë që procesi i SKZHI të shtrihej më tej, një seri prej dhjetë debatesh u transmetua në televizionin publik shqiptar gjatë periudhës tetor-dhjetor 2007. Shumica e debateve u regjistruan në një studio lëvizëse jashtë Tiranës dhe në to morën pjesë edhe përfaqësues të pushtetit vendor. Qëllimi i debateve ishte të jepte mundësinë për të diskutuar mbi strategjitë më të rëndësishme sektoriale në publik.

5.2 ZBATIMI

Mekanizmi kryesor që do të bëjë të mundur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim është procesi i **planifikimit të buxhetit**. Planifikimi strategjik dhe procesi i përgatitjes së buxhetit, dy komponentë të Sistemit të Planifikimit të Integruar, kanë disa pika takimi gjatë vitit kalendarik.

Përgatitja e tavaneve fillestare buxhetore (janar-shkurt)

Në muajin shkurt, Komiteti i Planifikimit Strategjik përcakton tavanet fillestare të institucioneve buxhetore për tre vitet e ardhshme. Ky proces ndahet në tri etapa. Së pari, përcaktohen parametrat e kuadrit makroekonomik nga Ministria e Financave. Së dyti, Komiteti i Planifikimit Strategjik diskuton mbi dokumentin e politikave prioritare, që përmbledh nga përparësitë e SKZHI-së, ato prioritete që institucionet i konsiderojnë të vlefshme dhe të rëndësishme për vitin rrjedhës, që do të ndikojnë në përcaktimin e tavaneve të tyre buxhetore. Dokumenti i politikave prioritare përgatitet nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, pas një vargu konsultimesh paraprake me ministrinë e linjës, si dhe me Ministrinë e Integritit European. Së treti, duke u ndikuar nga përfundimet e arritura në dokumentin e politikave prioritare, përgatiten tavanet fillestare nga Ministria e Financave, të cilat më pas miratohen në Komitetin e Planifikimit Strategjik. Zbatimi i këtij procesi është një masë për të garantuar që tavanet buxhetore marrin parasysh të gjitha kërkesat e institucioneve për financim për politikat e tyre më prioritare.

Rishikimi i deklaratave të politikave të programeve (mars-prill)

Buxheti i çdo ministrie përbëhet nga disa programe që shprehin secili një fushë aktivitësh, rezultatet dhe kontributet e të cilave ndihmojnë në arritjen e objektivave, të politikave që do të ndiqen në periudhën afatmesme si dhe të qëllimeve afatgjata. Këto qëllime dhe objektiva janë të shprehura hollësisht në çdo strategji sektoriale, të cilat shërbejnë edhe si dokumente reference. Deklaratat e politikave të programeve buxhetore shprehin qëllimet dhe objektivat që do të arrijë çdo program. Rishikimi i këtyre deklaratave, ka për qëllim të sigurojë që qëllimet dhe politikat e shprehura në to të jenë plotësisht në përputhje me strategjitë sektoriale dhe bëhet në fillim të procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Seancat e buxhetit (qershor dhe shtator)

Ministritë e linjës dorëzojnë në maj propozimet e tyre buxhetore për një periudhë trevjeçare, dhe në shtator bëhet rishikimi i shpërndarjes së burimeve për vitin e ardhshëm. Gjatë dy etapave Ministria e Financave e ndihmuar dhe nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj si dhe nga Ministria e Integritimit Europian, rishikon dokumentet e dorëzuara në mënyrë që ato të jenë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në përgjithësi, si dhe me Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në veçanti.

Rishikimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale (nëntor-dhjetor)

Pasi buxheti dorëzohet dhe miratohet në Parlament, ministritë e linjës përqendrohen në rishikimin e politikave. Rishikimi synon të sigurojë se strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale janë në linjën e duhur dhe gjithashtu përcakton nëse ka nevojë për përditësim për të reflektuar ndryshimet madhore të politikave. Duke patur parasysh faktin se nuk ka një mekanizëm buxhetor që bën të mundur financimin e drejtpërdrejtë të strategjive ndërsektoriale, në udhëzimet e shpërndara për ministritë e linjës, për përgatitjen e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, u theksua nevoja për përshtatjen e plotë të tyre me strategjitë sektoriale përkatëse. Një nga çështjet që do të kërkojnë vëmendje gjatë procesit të rishikimit të strategjive do të jetë dhe përmirësimi i lidhjes midis strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe me buxhetin.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, përveç procesit të buxhetit do të realizohet edhe nëpërmjet mekanizmit të ri, që do të miratohet në të ardhmen në mënyrë të koordinuar dhe graduale në qeveri, ai i vlerësimit të ndikimeve. Ky proces duhet të shqyrtohet përpara se të merren vendime madhore politike.

5.3 MONITORIMI

Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale

Monitorimi i zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale do të bazohet mbi një listë treguesish të përzgjedhur për çdo strategji. Këta tregues fokusohen në arritjen e qëllimeve strategjike dhe janë hartuar në nivelin e *impaktit* dhe të *rezultateve*. Ministritë nuk kanë për të raportuar rregullisht mbi këta tregues në ndonjë raport të veçantë.

Megjithatë strategjitë sektoriale do të jenë dokumenti i referencës për përgatitjen e PBA-së. PBA-ja siguron që alokimet e buxhetit gjatë një periudhe trevjeçare të pasqyrojnë përparësitë e politikave të përcaktuara në strategjitë sektoriale, duke realizuar një lidhje midis alokimeve të buxhetit dhe objektivave të politikave të programeve. Monitorimi i zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në nivelin e *input*-eve dhe *output*-eve është pjesë e sistemit të raportimit buxhetor. Në kuadrin e SPI-së, çdo ministri duhet të përgatisë çdo vit një Plan të Integruar të Ministrisë (bashkë me një Plan Monitorimi të Qeverisë të përfshirë si aneks), i cili parashikohet të jetë:

- Një instrument planifikimi, që përmban angazhimet kryesore të çdo ministrie për vitin rrjedhës, të cilat shprehin në dokumente të rëndësishme (kryesisht PBA-ja) dhe që ndihmojnë Kryeministrin për të vlerësuar performancën;
- Një instrument monitorimi, sipas të cilit ministritë do të raportojnë çdo tremujor në lidhje me përparimin e arritur përkundrejt angazhimeve kryesore; dhe

- Një instrument komunikimi, në kuptimin që dokumenti përmbledh të gjitha angazhimet kryesore të çdo ministrie në një dokument kompakt (pritet që dokumenti të mos jetë më shumë se 15 faqe) dhe në një mënyrë të integruar, që lehtëson leximin e dokumentit nga publiku.

Planet e Integuara të Ministrive u përgatitën për herë të parë më 2007. Një Raport i shkurtër Vjetor i Ministrisë, mbi arritjet në krahasim me zotimet e shprehura në Planin e Integruar të Ministrisë dhe Planin e Monitorimit të Ministrisë do të publikohet më 2008. Ministrinë nëse dëshirojnë, në Raportin Vjetor të Ministrisë mund të përfshijnë aktualizime të treguesve kryesorë të strategjive të tyre.

Sistemi i monitorimit do të mbështetet me Sistemin Informacionit të SPI-së të përgatitur rishtazi, që do të krijojë lidhje midis informacionit të raportuar nga ministrinë në Ministrinë e Financave (në lidhje me zbatimin e PBA-së) dhe Ministrisë së Integritit (në lidhje me zbatimin e MSA-së). Sistemi Informacionit të SPI-së do t'u shërbejë dy qëllimeve kryesore:

- Do t'i japë qeverisë informacionin e monitorimit, i cili është i nevojshëm për të ndjekur angazhimet kryesore të qeverisë; dhe
- Do t'u japë drejtuesve të ministrisë një mënyrë për të pasur informacion të gjerë për përmbushjen e planeve operative të ministrisë.

Strategjia Kombëtare

Përparimi në zbatimin e SKZHI-së do të vlerësohet me anë të treguesve të përcaktuar më poshtë. Këta tregues masin ekskluzivisht rezultatet dhe impaktet dhe do të aktualizohen çdo vit, nëse nuk përcaktohet ndryshe. Për më tepër, do të monitorohen edhe treguesit makroekonomikë të Kapitullit 1. Së fundi, alokimi i shpenzimeve publike do të ndiqet për informim.

Tabela 5.1 Lista e treguesve të SKZHI-së

	Sektori	Treguesi	Ndarja	Burimi
1.	Mbrojtja	Përmbushja e Objektivave të Partneritetit		Ministria e Mbrojtjes
2.	Drejtesia	'Shteti i së drejtës'	Krahasuar me vendet e EJL-së	Treguesit Mbarëkombëtarë të Qeverisjes, Banka Botërore
3.		Popullsia e burgjeve në krahasim me kapacitetet e disponueshme		Ministria e Drejtësisë
4.	Të drejtat e pronës	Numri i pronave që kanë marrë një certifikatë legalizimi		ALUIZNI
5.		Numri i pronave që janë regjistruar në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme		ZORPP
6.	Anti-korrupsioni	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit	Krahasuar me vendet e EJL-së	Transparency International
7.	Krimi i organizuar	Numri i viktimave të trafikut në Shqipëri ose që e ka pikënisjen në Shqipëri	Krahasuar me vendet e EJL-së	Policia e Shtetit; Raport Vjetor ONM mbi Viktimat e Trafikimit në Europën Jug-Lindore
8.	Rendi publik	Shkelje penale për 100 000 banorë (duke i përjashtuar shkeljet e kundërvajtjeve në trafik)	Krahasuar me disa vende europiane të përzgjedhura	Policia e Shtetit; Statistikat nga Burimet Europiane të Krimeve dhe Drejtësisë Kriminale
9.	Administrata publike	Numri i ankimeve në lidhje me zbatimin e ligjit mbi Shërbimin Civil	Sipas Ilojit	Komisioni i Shërbimit Civil
10.	Decentralizimi	Përmbushja e parimeve të Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore		Ministria e Brendshme

11.	Transporti	Numri i kilometrave të rrjetit rrugor nacional ndertuar		Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit
12.		Numri i rasteve të vdekjeve në aksidente rrugore për 10 000 mjete		INSTAT (vdekje); Policia e Shtetit (mjete)
13.		Koha mesatare e qëndrimit të anijes në port	Sipas porteve	Portet detare
14.		Numri i pasagjerëve		Tirana International Airport
15.	Energjia	Prodhimi i energjisë elektrike (GWh)	Sipas burimit	KESH
16.		Konsumi energjetik krahasuar me PBB-në		Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
17.	Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	Mundësia e furnizimit: Përqindja e familjeve që raportojnë se kanë ujë të rrjedhshëm në banesë	Sipas nivelit të të ardhurave	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) (çdo tre vjet)
18.		Cilësia e furnizimit: Përqindja e kampioneve të marra brenda një viti nga të gjitha 54 ndërmarrjet e ujësjetllës që dalin negative në testin për E.coli dhe mbetje klori		Njësia për Monitorim dhe Benchmarking, DP Ujësjetllës dhe Kanalizimeve
19.	Mjedisi	Përqendrimi mesatar vjetor në 4 qytete të 3 ndotësve të ajrit: PM10 (grimcat e imta); SO ₂ (dioksidi i sulfurit); dhe NO ₂ (dioksidi i azotit)	Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan	Instituti i Shëndetit Publik; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administratës së Ujërave
20.	Financa	Raporti borxh i brendshëm ndaj PBB	Krahasuar me vendet e EJL-së	Ministria e Financave; Raportet e FMN-së për vendet e tjera
21.	Ekonomia	Investimet e Huaja Direkte për frymë (€)	Krahasuar me vendet e EJL-së	Banka e Shqipërisë; EBRD
22.		Shumëllojshmëria e eksporteve: Pjesa e katër sektorëve (tekstile, këpucë, metale dhe minerale) në totalin e eksporteve		INSTAT
23.		Radhitja në anketën 'Doing Business'	Sipas treguesve Krahasuar me vendet e EJL-së	Banka Botërore
24.	Mbrojtja e konsumatorit	Përqindja e të intervistuarve që pranon se ndihen të mbrojtur nga masat ekzistuese për mbrojtjen e konsumatorit [Ky tregues duhet të përfshihet në anketat e ardhshme të opinionit publik]		Aktualisht nuk disponohet
25.	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit	Tregues i gatishmërisë për e-government	Krahasuar me vendet e EJL-së	Rrjet Online i Kombeve të Bashkuara për administratën publike dhe financat
26.	Punësimi	Niveli i papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç, sipas përkufizimit standard dhe atij të zbutur	Sipas gjinisë	Anketa për krahun e punës
27.	Barazia gjinore	Shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, sipas përkufizimit standard dhe atij të zbutur		Anketa për krahun e punës
28.	Mbrojtja sociale	Mbulimi nga programi i ndihmës ekonomike: Përqindja e njerëzve në varfëri (ekstreme) që përfitojnë ndihmë		Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) (çdo tre vjet)

29.	Përfshirja sociale	Shkalla e popullsisë në varfëri absolute		Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) (çdo tre vjet)
30.		Përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar		Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) (çdo tre vjet)
31.	Sigurimet shoqërore	Shkalla e zëvendësimit të pensioneve		Instituti i Sigurimeve Shoqërore
32.		Përqindja e varësisë së sistemit: Raporti midis numrit të përfituesve dhe të atyre që kontribuojnë		Instituti i Sigurimeve Shoqërore
33.	Shëndetësia	Shkaqet e vdekjeve sipas grupsëmundjeve për 100 000 banorë	Sipas gjinisë	INSTAT
34.		Shkalla e vdekshmërisë amtare		Ministria e Shëndetësisë, INSTAT
35.		Shkalla e vdekshmërisë foshnjore		Ministria e Shëndetësisë, INSTAT
36.	Arsimi bazë	Shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm: Numri i studentëve që ndjekin klasën 9-12 në krahasim me popullsinë e grup-moshës përkatëse (14-17-vjeç)	Sipas gjinisë	Ministria e Arsimit, INSTAT
37.	Arsimi i lartë	Numri i studenteve në arsimin e lartë	Sipas statusit me kohë të plotë / të pjesshme	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
38.	Planifikimi hapësinor	Përqindja e bashkive të pajisura me një plan urban sipas ligjit të planifikimit		Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit; Shoqata e Bashkive
39.	Zhvillimi rajonal	Niveli i zhvillimit socio-ekonomik [Treguesi do të përpunohet si pjesë e procesit të zbatimit të strategjisë së zhvillimit rajonal]	Sipas qarkut	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë, Energjitikës
40.	Zhvillimi rural	Madhësia mesatare e njësive ekonomike bujqësore (ha)	Krahasuar me vendet e EJL-së	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; INSTAT
41.		Numri i kilometrave të rrugëve rurale që janë ndërtuar		Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit
42.	Bujqësia	Produktiviteti në bujqësi dhe në agropërpunim (lekë/të punësuar)		Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
43.		Pjesa e produkteve bujqësore të shitura (%)		Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
44.		Vëllimi i eksporteve në agro-industri (€)	Sipas produkteve kryesore	INSTAT
45.	Turizmi	Numri i turistëve	Sipas rajoneve të origjinës	Organizata Botërore e Turizmit

Raporti vjetor i progresit

Sipas SPI-së, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave do të jetë përgjegjës për një raport vjetor, i cili:

- do të vlerësojë ecurinë e zbatimit të strategjisë, kryesisht përsa u përket prirjeve të treguesve të monitorimit të përcaktuar më lart
- do të përdorë informacione të tjera statistikore në dispozicion në mënyrë që të analizojë prirjet afatgjata dhe të krahasojë Shqipërinë me vendet e tjera në rajon
- do të identifikojë në mënyrë të përzgjedhur çështjet që kanë rëndësi kritike për procesin e arritjes së qëllimeve afatgjata të vendit dhe që do të jenë baza për diskutime më të gjera

Raporti vjetor i progresit:

- nuk paraqet një strategji të mirëfilltë, pasi ky rol mbulohet nga dokumenti i SKZHI-së
- nuk përvijon një kuadër që hedh shikimin nga e ardhmja, pasi kjo ofrohet në dokumentin e PBA-së nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave
- nuk zëvendëson Raportet Vjetore të Rezultateve të kryera nga ministritë e linjës, që do të përqendrohen në rezultate dhe përbën një pjesë kryesore të SPI-së

Publiku i gjerë është auditori kryesor i synuar i raportit të progresit vjetor. Struktura e raportit do të jetë e thjeshtë dhe do t'i kushtojë një faqe çdo treguesi dhe politikës përkatëse të përcaktuar më lart.

Programi pesëvjeçar i statistikave

Ndjekja e treguesve të monitorimit do të mbështetet nga zbatimi i një programi pesëvjeçar për statistikat zyrtare 2005-2009. Qeveria në kuadrin e përparësive të saj strategjike me Programin Statistikor të Komunitetit Europian si një pikënisje ka përcaktuar këto detyra përsa u përket statistikave:

- Maksimalizimi i përdorimit të burimeve administrative. INSTAT mbas krijimit të një regjistri me karakteristika unike për të gjitha Insitucionet Qendrore dhe Ministritë, do të organizojë një model grumbullimi të dhënash, me përgjegjësi hierarkike të mirëpërcaktuara.
- Përmirësimi i mënyrës së llogaritjes të të gjithë treguesve makroekonomikë, si dhe i sistemit të llogarive kombëtare, duke u përafuar me ESA 95. Të dhënat e përmirësuara do të ndihmojnë në llogaritjen e PBB të përkohshme jo vetëm sipas prodhimit, por edhe sipas shpenzimeve me çmime rrjedhëse dhe konstante.
- Përmirësimi i matjes së ekonomisë së pavrojtuar. Shqipëria do të përshtasë edhe më shumë rekomandimet e OECD-së, Eurostatit dhe Komitetit Ekonomik të Europës. Do të përmirësohet mënyra e deritanishme e llogaritjes mbi bazën e kushteve konkrete të vendit, por sidomos duke përdorur të dhënat që vijnë nga inspektorati i punës.
- Të dhëna të shpejta makroekonomike (PBB 'flash estimation'). Për t'u ardhur në ndihmë të gjithë vendimmarrësve, duke përdorur vlerësime mbi bazën e disa metodave ekonometrike, të dhënat e PBB vjetore të kombinuara me të dhënat nga indeksi i shitjeve dhe të përmirësuara me deflatorë të ndryshëm sipas degëve, do të mundësojnë llogaritjen e PBB tremujore.
- Të dhëna strukturore mbi ndërmarrjet dhe regjistrin e bizneseve.
- Të dhënat e tregtisë së jashtme dhe Intrastat.
- Statistikat sociale, të dhënat mbi individët dhe familjet. Aktualisht për këto statistika ka vetëm një vrojtim pranë familjeve, që bëhet me qëllim monitorimin e të dhënave për zbutjen e varfërisë, LSMS-ja. Asnjë tjetër iniciativë statistikore nuk është ndërmarrë, për ta ngritur vendin në nivelin e shteteve të tjera të Europës dhe të rajonit. Megjithatë INSTAT-i më 2006 implementoi studimin e parë mbi buxhetin e familjeve dhe do të zhvillojë më 2007 studimin e parë mbi fuqinë punëtore.
- Përdorimi i të dhënave të regjistrimit dhe anketës pranë familjeve LSMS. Kjo është një detyrë e re e INSTAT-it, që ka të bëjë më shumë me zgjerimin e kapaciteteve analitike të zyrës, si dhe me transferimin e know how nga asistenca e huaj drejt INSTAT. Këto publikime jo vetëm që do të kërkojnë të ushtrorjnë ndikim për imazhin e INSTAT-it në publik, por gjithashtu do të mundësojnë edhe një prani më të madhe të specialistëve të INSTAT-it në forumet shkencore ndërkombëtare.

- Statistikat bujqësore. Ato do të përafrohen me standardet Europiane, veçanërisht nëpërmjet regjistrimit bujqësor, duke dhënë një pamje më të plotë të realitetit bujqësor të vendit. Gjithashtu, ato do të ndihmojnë në llogaritjen më të mirë të PBB. Sektorë të tillë si peshkimi apo pylltaria do të zënë vend në statistikat zyrtare në formë më të plotë, sidomos për të ndjekur zhvillimet që lidhen edhe me Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë.
- Statistikat mjedisore
- Statistikat rajonale të mbledhura nga burime administrative në nivel kombëtar, do të përmirësohen me ngritjen e NUTS të nivelit 2 të klasifikimit.